# DOSJA E ZEZË E MJAFTG99

*Boturar në gazeta SOT në Nëntor-Dhjetor 2008*

Ky është një dosjer i realituar nga muaji Nëntor deri në Dhjetor 2008 në Gazetën Sot, nga Av Altin Goxhaj në lidhje me zbërthimin e plotë të skemës së krijimit të Partisë G99 nga Fondacioni Soros. Pas publikimit të këtij dosjeri, në Shqipëri erdhi me urgjencë Johnas Rolett, personi përgjegjës i Fondacioneve Soros për Ballkanin dhe ndërroi gjithë strukturën drejtuese të Fondacionit Soros Tiranë (Fondacioni i Shoqërisë së Hapur për Shqipërinë) për shkak të dekonspirimit të gjithë skemave të përdorura deri në atë çast.



# Organograma e financimit të spinoffit elektoral sorosian: G99

## George SOROS

## SOROS SHQIPERI

## EDI RAMA

Njeriu i Soros në politikën shqiptare (mik i afërt që në '96,Budapest) i dhuroi Soros Celësin e Artë të Tiranës. Anëtar i bordit të SOROS '93 – '98 (aktualisht Kryetar i PS dhe Bashkisë Tiranë)

## Fondacioni Soros Shqipëri

(themelohet në 1992 nga Fron Nazi në një celulë komuniste)

**REMZI LANI**
Njeriu i Soros për Median '93-'08
(Aktualisht Drejtor i Qendrës së Medias)

**Disa nga njerëzit kryesorë:**

**VADETE SALA**
Njeriu i Shoqërisë Civile'92-'05 (aktualisht drejtues i Programit të Qeverisë Gjermane për shoqërinë civile)

**CAPAJEC GJOKUTAJ**
Njeriu i Soros për Administrin e Fondacionit '97-'08
(aktualisht Drejtor i Fondacionit të Soros A.B.C.)

**DELINA FICO**
Njeriu i Soros për Lëvizjen Feministe '94-'08 (Aktualisht mbulon marëdhëniet publike të USAID për Fondin e Millenium)

**PIRO MISHA**
Njeriu i Soros për literaturën '92-'08
(aktualisht Drejtor i Shtëpisë së Dialogut dhe Komunikimit)

SOROS ANGLI
PRINCESHA E HOLLANDES
FAMILJA MBRETËRORE HOLLANDEZE
AMBASADA HOLLANDEZE

## G99 & MJAFT

**MILVA EKONOMI**
"Njeriu i Artë i Soros në Shqipëri", Findnacierja e të gjithë strukturave kryesore të Soros në Shqipëri '99 – '08
(aktualisht Drejton Institutin Agenda, G99, MJAFT, Besën,

## G99

C&PR Production

GRAFIK PROPAGANDA

## FONDACIONI MJAFT

BALLKAN YOUTH LINK

Shoqata Kombëtare e Debatit – ANDA

Instituti i Lidershipit Rinor

MOZAIK sh.p.k.

## LËVIZJA MJAFT

## MILIONA EURO financime për Lëvizjen MJAFT

- AMBASADA GJERMANE
- SNV
- NOVIB
- AMBASADA E MBRETËRISË SË BASHKUAR
- OSCE
- AMBASADA E SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS
- USAID
- DELEGACIONI I BASHKIMIT EUROPIAN NË TIRANË
- Agjencia Austriake IFA
- Agjencia zvicerane për Zhvillim dhe Kooperim SDC
- Agjencia Spanjolle për Bashkëpunim dhe Kooperim
- Banka Botërore
- UNICEF
- UNDP
- UNV
- UNDCP
- DFID
- GTZ
- IOM
- ILO
- OXFAM
- FREEDOM HOUSE
- Iniciativa e Paktit të Stabilitetit ESI
- NED
- GMF (German Marshall Fund)
- BOSCH (Fondacion Gjerman)
- Olaf Palme
- Pakti i Stabilitetit për EJL i mbështetur nga Qeveria Gjermane
- NDI
- IRI
- NED
- Fondacioni i Ndërkombëtar i Biznesit Rinor
- Fondacioni Ndërkombëtar i Rinisë
- Ballkan Children & Youth Foundation BCYF
- Forumi i Lidershipit të Biznesit të Princit të Éellsit
- Fondacioni Rockfeller
- Këshilli Britanik
- Fondacioni Soros Kosovë, Etj

Zbulohet në gjykatë akti që verteton se Veliaj mban edhe vulën e MJAFT edhe G99

# Dorëheqja e Veliajt nga MJAFT, mashtrim, kryetari i G99 vazhdon drejtor i MJAFT!

Erion Veliaj ka gënjyer publikisht kur ka deklaruar se ai dha dorëheqje nga MJAFT për t'u bërë drejtues i G99! Erion Veliaj ka gënjyer kur ka thënë se i ka dorëzuar çelësat e MJAFT! Erion Veliaj përballë çdo institucioni kombëtar dhe ndërkombëtar mbetet Kryetar i Bordit te Drejtorëve të MJAFT dhe çdo fond që ka gëlltitur MJAFT që kur dha dorëheqjen mediatike por jo faktike! Çdo fond qe ka marre dhe merr MJAFT nga Ambasadat e huaja që nga Shtatori 2007, qe ne fakt jane fonde qe burojnë nga kontributet e taksapaguesve amerikanë, holandezë, gjermanë, anglezë, spanjollë, austriakë, zviceranë, danezë, suedezë etj., janë menaxhuar juridikisht nga Erion Veliaj!

Vula e MJAFT eshtë kompetencë totale personale e Kryetarit te Bordit të Drejtorëve të MJAFT! Që nga 2007, Erion Veliaj organizoi një spektakël mediatik për të prezantuar 7 drejtorët e rinj të MJAFT, tre nga të cilët mbeten krejtësisht të jashtëligjshem!

Edhe sot e kesaj dite, sipas Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Drejtorët e vërtetë realë të MJAFT mbeten:

Z. Erion Veliaj - Kryetar i Bordit të Drejtorëve dhe Drejtor Ekzekutiv i MJAFT

Z. Arbain Mazniku - anëtar, Drejtor i Departamentit të Politikave

Z. Endri Fuga - anëtar, Drejtor i Departamentit të Komunikimit dhe Medias

Znj. Marinela Lika - anëtare, Drejtore e Departamentit të Koordinimit të Projekteve

Ndërkohë që disa muaj para dorëheqjes virtuale të Veliajt ai është bërë me Vendim nr. 288/1, dt 15 shkurt 2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, edhe Drejtor Ekzekutiv i Mjaft! Pra Erioni jo vetëm që nuk ka dhënë dorëheqjen juridike asnjëherë nga MJAFT por është bërë njëkohësisht edhe Kryetar i Bordit të Drejtorëve dhe Drejtor Ekzekutiv! Është e qarte se Erion Veliaj sot është më shumë se kurrë Drejtor dhe Kryetar i MJAFT! Ai tashmë është edhe Drejtues edhe financier i MJAFT! Ai kontrollon edhe vulën edhe kompetencat financiare! Sipas dokumenteve të Mjaft në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, të cilat janë të vetmet dokumenta juridikë që kanë vlerë ligjore në marëdhënie me të tretë dhe në radhë te parë me donatorët që vazhdojnë të ushqejnë MJAFT me miliona euro, MJAFT vazhdon të drejtohet nga Erion Veliaj, Arbian Mazniku, Endri Fuga, Marinela Lika të cilët siç dihen janë drejtues të lëvizjes politike G99 të cilët pretendojnë të bëhen deputetë në zgjedhjet e 2009 si përfaqësue të Lëvizjes G99 (te deklaruara publikisht në media nga Erion Veliaj).

**Tashmë shou i Velisë me emërimin virtual të 6 drejtuesve të rinj të MJAFT gjoja pa drejtor ekzekutiv apo Kryetar ka qenë një lojë për të fshehur faktin se Kryetar dhe Drejtor Ekzekutiv i MJAFT paska qenë Erion Veliaj!** Kjo vërtetohet nga Vendimi i Gjykatëses Marian Shegani (Dedi) e cila në dt.15.02.2007 me nr.Vendimi 288/1 ka vendosur si më poshtë:

2. Depozitimin e vendimit date 26.10.2006 të mbledhjes së Bordit Këshillimor të Qendrës Lëvizja Mjaft, i cili pasqyron: Pranimin e dorëheqjes nga detyra të Drejtorit Ekzekutiv Z. Endri Fuga; emërimin e Kryetarit të Bordit Ekzekutiv Z. Erion Veliaj njekohësisht edhe në detyrën e Drejtorit Ekzekutiv në perputhje me Statutin e ri të Qendrës; miratimin e tekstit te ri te Statutit te Qendrës së ndryshuar.

Në faqen online të MJAFT rezultojnë 7 drejtorë të rinj të MJAFT:

1. Llukan Tako Drejtor Administrativ
2. Leart Kola Drejtor i Aksionit
3. Elisa Spiropali Drejtore e Politikave
4. Kristi Pinderi Drejtor i komunikimit
5. Ervin Qafmolla Drejtor i Medias
6. Aniuen Skënderi Drejtore e Marrëdhënieve Nderkombetare
7. Elsi Rizvanolli Drejtor i Monitorimeve

Problemi qëndron që këta persona janë drejtorë online sepse nuk figurojnë në asnjë dokument ligjor dhe ata s'kanë asnje kompetencë mbi MJAFT pa autorizimin dhe vulosjen e Erion Velise i cili është drejtori real i tyre! Ata skanë asnjë kompetencë dhe noterizimet e brendshme organizative të MJAFT nuk kanë ansjë vlerë ligjore pasi ligji i ka lënë kujtdo një afat maksimal prej 3 muajsh për depozitimin e ndryshimeve të mundshme të drejtuesve të një OJF-je!

Erion Veliaj ka kompetenca të plota ligjore mbi të gjithë këta Drejtorë virtualë.

Sipas Nenit 12 - Organi Ekzekutiv Dhe Pwrfaqësimi i Qendrës, Pika 12.3 "Emërimi dhe shkarkimi nga detyra e Anëtarëve të Bordit të Drejtorëve behet nga Bordi Këshillimor me propozim të Kryetarit të Bordit të Drejtorëve."

Çdo dokument ligjor dhe deri edhe çdo proçesverbal është kompetencë totale e Veliajt.

" Në të njëjtin Nen, pika : 12.4 pika c, thuhet shprehimisht "mbledhjet e Bordit të Drejtorëve drejtohen nga Kryetari i Bordit të Drejtorëve. Për mbajtjen e procesverbalit dhe hartimin e vendimit të mbledhjes së Bordit të Drejtorëve përgjegjës është Drejtori Ekzekutiv i cili çdo mbledhje ngarkon një anëtar të stafit të Qendrës me detyrën e sekretarit të mbledhjes së Bordit të Drejtorëve Procesverbalet dhe Vendimet e mbledhjes së bordit **bëhen me shkrim dhe mbahen në një regjistër të veçantë. Procesverbalet dhe vendimet e mbledhjes së Bordit nënshkruhen nga Kryetari i Bordit të Drejtorëve dhe Sekretari."**

## NENI 9- ANETARET E BORDIT KESHILLIMOR DHE THEMELUESIT E QENDRËS

9.1 Anëtarët e parë të Bordit Keshillimor dhe Themeluesit e Qendrës janë si më poshtë vijon:

Znj. Milva Ekonomi, shtetase shqiptare, e bija e Vasilit, lindur më 31. 12. 1962, në Tiranë, pas. 0594246, banus në Tiranë, Blv B. Curri, P.4, Ap. 19

Znj. Klotilda (Ferhati) Bushka, shtetase shqiptare, e bija e Fatmirit, lindur në Tiranë më 11.04.1979, banuese në Tiranë Rr. Komuna e Parisit, pas. 0245131

Z. Alken Myftiu, shtetas shqiptar, i biri i Nexhatit, lindur më Tiranë, më 17.10.1973, banues në Tiranë, Rr. Kongresi i Lushnjes. Pas. N. Z0185989



## Lëvizja MJAFT ka vetëm 3 anëtarë!

Lëvizja e mijëra anetareve te MJAFT të pretenduar nga Veliaj është një falsitet dhe mashtrim i rëndë deri në nivele ndërkombëtare. Sipas Veliajt, MJAFT ka pasur 6mijë anëtarë! Por në fakt në gjykatën e Rrethit Tiranë Lëvizja MJAFT është regjistruar si një Qendër me 3 anëtarë! Sipas ligjit për OJFtë, Nr.8788, datë 7.5.2001, në Nenin 11, ku përcaktohet forma juridike e organizimit të Qendrës, pika 1. "Qendra është person juridik pa anetaresi, që ka për objekt të veprimtarisë së saj kryerjen e shërbimeve dhe realizimin e projekteve për qëllime në të mirë dhe në interes të publikut, me fonde dhe të ardhura të siguruara sipas ligjit. Nuk lejohet që qendra te kryejë veprimtari fitimprurëse." Pra

MJAFT është regjistruar në gjykatë si një organizatë jofitimprurëse pa anëtarë!

**Cilat janë kompetencat e Erion Velisë sot në MJAFT sipas Nenit 13, pika 13.2**
**"Kryetari i Bordit të Drejtorëve:**

1. Organizon, drejton dhe menaxhon mbledhjet e Bordit të Drejtorëve
2. Përfaqeson Qendrën në marrëdhënie me të tretët, në nivele kombëtare dhe ndërkombëtare
3. Është përgjegjës për ngritjen e fondeve të Qendrës, drejton punën për gjetjen e fondeve dhe kujdeset për mbarëvajtjen e punëve me donatorëve
4. Drejton punën për krijimin e partneriteteve me donatorë dhe organizata të tjera kombetare dhe ndërkombëtare
5. Organizon punën e grupeve këshillimore të Qendrës dhe moderon mbledhjet e këtyre grupeve
6. Është përgjegjës për krijimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit me institucionet publike dhe ato private
7. Kontrollon punën e anëtarëve të tjerë të Bordit të Drejtorëve
8. Përfaqëson Bordin e Drejtorëve dhe stafin e Qendrës tek Bordi Këshillimor".

Kreu i G99, Veliaj, devijon destinacionin e lëvizjes "MJAFT", duke mashtruar donatorët e huaj

# Financat e "MJAFT", në duart e grupimit politik G99

Erion Veliaj dhe drejtues të tjerë të G99, 1 vit më parë mashtruan shqiptarët dhe ndërkombëtarët duke bërë sikur po jepnin dorëheqjen nga Lëvizja "MJAFT". Veliaj me shokë, në Akademinë e Arteve në Tiranë, në 26 Shtator 2007, organizuan aktin e fundit të shou-t 5vjeçar të Lëvizjes "MJAFT"! Fjalimi i famshëm i Velisë "Shfaqja duhet te vazhdoje!" marrë nga kënga e famshme e Fredi Merkurit u transmetua në televizionet me kryesore dhe u botua në shumicën e shtypit shqiptar. Teksti i plotë i fjalimit të Velisë u perkthye anglisht dhe iu shpërnda të gjithë ndërkombëtarëve si vërtetim i faktit se Veliaj nuk ishte më përgjegjës për financat e "MJAFT" dhe se ai do te krijonte një parti politike nga e para! Në sallen e Black Boxit në Akademinë e Arteve merrnin pjese një numër i madh donatorësh që kishin ushqyer me vite me parate e taksapaguesve holandez, gjermanë, anglezë, zvicerane, austriakë, kanadezë, danezë apo suedezë, numrat bankarë të organizates së Erion Velisë. Ata ishin dëshmitarë të dorëheqjes publike të Velise, Maznikut, Likës dhe Fugës! Ata ishin dëshmitarë publikë të një dorëheqje publike! Por e vërteta edhe sot e kësaj dite është krejtësisht e kundërta! Veliaj vazhdon të ketë të drejtën e firmës së parë mbi vulën e "MJAFT", te ketë te drejtën e firmes së parë në çdo Bankë brenda dhe jashtë vendit, të ketë të drejtën të kërkojë shkarkimin e çdo Drejtori Departamenti në "MJAFT", të ketë të drejtën e përfaqësimit të organizatës pranë çdo donatori sepse edhe në rast kapjesh me abuzime, Veliaj mban përgjegjësi zyrtare dhe ligjore në gjykatat shqiptare apo te huaja. Sepse tashmë Erioni ka mashtruar në nivel ndërkombetar mbi fondet e taksapaguesve të huaj dhe ai dhe shokët e vet që kane mashtruar janë subjekt i çdo lloj hetimi ndërkombëtar.

Erion Veliaj, prej vitesh nuk pranon të bëjë transparencë para shqiptarëve për 6 vjet financime miliardësh të "MJAFT", duke shkaterruar te gjithë konkurrencën e shoqërisë civile, sepse ai bazohej në parimin se "MJAFT" është ushqyer me fonde taksapaguesish të huaj apo donacione private të huaja dhe kështu ai s'kishte detyrim para shqiptarëve te tregonte se sa para kishte gelltitur dhe se për çfarë ishin harxhuar.

Sot e kësaj dite, megjithëse në dhjetëra raste është kërkuar transparenca e financave të "MJAFT" (ku edhe vetëm sasia e miliardave nuk është pranuar të tregohet asnjëherë), Veliaj dhe bashkëpunëtorët e vet nuk kanë pranuar të tregojnë asgjë.

Sot, Veliaj me shokët e tij, drejtojnë një organizatë politike të quajtur G99, e cila kërkon të çojë 10 deputetë në Parlament (sipas Erion Velisë)! Në fakt organizata e re G99 e regjistruar si OJF në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, është themeluar nga njerëzit e "MJAFT", por ajo s'ka asnjë donator të deklaruar, ndërkohë që zyrat dhe pajisjet e saj janë më të shtrenjtat që ndonjë organizatë mund të ketë në Shqipëri. Zyrat e saj dhe numri i personave të angazhuar në të, kanë një kosto mujore mbi 20 mijë euro në muaj ç'ka vërteton se minimumi i shpenzimeve të kësaj organizate është 250 mijë euro në vit, pa përfshirë këtu shpenzimet për spote TV, shkolla verore në hotelet më të shtrenjta të Shqipërisë, turne të shtrenjta dhe materiale promocionale të cilësisë dhe sasisë së lartë. Problemi është ku i gjejnë drejtuesit e G99 gjithë këto para? Dhe në fakt G99 nuk ka deklaruar asnjë burim deri më sot. I vetmi burim që kanë deklaruar është ai i 120 personave që moren pjesë në Asamblenë e G99, ku secili duhet të kontribuonte me 1000 lekë në vit, shifër që nuk bën më shumë se 2000 fletëpalosje gjithsej.

Erion Veliaj me mbështetjen e 3 drejtorëve të tij të "MJAFT", që gjoja kanë dhënë dorëheqje dhe janë bashkuar me te te G99, është i vetmi përfaqësues ligjor në i "MJAFT" në sistemin Bankar shqiptar dhe jashte Shqipërisë. Asnjë Bankë nuk mund të njohë një përfaqësues tjetër përveç firmës së autorizuese të Erion Velisë, sepse sipas çdo marrëdhënie juridike dhe rregulloreje bankare i vetmi përfaqësues që autorizon të drejtën e firmës për të tërhequr paratë në Bankë është përfaqësuesi firma e te cilit është e depozituar në Gjykatë. Asnjë firmë tjetër përveç Velisë nuk mund të njihet dhe në rast se një Bankë do të guxonte t'a shkelte këtë rregull, ajo do të ishte subjekt i masave nga ana e Gjykatës. Çdo person që paraqitet sot në Bankë në emër të "MJAFT", është person që më parë duhet jetë autorizuar nga Erion Veliaj. Dhe është po Veliaj që ka të drejtë që të anulojë të drejtën e çdokujt që të paraqitet në Bankë. Është po Erion Veliaj, i cili ka të drejtë që pavarësisht autorizimit të një personi të tretë te paraqitet sa herë të dojë në Bankë dhe të tërheqë çdo lloj shume që ndodhet në numrat bankarë të "MJAFT"! Është po Veliaj, i cili ka te drejtë që te autorizojë persona të caktuar për të tërhequr para nga llogaria e "MJAFT" në Bankë. Paratë që tërheq "MJAFT" në banka, mund të terhiqen vetëm me pëlqimin e Velisë, i cili ka kompetencën për te terhequr paratë në banka. Kompetenca më e rëndësishme që ka Veliaj në Banka është edhe kontrolli ekskluziv i pasqyrave financiare të llogarive bankare të "MJAFT", duke ia mohuar kujtdo që e sheh të arsyeshme, dhe në këtë rast edhe 7 drejtuesve virtualë që gjoja drejtojnë "MJAFT" sot.

"MJAFT" on të njohesh rregulloren e çdo lloj banke brenda dhe jashtë Shqipërisë, për të kuptuar se sot Veliaj ka të drejtë të tërheqë sa here te doje çdo lloj sasie parash te taksapaguesve të huaj të destinuara për "MJAFT" në numrat e llogarive zyrtare të saj. Erioni ka të drejtë që vetëm me një shkresë te thjeshte, madje edhe me shkrim dore, të kryejë dhe te anulojë autorizime për të drejtat bankare të "MJAFT". Sepse rregulloret bankare ia njohin këtë te drejtë ekskluzive Velisë, për arsye se bankat njohin sipas detyrimeve ligjore vetëm përfaqësuesin ligjor të organizates. Dhe ky sipas Statutit të "MJAFT" dhe aktit të themelimit te regjistruar në Gjykatën e Faktit të Rrethit Gjyqësor Tiranë është Kryetari i Bordit të Drejtorëve dhe Drejtori Ekzekutiv i "MJAFT", Z. Erion Veliaj. Dhe në rast se për këtë qëllim duhet shkresë me vulë, Veliaj



FAXIMILE E REGJISTRIMIT TË G99 NË GJYKATË



FAXIMILE E REGJISTRIMIT TË MJAFT SOT NË GJYKATË

## Bordi Vendimarrës i "MJAFT" është pjesë e Bordit Vendimarrës të G99!

Neni 9 i Statutit të "MJAFT" i depozituar në Gjykatën e Tiranës:

NENI 9- ANËTARËT E BORDIT KËSHILLIMOR DHE THEMELUESIT E QENDRËS.
9.1 Anëtarët e parë të Bordit Këshillimor dhe Themeluesit e Qendrës janë si më poshtë vijon:
Znj. Milva Ekonomi, shtetase shqiptare, e bija e Vasilit, lindur më 31. 12. 1962, në Tiranë, pas. 0594246, banus në Tiranë, Blv B. Curri, P.4, Ap. 19
Znj. Klotilda (Ferhati) Bushka, shtetase shqiptare, e bija e Fatmirit, lindur në Tiranë më 11.04.1979, banuese në Tiranë, Rr. Komuna e Parisit, pas. 0245131
Z. Alken Myftiu, shtetas shqiptar, i biri i Nexhatit, lindur më Tiranë, më 17.10.1973, banues në Tiranë, Rr. Kongresi i Lushnjës. Pas. N. Z0185989

Akti i vendimit të regjistrimit të G99:

Këshilli i parë i Shoqatës G99:
Ndërmjet 19 anëtarëve të Këshillit të Parë të G99 gjenden këto 3 emra:
Milva Ekonomi, Alken Myftiu, Klotilda Bushka (Ferhati).

# Kryetari i G99, Erion Veliaj, kontrollon numrat e llogarive bankare të "MJAFT" në Bankat brenda dhe jashtë vendit!

Megjithëse kreu i G99 është larguar nga drejtimi i lëvizjes "MJAFT", nëpërmjet një dorëheqje publike, ky fakt rezulton një mashtrim i pastër. Tashmë në bazë të vendimit të gjykatës të konfirmuara me faksimilet origjinale, vërtetohet se Erion Veliaj vazhdon të tërheqë rregullisht paratë e donatorëve të destinuara për këtë OJF. Sipas Vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me Nr vendimi 288 dt 26.1.2006, të firmosur nga Gjykatësja Altina Xhoxhaj, Kryetari i Bordit të Drejtorëve Veliaj "përfaqëson Qendrën në marrëdhënie me të tretët. Drejtori Ekzekutiv ka të drejtë që veçmas ose bashkërisht me Kryetarin e Bordit të Drejtorëve të përfaqësojë Qendrën në marrëdhënie me Bankat dhe institucionet financiare, dhe të përfaqësojë Qendrën tek të tretët, në mungesë të Kryetarit të Bordit të Drejtorëve." Ky vendim mbetet në fuqi edhe sot e kësaj dite dhe në ditët në vazhdim.

po sipas këtij Statuti ka të drejtë të përdorë vulën e "MJAFT" sa herë të dojë. Veliaj ka të drejtë të bëjë edhe vulën në dy kopje dhe njërën ta mbajë në shtëpinë e tij dhe ta përdorë sa herë të dojë.

Kompetencat aktuale të Velisë në raport me llogaritë bankare të "MJAFT" janë të njëjta edhe në raport me projektet dhe raportet që paraqet "MJAFT" pranë donatorëve ndërkombëtarë. Erion Veliaj i G99, është personi përgjegjës në nivelin më të lartë të hierarkisë së kompetencave për çdo projekt që ka paraqitur dhe vazhdon të paraqesë "MJAFT" pranë Donatorëve ndërkombëtarë, sidomos për projektet që "MJAFT" ka aplikuar për monitorimin e zgjedhjeve dhe edukimin e votuesve për herë të parë për vitin 2009. Subjekti politik G99 do të paraqesë kandidatë në zgjedhjet e ardhshme, ndërkohë që Erion Veliaj është funksionari më i lartë i "MJAFT" dhe kjo organizatë ka aplikuar dhe po aplikon pranë donatorëve ndërkombëtarë për zgjedhjet e 2009, projekte të cilat pritet ti sjellin numrave të llogarive të "MJAFT" të kontrolluara nga Veliaj rreth gjysëm milioni euro.

Fakti që Veliaj nuk ka dhënë dorëheqje të vërtetë nga "MJAFT", vërtetohet nga fakti se, "MJAFT" i Velisë nuk ka depozituar asnjë procesverbal dhe ndryshim në përfaqësimin ligjor në gjykatë. Në raport me çdo të tretë, përfshirë edhe donatorët. Veliaj mbetet juridikisht i vetmi person përgjegjës. Këto të dhëna janë mbajtur të fshehura në projektet e "MJAFT" prej 1 viti. Prej 1 viti të gjitha projektet e "MJAFT" janë bazuar mbi të dhëna të rreme, duke deklaruar të dhëna kontradiktore të cilat janë manipuluar në aplikimet për fonde, pasi të tjerë persona janë paraqitur si përgjegjës kryesorë të "MJAFT". Këta persona, në fakt janë përfaqësues virtualë dhe emrat e tyre janë përdorur në projektet e "MJAFT" në mënyrë të rreme pasi ata nuk janë përgjegjës ligjorë. Por ka edhe disa raste abuzive, të cilat bazohen në qindra mijë euro marëveshje me donatorët ndërkombëtarë, ku Veliaj vazhdon të mbetet përgjegjës ligjor i "MJAFT" megjithëse publikisht ka dhënë dorëheqje. Dokumentacioni i plotë do të paraqitet në ditët në vazhdim ku vërtetohet dhe dekonspirohet skema e plotë se si këta njerëz kanë devijuar fondet e "MJAFT" për të mbështetur grupimin politik G99. Në fakt, këto raste janë shkelje e rëndë ligjore dhe financiare deri penale, ku në mënyrë të qëllimtë, fondet e taksapaguesve të huaj të cilat nuk lejohet në mënyrë kategorike të shpenzohen për veprimtari partizane (partiake), të shpenzohen për veprimtari në favor të grupimeve politike. Tashmë dhe në ditët në vazhdim, qytetarët shqiptarë dhe institucionet e huaja që mbrojnë interesat e taksapaguesve të vendeve të tyre me paratë e të cilëve është financuar "MJAFT", po mësojnë dhe do sqarohen më së miri se si funksionon në Shqipëri skema e manipulimit të fondeve nga përfaqësues të rremë të shoqërisë civile. Në ditët në vijim lexuesit e gazetës SOT, por edhe përfaqësuesit seriozë të trupit diplomatik të atashuar në Shqipëri, të cilët nuk janë implikuar në aferat e sipërpërmendura, do të shikojnë qartazi se si shpenzohen paratë e taksapaguesve të shteteve përkatëse, për grupime të caktuara aventurierësh. Rasti në fjalë, pra grupimi Veliaj&CO të cilët drejtojnë një organizatë politike që synon të çojë deputetë në Parlament, kanë kontroll të plotë mbi të gjitha financimet dhe llogaritë bankare të "MJAFT". Këto para paguhen nga shtete të ndryshme evropiane dhe amerikane për të sensibilizuar dhe forcuar shoqërinë civile në Shqipëri, por që fatkeqësisht nga Veliaj&CO po shpërdorohen për qëllime të mirëfillta politike dhe karrieriste. Ky veprim është dhunim i rëndë i të gjitha kontratave ligjore financiare të "MJAFT" me donatorët, por për të vërtetuar dhe konfirmuar këtë fakt do të duhet ndërhyrja e organeve të specializuara të krimit ekonomik. Tashmë kjo çështje është subjekt i hetimit ligjor financiar të krimit ekonomik ku shumë shpejt do të dalin implikime të rënda të Erion Velisë me paratë e taksapaguesve të huaj por edhe me falsifikimet që janë bërë me raportet e auditimit dhe raportimeve financiare të "MJAFT"!

Pjesë nga Statuti i "MJAFT" i regjistruar në Gjykatë:

NENI 12 - ORGANI EKZEKUTIV DHE PERFAQËSIMI I QENDRËS

12.1 Organi Ekzekutiv i Qendrës është Bordi i Drejtorëve. Bordi i Drejtorëve është organ kolegjial dhe përbëhet nga:

- Kryetari i Bordit të Drejtorëve
- Drejtori i Departamentit të Politikave
- Drejtori i Departamentit të Komunikimit dhe Medias
- Drejtori i Departamentit të Koordinimit të Projekteve
- Drejtori i Departamentit të Aksionit të Drejtpërdrejtë

12.2 Bordi i Drejtorëve drejtohet nga Kryetari i Bordit të Drejtorëve që zgjidhet nga Bordi Këshillimor për të drejtuar veprimtarinë e përditshme të Qendrës dhe ekzekutimin e programeve të vendosura nga organi më i lartë vendimmarrës. Numri i anëtarëve të Bordit të Drejtorëve është i ndryshueshëm në varësi të Departamenteve të Qendrës. Gjithsesi numri i anëtarëve të Bordit të Drejtorëve nuk mund të jetë më i vogël se tre. Kohëzgjatja në detyrë e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve është e pakufizuar.

12.3 Emërimi dhe shkarkimi nga detyra e Anëtarëve të Bordit të Drejtorëve bëhet nga Bordi Këshillimor me propozim të Kryetarit të Bordit të Drejtorëve. Personat e mëposhtëm janë zgjedhur në funksionet e Bordit të Drejtorëve të parë të Qendrës për një periudhë të pakufizuar kohore:

- Z. Erion Veliaj - Kryetar i Bordit të Drejtorëve
- Z. Arbian Mazniku - anëtar, Drejtor i Departamentit të Politikave
- Z. Endri Fuga - anëtar, Drejtori i Departamentit të Komunikimit dh Medias
- Znj. Marinela Lika - anëtare, Drejtore e Departamentit të Koordinimit të Projekteve
- Z. Besian Pesha - anëtar, Drejtori i Departamentit të Aksionit të Drejtpërdrejt

12.4 c) mbledhjet e Bordit të Drejtorëve drejtohen nga Kryetari i Bordit të Drejtorëve. Për mbajtjen e procesverbalit dhe hartimin e vendimit të mbledhjes së Bordit të Drejtorëve përgjegjës është Drejtori Ekzekutiv i cili çdo mbledhje ngarkon një anëtar të stafit të Qendrës me detyrën e sekretarit të mbledhjes së Bordit të Drejtorëve Procesverbalet dhe Vendimet e mbledhjes së bordit bëhen me shkrim dhe mbahen në një regjistër të veçantë. Procesverbalet dhe vendimet e mbledhjes së Bordit nënshkruhen nga Kryetari i Bordit të Drejtorëve dhe Sekretari.

12.5 Qendra përfaqësohet tek të tretët nga Kryetari i Bordit të Drejtorëve, dhe nga Drejtori Ekzekutiv, veçmas ose së bashku.

NENI 13 - DETYRAT E BORDIT TË DREJTOREVE DHE ANETARËVE TË TIJ

13.1 Bordi i Drejtorëve:

1. Zbaton politikat e Qendrës
2. Drejton programin e Qendrës dhe menaxhon aktivitetin e saj
3. Menaxhon shpenzimet dhe buxhetin
4. Emëron dhe shkarkon stafin në mbështetje të legjislacionit të punes
5. Ndjekë dhe vlerëson punën e stafit në bazë të rregullores së miratuar nga Bordi Këshillimor
6. Raporton në mbledhjet e Bordit, dhe paraqet raportin vjetor para Bordit Këshillimor
7. Në bashkëpunim me stafin harton plane dhe projekte
8. Vendos për hapjen dhe mbylljen e departamenteve të veçanta
9. Vendos në lidhje me shpërblimet dhe bonuset për stafin e Qendrës
10. Ndihmon në krijimin e rrjetit të bashkëpunimit me OJF-të dhe institucionet publike dhe private

13.2 Kryetari i Bordit të Drejtoreve:

1. Organizon, drejton dhe menaxhon mbledhjet e Bordit të Drejtorëve
2. Përfaqëson Qendrën në marrëdhënie me të tretet, në nivele kombëtare dhe ndërkombëtare
3. Është përgjegjës për ngritjen e fondeve të Qendrës, drejton punën për gjetjen e fondeve dhe kujdeset për mbarëvajtjen e punëve me donatorëve
4. Drejton punën për krijimin e partneriteteve me donatorë dhe organizata të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare
5. Organizon punën e grupeve këshillimore të Qendrës dhe moderon mbledhjet e këtyre grupeve
6. Është përgjegjës për krijimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit me institucionet publike dhe ato private
7. Kontrollon punën e anëtarëve të tjerë të Bordit të Drejtoreve
8. Përfaqëson Bordin e Drejtoreve dhe stafin e Qendrës tek Bordi Këshillimor

NENI 14 – DREJTORI EKZEKUTIV

14.1 [illegible]

14.2 [illegible]

1. [illegible]
2. [illegible]
3. [illegible]
4. [illegible]
5. [illegible]
6. [illegible]
7. [illegible]
8. [illegible]
9. [illegible]
10. [illegible]
11. [illegible]

14.3 [illegible]

[illegible]

FAXIMILE E STATUTIT TË MJAFT SOT NË GJYKATË

Ambasadori Gjerman, dëshmitar i shpërdorimit të fondeve të MJAFT nga G99

# Mbi çerek milioni Euro të taksapaguesve të huaj devijojnë për të financuar partinë Erion Velisë

Shoqëria civile shqiptare ka kohë që është e mbërthyer nga kriza e identitetit. Megjithëse pluralizmi shqiptar ka hyrë në datëlindjen e tij të tetëmbëdhjetë, shoqëria civile shqiptare vazhdon të ngelet një foshnjë në djepin e ndërtuar nga korrupsioni i qarqeve të ndryshme ndërkombëtare. Në mënyrë të qëllimshme qarqe të caktuara të diplomacisë së huaj apo dhe të grupimeve të caktuara ekonomike investojnë para për të ngritur një model të shoqërisë civile i cili të përmbushë oreksët e tyre. Shoqëria civile shqiptare tashmë është totalisht e atrofizuar dhe e monopolizuar. Kjo shoqëri civile tashmë kontrollohet nga qarqe të dyshimta të cilat e kanë përmbledhur përfaqësimin e kësaj shoqërie vetëm në një grupim të reduktuar personash. Nëpërmjet investimeve të miliarda lekëve, këto qarqe e kanë rrudhur përfaqësimin e shoqërisë civile në pak figura, ku më emblematikja është ajo e Erion Velisë, i cili nëpërmjet organizatës MJAFT dhe grupimit elektoral G99, ka hedhur hapin e tij drejt kapjes së politikës shqiptare. Donatorët kanë hedhur para të marra nga taksapaguesit e tyre me qëllimin e sensibilizimit dhe forcimit të shoqërisë civile, e cila sot konsiston vetëm në emrin e Erion Velisë. Ky njeri ka gllabëruar këto fonde duke ndryshuar destinacionin e vërtetë të fondeve të dhuruar nga taksapaguesit europianë dhe amerikanë.

Prej ditësh ka plasur skandali Veliaj i cili ka përdorur fondet e taksapaguesve të huaj të destinuara për shoqërinë civile për të financuar Grupimin e tij politik G99 që është kthyer tashmë në një shtojcë të "Politikës së Re" të Partisë së Edi Ramës.

Janë mbi 2.5 milionë euro të taksapaguesve europianë dhe amerikanë të cilat kontrollohen në numrat bankar të MJAFT nga Kryetari i Grupimit Elektoral G99. Janë projekte që i janë dhënë MJAFT kundrejt kushtit ndërkombëtar "të mos përdorimit për qëllime partizane" (elektorale), fondet e të cilave kontrollohen në disa Banka brenda Shqipërisë nga Erion Veliaj dhe ish-mjaftistët e tjerë. Këto fonde burojnë nga kontributet e taksapaguesve gjermanë, holandezë, anglezë, danezë, zviceranë, spanjollë, dhe tashmë edhe amerikanë, të cilat janë dhurime për forcimin e shoqërisë civile në Shqipëri. Vetëm njëri ndër projektet që ushqen politikën e Velisë ka vlerë 1.2 milionë euro dhe është financuar nga Mbretëria e Hollandës. Vetëm njëri projekt, që është deklaruar si punësim i Veliajt në media para 6 muajsh, financohet me paratë e taksapaguesve gjermanë dhe austriakë për Lëvizjen MJAFT. Vetë Ambasadori Gjerman në Shqipëri Z. Bernd Borchardt, në dt. 17 Tetor 2008 prezantoi filmin më të shtrenjtë në historinë e Shqipërisë bashkë me G99 e Velisë, Institutin Agenda të Milva Ekonomit të G99. Akoma nuk dihet fati i 400 mijë eurove të dhëna nga Balkan Youth Children Fundatiton për të dhënë minikredi të paligjshme në Shqipëri, fonde të cilat u morën duke shkelur hapur rregullat 3 vite më parë. Dikur ambasadori zviceran deklaroi se ai nuk do të lejonte që fondet e taksapaguesve zviceranë të përdoreshin nga MJAFT për qëllime elektorale por sot skandali Veliaj ka paraqitur faksimilet që vërtetojnë se të gjitha fondet e taksapaguesve të huaj kontrollohen nga lideri i grupimit elektoral G99.

Tashmë rreth gjysmë milioni euro janë aplikuar pranë të gjithë institucioneve ndërkombëtare për zgjedhjet 2009 nga Erion Veliaj duke mashtruar të gjithë donatorët e huaj sikur



Marrë nga faqja e internetit të G99 që implikon ambasadorin Gjerman

Drejtuesja dhe Avokatja e MJAFT dhe G99 emërohet si asistente e Kryetares së Gjykatës së Lartë

## Veliaj dhe avokatja Ferhati përpiqen të rregullojnë dokumentacionin që i nxjerr MJAFT zbuluar para donatorëve

Prej disa ditësh, drejtuesja e MJAFT dhe G99, avokatja Klotilda Ferhati (Bushka) e cila tashmë është edhe asistente Kryetares së re të Gjykatës së Lartë, Shpresa Beçaj, duke qenë në pozicionin e ri në Gjykatën e Lartë, po bën përpjekje të justifikojë dokumentacionin i cili i komprometon përpara donatorëve. Sipas burimeve brenda MJAFT dhe G99, Erion Veliaj, po bën përpjekjet maksimale që të nxjerrë një dokument nga Gjykata e Tiranës për të vërtetuar se dorëheqja e tij është bërë shumë kohë më parë se të plasë skandali në gazetën Sot. Ai nëpërmjet influencave të tij dhe asistentes së Kryetares së Gjykatës së Lartë, zonjës Klotilda Ferhati(Bushka), po kërkon të shpikin historinë sikur dorëheqja e Velisë është dorëzuar tre muaj më parë, por paska qenë Gjykata e Tiranës e cila e ka humbur.

Por, megjithë përpjekjet e Velisë për të rregulluar këtë falsifikim që ju ka bërë donatorëve, kjo është një mision i pamundur, për arsye se i gjithë dokumentacioni është i arshivuar në sistemin kompjuterik të Gjykatës së Tiranës. Ky veprim i Velisë, sikur ka humbur kërkesa e MJAFT në sekretarinë e katit të parë, është i papranueshëm edhe për faktin se Klotilda Ferhati si avokate që është duhet ta dijë shumë mirë se në se ke çuar një kërkesë për ndryshim kompetencash në gjykatë duhet që të ndjekësh afatet kohore që në asnjë rast nuk shkojnë edhe në rastin më të keq më tepër se 2 muaj (dhe që nga dorëheqja e Velisë ka kaluar mbi 1 vit).

## Ambasadori Gjerman, dëshmitar i shpërdorimit të fondeve të MJAFT nga G99

Prej disa javësh, vetë Ambasadori Gjerman në kundërshtim me ligjin shqiptar mbështeti këto ditë hapur përdorimin e parave të taksapaguesve gjermanë dhe austriakë për promovimin e G99. Siç deklarohet në faqen zyrtare të G99 (eee.g99.org), Ambasadori Gjerman bashkë me Erion Velinë dhe Remzi Lanin e Fondacionit Soros, morën pjesë në një aktivitet të G99 dhe ESI (një organizatë evropiane që mbështetet financiarisht nga kontributet e taksapaguesve europianë dhe rrjeti i fondacioneve solos në Europë) ku u prezantua filmi qesharak "The Albanian Renaissance" (Rilindja Shqiptare) ku nudisti Edi Rama, pionerwt e Enverit Erion Veliaj, Endri Fuga, Arbian Mazniku dhe ish-Spiuni i Sigurimit të Shtetit Remzi Lani me pseudonimin "Holta", paraqiten si "rilindasit e rinj" të Shqipërisë. Ky film i cili financohet me paratë e taksapaguesve europianë është një nga burimet e rrogave të shumta dhe më të larta të Erion Velisë (mbi 2000 euro / muaj) me paratë e taksapaguesve europianë. Ky film tregon se si po çlirojnë Shqipërinë tipat e çuditshëm sorosianë dhe për realizimin e këtij filmi janë harxhuar më shumë para se për çdo film tjetër me metrazh të gjatë në Qendrën Kombëtare të Filmit në Shqipëri. Skenari i përgatitur në bashkëpunim të ngushtë midis stafit gjermano-austriak dhe grupit të Veliajt ka shkelur të gjithë principet e prodhimit të filmit nga ESI ku në çdo vend të Ballkanit janë realizuar filma dokumentarë për çështje janë konfliktit të interesit të organizatorëve. Në rastin shqiptar, filmi që glorifikon Velinë, Ramën dhe spiunin Remzi Lanin si Rilindasit e Rinj të Shqipërisë, është shkruar dhe përgatitur nga vetë Erion Veliaj, Spiropali dhe Remzi Lani. Veliaj i punësuar si analist i ESI-t (organizata që ka prodhuar filmin) bashkë me Remzi Lanin dhe Spiropalin ka bërë një skenar që demonstron qartë delirin e tyre të madhështisë ndërkohë që ky film është shfaqur në kanalet televizive më të rëndësishme në Gjermani dhe Austri.

Ambasadori Gjerman bashkë me Grupimin G99 i ka vënë vulën me pjesëmarrjen dhe fjalët që ka thënë devijimit të fondeve të taksapaguesve gjermanë për qëllimet e grupimit elektoral G99.

Kjo tregon edhe njëherë implikimin e disa diplomatëve të huaj në devijimin e fondeve që burojnë nga taksapaguesit e vendeve të tyre për qëllime të paligjshme dhe jashtë destinacionit fillestar.

### Kostot administrative të G99

Grupimi elektoral G99 jo më kot u regjistrua në mënyrë hileqare në Gjykatën e Rrethit Tiranë si një OJF në 30 korrik 2008. Megjithëse një formacion i ri politik zyrat e G99 janë zyra shumë luksoze dhe me hapësira për metra katror shumë të madhe. Ambienti me qera në qendër të Tiranës ka një kosto mbi 1000 Euro në muaj dhe gjithashtu shpenzimet për korrent, internet, mirëmbajtje janë të përditshme. Mobiliet e G99 janë të cilësisë së lartë ndërsa pajisjet janë të prodhimeve më të fundit. Numërohen mbi 20 kompjuterë dhe laptopë ndërkohë që të gjitha llojet e pajisjeve kapin një vlerë mbi 40 mijë euro.

Numri i fuoristradave në dispozicion të G99 është 4. Këto automjete janë të një gjendje shumë të mirë, ndërkohë që njëra prej tyre i është dhuruar Velisë nga një institucion ndërkombëtar. Numri i personave që punojnë full time vetëm në Tiranë në G99 është mbi 12 ndërkohë që numri i deklaruar i stafit të MJAFT është mbi 40. Të gjithë full time dhe me rroga mbi 600 euro. Të gjithë telefona me kontratë dhe sasia e parave që ata shpenzojnë çdo muaj është mesatarisht 40 mijë lekë për person. Në çdo prefekturë G99 ka stafin e vet, zyrat po ngrihen çdo ditë, dhe mbulohen shpenzimet për internet, telefon me kontratë, transport, pajisje, dhe dieta ditore për lëvizjet dhe takimet që bëhen për qëllime rekrutimi të anëtarëve të ndryshëm. Një nga shpenzimet më tipike administrative të G99 është edhe kancelaritë që kanë një kosto mujore mbi 1000 euro.

### Ja shpenzimet për aktivitetet e G99

Shpenzimet për aktivitete të G99 janë të jashtëzakonshme dhe do të ishin luks për çdo parti politike përfshi edhe ato në pushtet. Në verë 2008, forumet rinore FRESSH dhe LRI, organizuan shkolla vere me një kosto 1000 L/person në ditë në kampe me çadra. Ndërkohë që kolegët e tyre të G99 prenotuan hotelin më të shtrenjtë të Himarës me pishinë brenda me një kosto normale prej 100 euro për person. Rreth 70 të rinj të rekrutuar nga G99 për të mësuar teknikat e harxhonin mbi 7000 euro. Vetem kosto e transportit të tyre kushtonte 3000 mijë euro. Ndërkohe që takimet që organizon G99 në sallat më të shtrenjta në Shqipëri kanë një kosto të jashtëzakonshme përfshi këtu edhe pajisjet fonike, videoprojektor, kamera filmime etj. Sa herë Lëvizin drejtuesit e G99 shpenzohen mbi 400 euro. Sasia dhe cilësia e shtypjes së posterëve dhe volantinave deri më tani ka kushtuar 12000 mijë euro. Ndërkohë që spotet TV dhe audio nuk pushojnë në media dhe vlera e tyre kap sot mbi 10mijë euro. Po ashtu aktivitetet ndërkombëtare dhe vizitat e shumta që bëjnë jashtë shtetit Veliaj & drejtuesit e tjerë të grupimit elektoral G99 kanë një kosto të jashtëzakonshme. Sipas të dhënave të deritanishme të shpenzuara për G99, të cilat do të saktësohen dhe do të shtohen në ditët në vijim, rezulton që deri më tani të jenë mbi çerek milioni euro. Ndërkohë që aplikimet e MJAFT për zgjedhjet janë shkruar dhe po kontrollohen nga drejtuesit e G99 Arbian Mazniku dhe Endri Fuga, Veliaj po pret ardhjen e tyre në numrat e llogarive bankare për financimin e fushatës së

Fondi i amerikanëve, kontroll gjykatave nga politikanët Rama&Veliaj

# USAID financime dhjetëra mijë dollarë lëvizjes MJAFT e cila kontrollohet nga Veliaj&Rama

Edhe amerikanët e USAID nuk ngelen pas në financimet e tyre për politikanet e kallëpit Rama&Veliaj. Tashme këta dy politikanë kanë marrë të drejtën të monitorojnë edhe gjykatat shqiptare, fakt që përbën shkelje dhe konflikt te rëndë të interesit. Ky veprim dëmton dhe rrezikon tërësisht pavarësinë e gjykatave, pavarësi e mbrojtur me devotshmëri nga ambasadori amerikan e SHBA i nderuari zoti Xhon Uithers. Prej mëse 1 muaji MJAFT merr nën kontroll edhe monitorimin e Gjykatave Shqiptare. USAID i jep MJAFT disa dhjetëra mijë dollarë për të monitoruar gjykatat shqiptare, pasi janë dhënë nga OSBE dhe institucione të tjera donatore qindra mijë euro për të monitoruar Parlamentin dhe Pushtetin Lokal. Siç dihet, MJAFT i ka instrumentalizuar këto fonde për qëllimet politike të Edi Ramës, ashtu siç ndodhi edhe dy vjet më parë kur u akuzua hapur nga Deputeti i LSI, Pëllumb Xhufi, të dhënat e te cilit ishin falsifikuar në mënyrë të qëllimtë nga Erion Veliaj sipas porosive të Edi Ramës. Dy vjet më parë, Pëllumb Xhufi e akuzoi Lëvizjen MJAF të Erion Velisë si një organizatë me strukturë masonike e cila i vinte gjoba politikanëve shqiptarë për qëllime të errëta politike. Ne atë kohë, Veliaj & Co falsifikuan të dhënat e deputetit Pëllumb Xhufi duke i shpërndarë në anglisht në shumë raportimeve ndërkombëtare me qëllim për të "gjobitur" kundërshtaret potencialë të Ramës dhe interesave sorosiane në Shqipëri. Po atë vit, nëpërmjet një shou te improvizuar, u akuzua edhe konkurrenti i Ramës në PS, Ben Blushi si njeri i dhunshëm. Paratë e taksapaguesve të huaj përdoren vazhdimisht jashtë destinacionit të tyre për qellimet e ndyra të politikës shqiptare. Pra fondet amerikane shërbejnë më së miri për të vënë në funksionim një mekanizëm shpifarak si lëvizja MJAFT, e drejtuar nga aventurierë dhe demagogë të klasit ndërkombëtar. Themi ndërkombëtar, pasi ky njeri ka qenë në gjendje tu "hedhë trutë e gomarit", të gjitha përfaqësive ndërkombëtare në Shqipëri.

Monitorimi i ri i gjykatave në Shqipëri, me fondet dhe kontributet e taksapaguesve amerikanë, është një precedent i rrezikshëm në Shqipëri, pasi tashmë Edi Rama kërkon të kontrollojë edhe Gjykatat Shqiptare, për të ushtruar presion, duke gjobitur gjykatësit sipas interesave të politikes së ditës. Tashmë sa herë që të rrezikohen interesat e politike të Edi Ramës apo të G99 dhe MJAFT (e cila ka boll probleme të veta me regjistrimet juridike në Gjykatën e Tiranës), protestuesit me pagesë të MJAFT do të dalin tek dera e Gjykates dhe në ekranet e blera televizive, për të akuzuar gjykatës të ndryshëm që s'do të plotësojnë orekset politike të Ramës dheVelisë.

Precedentët e rrezikshëm të goditjes se armiqve të Edi Ramës në Parlamentin Shqiptar, tani do të zhvendosen edhe në Gjykatat Shqiptare. Tashmë siç kanë deklaruar Kristi Pinderi dhe Elton Kacidhja, dy drejtuesit e Lëvizjes MJAFT (Revista MAPO pronë e dy drejtuesve të G99 Arbian Maznikut dhe Endri Fugës), tashmë i "Gjithë shteti nën sytë e "Mjaft".

"Ky është modeli i qeverisjes tek i cili Lëvizja MJAFT beson dhe që qytetarët shqiptarë meritojnë. Pikërisht këtij modeli iu referuam, ne fillim, kur nisëm punën për monitorimin e legjislativit", thotë Kacidhja. (Revista MAPO).

*Vijon*




Marrë nga faqja online, Unevotoj.com/ gjykatat

## Ambasada gjermane, financime për politikanët dhe spiunët e sigurimit

Fondet për forcimin e shoqërisë civile në Shqipëri nga donatorët e huaj, duket se nuk shkojnë në destinacionin e përcaktuar. Tashmë diplomacia e huaj dhe qarqe të caktuara ndërkombëtare, duan që modelin e shoqërisë civile ta paraqesin ashtu si e mendojnë ata. Hipokrite, hajdute, te pamoralshme dhe gënjeshtare. Pikërisht në ditet e sotme, diplomacia dhe qarqet e caktuara që përmendëm më sipër, e kanë formatuar modelin se kush do të jetë shoqëria civile në Shqipëri. Diplomatet gjermanë janë ndër kontribuuesit kryesorë të përcaktimit të këtij modeli. Filmi i financuar nga gjermanët dhe i promovuar nga vetë ata, ku Erion Veliaj, Remzi Lani dhe politikani Edi Rama lançohen si rilindësit e shoqërisë shqiptare përbën skandalin e shekullit, ku diplomacia e një shteti ndërhyn në mënyrë skandaloze për të përcaktuar jo vetëm modelet e shoqërisë civile, por dhe modelet e politikës. Filmi dokumentar i financuar nga ambasada gjermane dhe taksapaguesit gjermanë jo vetëm që nuk lançon shoqërinë civile shqiptare por i bën publicitet dy politikanëve, Erion Veliaj dhe Edi Rama. Nga përcaktimi i fondeve për levizjen MJAFT, del qartë që këto para të taksapaguesve gjermanë te destinuara për qytetarët shqiptarë, janë dhënë për grupimin elektoral G99 dhe PS, ku respektivisht janë kryetarë Veliaj dhe Rama. Hiq modelin e spiunit Remzi, i cili për gjermanët është modeli i rilindësit për arsye se futi në burg mësuesin e tij Dodë Bajraktarin se mbante biblën, të dy politikanët e sipërpërmendur nuk janë pjesë e shoqërisë civile por janë pjesë e politikës shqiptare. Këtu diplomatët gjermanë kanë shkelur me të dyja këmbët ligjin e shtetit shqiptar për "Financimin e Partive Politike". Përveç që kanë shkelur dhe ligjin e tyre për spiunët e STASSIT komunist të Honekerit.

Prej 2 vjetësh nuk dihet se ku kanë përfunduar këto para

## Zhduken një milion euro të Qeverisë Gjermane për OJF e Shqipërisë

Projekti "Forcimi i Shoqërisë Civile dhe Përmirësimi i Strukturave Demokratike", projekt i financuar nga Qeveria Gjermane me paratë e taksapaguesve gjermanë, synoi prej 2 vjetësh të forconte shoqërinë civile dhe të rriste rolin demokratik të saj. Megjithëse kanë kaluar dy vjet dhe projekti përfundon vitin që vjen, asnjë organizatë nuk ka idenë e ekzistencës së këtij projekti. Ky projekt drejtohet nga organizata gjermane GOPA e cila është implementuese e GTZ dhe zyrat i ka pranë Ambasadës Gjermane në Tiranë. Një milion euro janë investuar nga paratë e taksapaguesve gjermanë dhe OJF e kontaktuara sot me telefon nga gazeta Sot, nuk kanë asnjë dijeni për ekzistencën e tij dhe për më tepër janë habitur kur kanë marrë vesh se ky projekt ka vënë në dispozicion të shoqërisë civile rreth 1 milionë euro.

Një nga objektivat e këtij projekti ka qenë edhe mbështetja e qeverisë shqiptare për ti vënë në dispozicion të shoqërisë civile rreth 1.2 milionë euro për OJF, shifër e premtuar kjo edhe nga Qeveria Shqiptare.

Por si është e vërteta dhe pse OJF shqiptare nuk kanë asnjë dijeni për këtë shumë apo projekt?

Dy vjet më parë, Ministria e Jashtme e Gjermanisë ofroi mbi 1 milion Euro me synimin për të forcuar rrjetin e OJF në Shqipëri. Ky fond u caktua si pasojë e dobësimit të shoqërisë civile, per hir të thithjes së të gjithë fondeve nga një rrjet i vogel i OJF të krijuara nga Soros në Shqipëri me në figurën emblematike të Erion Velisë. Siç ndodh gjithmonë në sektorin e OJF, të rrjetit Soros ushtroi të gjithë influencat e veta që Drejtore e këtij projekti të ishte Drejtoresha e Soros në Shqipëri, Valdete Sala, një ndër themelueset dhe




mbështetëset kryesore të Lëvizjes MJAFT dhe lançuesja e vërtetë e yllit sorosian të shoqërisë civile Erion Veliaj. Valdetja njihet në të gjithë rrethet e shoqërisë civile si personi që solli Erion Velinë nga SHBA dhe i ofroi mbeshtetjen per financimin e parë të Fushatës MJAFT në Mars 2003. Valdete Sala e cila është themeluese Fondacionit Soros në Shqipëri dhe njeriu që e lidhi që në 1992 Edi Ramën me fondacionin Soros, prej vitesh ka qenë konsulentja kryesore e Ambasadës Hollandeze, e cila ka hedhur dhjetra milione euro në Shqipëri për interesat e saj. Valdete Sala në fund të 2005 hoqi dorë nga të qënit Drejtore e Soros Shqipëri dhe aplikoi për t'u bërë Drejtore e Programit 1 milion Euro të Qeverisë Gjermane për Shqipërinë. Për t'ia arritur këtij qëllimi, në vitin 2006, një ndër organizatat e saj të shumta (ajo drejton disa organizata në konflikt të pastër interesi me pozicionin e Drejtorit të një Donatori) me emrin Co-Plan, Kryetare e Bordit të së cilës ka qenë vetë Valdete Sala, e nominoi këte fundit me cmimin e lidershipit të shoqërisë civile, për kontribut të shquar në dhënien e parave të Soros, aty ku ajo ka dashur gjatë 14 viteve në detyrë. Çmimin që mori Valdete Sala në 2006 e mori një vit më vonë edhe ish-spiuni i Sigurimit Remzi Lani. Me këto skema të çmimeve të shoqërisë civile, drejtoresha dhe themeluesja e Soros dhe MJAFT, u emërua edhe Drejtore e 1 milion eurotë taksapaguesve gjermanë. Ndërkohë prej 2 vjetësh këto fonde nuk i janë ofruar asnjëherë shoqërisë civile, për vetë faktin që OJF te ngelen në krizë dhe uri financimesh me qëllimin që të kete vetëm një organizatë dhe një lider, Erion Veliaj. Ky i fundit është miku i ngushtë i Valdete Salës, e cila njihet gjithashtu edhe si njeriu më i afërt i Edi Ramës.

Djali i Valdete Salës është edhe përfaqësuesi i firmës belgo-hollandeze e cila nëpërmjet konkurseve të trukuara iu dha e drejta nga Edi Rama për të betonizuar sheshin Skënderbej. Një nga detyrat më kryesore që pati Valdete Sala me fondet e Qeverisë Gjermane ishte edhe të asistonte Qeverinë Shqiptare e cila kishte vendosur ti jepte 1.2 milionë euro OJF ve Shqiptare që ne fillim të vitit 2008. Por Qeveria Shqiptare nuk arriti dot ta lëvronte këtë shumë sepse Drejtoresha sorosiane e fondeve të qeverisë gjermane nuk ofroi mbështetjen e mjaftueshme. Keshtu OJF shqiptare i mungojnë 2.2 milionë euro si pasojë e dështimit të dy programeve të qeverisë gjermane dhe qeverisë shqiptare që duhej ti asistonte Valdete Sala!

5 MJAFTËT e Velisë si një vrimë e zezë e kontributeve të taksapaguesve të huaj

# G99 kontrollon 5 vula OJF dhe 14 numra bankarë të shoqërisë civile në sytë e ambasadorëve

Sasia e parave që MJAFT ka marrë nga donatorët ndërkombëtarë ësh që e paqartë, sepse mungojnë të dhënat normale që çdo organizatë apo rrjet organizatash që kanë gëlltitur mbi 5.4 milionë Euro duhej t'i kishte publikuar të paktën online apo në raporte të rregullta publike. Dihet tashmë se, që në themelimin e vet, Lëvizja MJAFT e përfaqësuar ligjërisht si një qendër me tre anëtarë por që në fakt është e përbërë nga 5 organizata: Shoqata Kombëtare Shqiptare e Debatit - "ANDA" (Spinoff i Soros 1999), Ballkan Youth Link - Albania "BYL-A"(e famshme për ritualin e përvitshëm të meshkujve që vishen si femra), Qendra MJAFT (Vulën e të cilës dhe llogaritë përkatëse bankare i kontrollon Erion Veliaj), Fondacioni MJAFT (që operon prej 4 vjetësh në mënyrë të paligjshme), si dhe Instituti i famshem AGENDA (i krijuar si spinoff i Soros, qendër e reklamuar në media nga Veliaj si organizatë e krijuar nga MJAFT). Këto 5 organizata kanë si drejtues të gjitha njëkohësisht të njëjtin grup njerëzish të G99: Erion Velia, Arbian Mazniku, Marinela Lika, Endri Fuga, Milva Ekonomi dhe Klotilda Ferhati (Bushka). Ky grup njerëzish janë njëkohësisht në të gjitha strukturat duke krijuar një rrjet monstruoz që nëpërmjet emrave të ndryshme thithin të gjitha fondet e shoqërisë civile për çdo lloj fushe duke u bërë si një vrimë e zezë e të gjithë ndihmave që vijnë për shoqërinë civile në Shqipëri.

Duke u kombinuar në borde kryetarësh dhe drejtorësh në organizatat që kanë krijuar nëpërmjet avokates Klotilda Ferhati (Bushka) dhe nën orientimin e përfaqësuesve të Soros në Shqipëri, këto 5 organizata kombinojnë duke luajtur me emrat e njëra tjetrës dhe duke çorientuar çdo auditim pasi përdorin 5 libra financiarë të ndryshëm dhe deri më sot numërohen mbi 14 numra bankar të hapur vetëm në Tiranë. Kjo lojë e logove të ndryshme për të hutuar çdo lloj kontrolli financiar pasi nuk merret asnjëherë vesh se ku përfundon Qendra MJAFT dhe ku vazhdon Fondacioni MJAFT, ku mbaron Fondacioni MJAFT dhe ku vazhdon ANDA, ku mbaron ANDA dhe ku vazhdon BYL-A, dhe asnjëherë s'merret vesh se ku fillon dhe përfundon Instituti AGENDA. Ajo që dihet me siguri në këtë lojë kukamçefti me paratë e taksapaguesve të huaj, është që gjithmonë në Bankë kontrollon ekipi drejtues sorosian i G99: Erion Veliaj, Milva Ekonomi, Arbian Mazniku, Endri Fuga, dhe Marinela Lika.

Këta 5 persona që kanë kontrolluar dhe kontrollojnë sipas urdhrave të Soros Albania mbi 5.4 milione euro në llogaritë bankare brenda Shqipërisë, kanë krijuar precedentin më të rrezikshëm dhe pse jo edhe më inteligjent të fshehjes nga sytë e publikut të shumave reale që i kanë ushqyer numrat e tyre bankare. Në fakt shuma e dokumentuar deri më tani është më e madhe por do të jepet më e identifikuar në ditët në vazhdim sepse Instituti i Agenda ka krijuar një farë pavarësie nga Erion Veliaj pasi Milva Ekonomi është ca më e vjetër dhe më profesioniste në realizimin e objektivave të Soros në Shqipëri.

Problemi i lojërave të financimeve të ndarë në 5 gishta te së njëjtës dorë (ashtu siç është edhe logoja e MJAFT), mund të jetë larg vëmendjes së publikut por kjo s'mund të thuhet për të gjithë donatorët. Se si funksionon magjia sorosiane e 5 drejtuesve të G99 mund të jetë e paqartë për publikun sepse nuk ka informacion por kjo smund të thuhet për asnjë donator të familjarizuar me realitetin shqiptar pasi siç dihet, çdo donator kur të ofron një shumë të caktuar është i detyruar që të kontrollojë fillimisht dokumentet e regjistrimit juridik në Gjykatë, dhe të shohë se kush është përfaqësues ligjor i organizatës. Në fakt nëse një donator sheh emrin e Endri Fugës edhe tek Qendra MJAFT, edhe te Fondacioni MJAFT, edhe te ANDA, edhe te BYL-A, edhe te AGENDA, atëherë ai e kupton se këtu diçka nuk shkon. Por kur sheh se sa miliona euro të taksapaguesve të huaj gelltisin këta 5 drejtues të G99 të dorës MJAFT, atëherë indiferenca e donatorit nuk është më indiferencë por implikim. Implikim që kanë lejuar këtë lojë të shëmtuar e cila dukshëm dhe në kundërshtim të hapur me legjislacionin shqiptar ka sjellë abuzime të rënda me para që iu sollën Shqipërisë për ta ndihmuar në rrugën e demokracise. Dhe implikimi i ambasadorëve nuk ka qenë pasiv. Janë ata që kanë pranuar të promovojnë këtë lojë rrotullimesh të emrave të organizatave që ç'organizojnë llogarimbajtjen financiare siç është rasti i denoncuar dje në Gazetën Sot kur Ambasadori Gjerman shfaqet në promovimin e lidershipit të ri politik të G99 herë me një ftesë që prodhohet nga G99, herë me një deklaratë për shtyp të Qendrës MJAFT, dhe herë me një baner që shfaqet me logon e Institutit AGENDA! Këto tre imazhe alternohen, një herë njëra dhe njëherë tjetra, si një lojë letrash dhe asnjëherë nuk merret vesh se kush e bën dhe kush e financon aktivitetin! Sepse këto imazhe që zëvendësojnë në të njëjtën ditë aktivitetin ku herë i del për zot aktivitetit njëra organizatë dhe herë tjetra, me logon e qeverisë gjermane në prani të vetë Ambasadorit Gjerman, i shërbejnë organizatave për të justifikuar fondet që marrin. Filmi i financuar nga taksapaguesit gjermanë dhe austriakë i denoncuar dje në Gazetën Sot, që glorifikonte si rilindas të rinj të Shqipërisë sorosianët që drejtojnë Grupimin Elektoral G99, produksioni i të cilit u përgatit bashkërisht me ndihmën e rrogëtarit të projektit Erion Velia, si dhe me ndihmën e Remzi Lanit dhe Elisa Spiropalit, u shfaq duke manipuluar autorësinë e aktivitetit nga tre organizata gjoja të ndryshme.

Përse ka ndodhur kjo?

Sepse kështu, duke nxjerrë një herë MJAFT, një herë G99 dhe një herë Agendën, askush nuk është në gjendje të kontrollojë burimet e këtij aktiviteti dhe njëkohësisht t'i japë përgjigje se kush e bën në të vërtetë. I vetmi që mund ta dijë në këtë rast është Ambasadori Gjerman në Tiranë i cili ka qenë prezent në sallë dhe ka lavdëruar liderët e rinj sorosianë të G99!

Dhe meqë jemi në rastin e Ambasadorit Gjerman, e njëjta histori ka ndodhur edhe një vit më parë kur Veliaj lëvizte në Bankë disa dhjetëra mijëra euro nga Ambasada Gjermane për të financuar një udhëtim turistik të të rinjve shqiptarë të shkëlqyer me mësime ndërmjet të cilëve figuronin shumë mjaftistë që shpërbleheshin për mungesat që kishin bërë në shkollë prej kohës që harxhonin në zyrat dhe aktivitetet e MJAFT.

Kurrë nuk u mor vesh kush i kontrollonte paratë në Bankë: Fondacioni MJAFT, Qendra MJAFT, Lëvizja Europiane (që përfaqësohej nga Veliaj) apo BYL-A e përfaqësuar përsëri nga Veliaj, apo të treja bashkë njëohësisht.

Kjo praktikë ka ndodhur vazhdimisht me Fondacionin Soros, ku delikatesa diplomatike ia lente vendin vrazhdësisë tipike sorosiane. Këtu Arbian Mazniku dhe Endri Fuga si Kryetarë Bordesh të Soros për Rininë (me emrat e çuditshëm Bordi Rinor dhe Bordi i Iniciativës Rinore të Europës Juglindore) miratonin projektet e tyre duke luajtur pikërisht me disa emra organizatash njëkohësisht.

Kjo lojë shumë e suksesshme financiarisht vazhdon prej vitesh dhe sot nuk është vetëm vula dhe numrat bankar të MJAFT që kontrollon kjo dorë nëntëdhjetenëntëshe por janë edhe numrat e llogarive bankare të Fondacionit MJAFT i cili ka lëvizur me qindra mijë euro (deri më tani na rezultojnë të dhënat për 800 mijë euro), të BYL-A dhe ANDA. Drejtuesit e G99 kanë kontroll mbi miliona euro të shoqërisë civile shqiptare në sistemin bankar si brenda vendit ashtu edhe jashtë tij. Pesë drejtuesit kryesorë të G99 kanë 5 vula dhe mbi 14 llogari bankare të destinuara për shoqërinë civile në Shqipëri.

*Nesër vijon...*

**Ja se si hollandezët kanë sponsorizuar dhe mbështetur politikanin Veliaj me fondet e caktuara për shoqërinë civile në Shqipëri**



I njëjti aktivitet prezantohet në emër të Insitutit të AGENDA



Kjo faqe online (në www.g99.org) u hoq gjatë natës nga Erion Veliaj

I njëjti aktivitet prezantohet në emër të G99

Paratë e Holandezëve për shoqërinë civile shqiptare përfundojnë në aksionet politike të Edi Ramës

# Holandezët, mbi 2 miliardë lekë shoqërisë civile të Erion Velisë për ta futur në politikë

Është një fakt i panjohur publik pse Ambasada Holandeze është donatori kryesor i Velisë! Ka pasur shumë hamendje duke aluduar që nga homoseksualiteti i njohur i diplomatëve holandezë, lidhje personale të drejtuesve të MJAFT me diplomatët, interesa holandeze në Shqipëri, etj. Në fakt elementi më i fortë që ka përcaktuar motivet e mbështetjes holandeze për Erion Velinë, është një fakt që është fshehur me kujdes në Shqipëri sidomos me mbështetjen e strukturave të Soros.

Në 2003 kur u shpall për herë të parë fushata MJAFT (15 Mars 2003) Erion Veliaj & Co u fshehën duke rreshtuar mbi 70 organizata joqeveritare si organizatorë për të fshehur absurditetin e 350 mijë eurove të marra me një dorë të kuqe nga dy shoqata krejtësisht minore që i kishte krijuar Fondacioni Soros që në 1999 - 2000. Këto dy organizata rinore drejtoheshin që në atë kohë nga Erion Veliaj, Arbian Mazniku, Endri Fuga dhe Klotilda Ferhati nën supervizimin e kujdesshëm të themeleuses së Soros Shqipëri Valdete Sala. Në vitin 6 Janar 2002 kur u prezantua për herë të parë projekti i fushatës MJAFT u kuptua që asnjë donator nuk mund të mbështeste një absurditet të tillë dhe kaq pa reputacion nisur edhe nga fakti që pas këtij projekti ishte vetë Fondacioni Soros Tiranë. Kjo solli nevojën e "përpunimit" 12 mujor të donatorëve nën asistencën e plotë të të gjithë strukturave Soros në Tiranë të cilat ftuan Erion Velinë në 2002 për t'a prezantuar me komunitetin Ndërkombëtar në aktivitetin e bujshëm YLLI 2002, aktivitet i famshëm sot e kësaj dite për ritualin e veshjes së meshkujve si femra, fotot e të cilit përbënë një skandal të madh mediatik në shkurt 2006. Për këtë qëllim, në Shtator 2002, u prodhua një material promocional i Erion Velisë në një CD prezantuese në të cilin aplikantët për fonde për fushatën MJAFT ishin veshur si femra! Pas disa muajsh Ambasada Hollandeze dha grantin e parë prej 300 milionë lekësh që duhej të shpenzoheshin me urgjencë brenda 4 muajsh sepse duhej të fillonte derdhja e miliona eurove për djemtë e veshur si femra akt që Ambasada Hollandeze e vlerësonte si një akt të lartë qytetarie dhe civilizimi. Këto para ishin pjesë e kontributeve të taksapaguesve hollandezë për të ndihmuar shoqërinë civile në Shqipëri.

Që nga viti 2003 deri në 2008, Veliaj me shokët që vishen si femra, kanë thithur aq shumë fonde nga Ambasada Hollandeze sa gjithë organizatat rinore shqiptare për 18 vjet.

Direkt pas shpenzimit me urgjencë të 300 milionë lekëve të para, Veliaj filloi çdo muaj të merrte dhjetëra milionë lekë nga holandezët e Tiranës dhe ata të Hollandës. Vazhdimisht logoja e Mbretërisë Holandeze ka zbukuruar deklaratat për shtyp dhe faqet online të 5 MJAFT të Velisë: 1. Shoqata Kombëtare Shqiptare e Debatit - "ANDA", 2. Ballkan Youth Link - Albania "BYL-A", 3. Qëndra MJAFT, 4. Fondacioni MJAFT, si dhe Instituti i famshëm AGENDA. Dihet se këto 5 organizata kanë si drejtues të gjitha njëkohësisht të njëjtin grup njerëzish të G99: Erion Velia, Arbian Mazniku, Marinela Lika, Endri Fuga, Milva Ekonomi dhe Klotilda Ferhati (Bushka).

Tashmë shifra e Velisë e përfituar vetëm nga kontributet e taksapaguesve hollandezë të destinuara për shoqatat shqiptare, kap shifrën e mbi 2 miliardë lekëve. Çdo organizatë që ka guxuar të shkelë për të aplikuar pranë Ambasadës Holandeze ka gjetur gjithmonë të njëjtën përgjigje nga anëtarja e shoqatës që themeloi MJAFT, Elga Mitro e cila është edhe Asistente e Programit të Ambasadës Holandeze për OJFtë: "Ambasada nuk mund t'Ju mbështesë pasi granti për këtë qëllim i është dhënë Lëvizjes MJAFT prandaj Ju mund të shkoni në zyrat e tyre dhe të bashkëpunoni me ta". Në fakt MJAFT nuk ka lënë "qëllim" dhe "objektiv" të Ambasadës pa realizuar duke e kthyer konkurrimin për fonde në një histori të pamundur pasi konkurrimi ndodhte brenda dyerve të mbyllura të ambasadës në prezencë vetëm të një pale.

Në 2003, pa u raportuar ende të gjitha faturat e 300 milionë lekëve të para edhe dhjetëra miliona të tjera për karvanin e turizmit që MJAFT organizoi për zgjedhje në Shqipëri, ndërkohë që në 2004, mbi 100 milionë lekë të tjera hynë në llogaritë bankare të Velisë. Në 2005 mbi 500 milionë Lekë nga Hollanda u deshën përsëri në numrat Bankar të Velisë. Në 2006, në kohën kur plasi skandali i fotove të travestitizmit të MJAFT, shoqëruar edhe nga deklaratat e protestës së Velisë ndaj Policisë për arrestimin e 3 travestitëve prostituta, Ambasada Holandeze vendosi të derdhte shumën rekord në llogaritë e kontrolluara të Grantit prej 1 miliardë e 250 milionë lekëve për të mbështetur tashmë edhe kalimin e MJAFT direkt në zgjedhje. Tashmë Veliaj nuk kishte më nevojë të çonte një plan aktivitetesh për miratim pranë donatorit, pasi shuma e re kishte kartabiankë të lirisë së Erionit për të vendosur vetë se çfarë do të bënte me ato para! Tashmë Veliaj e kishte edhe kapitalin fillestar për t'u hedhur në politikë! Mbi 2 miliardë lekë të hedhura në 5 vjet vetëm nga Mbretëria e Holandës nga fondet e taksapaguesve holandezë për shoqërinë civile shqiptare për promovimin e imazhit të Velisë dhe të shokëve të tij që pozojnë të veshur si femra në CD prezantuese të projekteve!





| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 622 | [illegible] | [illegible] | [illegible] | GRANT | | EUR | [illegible] | [illegible] | [illegible] | [illegible] |
| 623 | [illegible] | Local Governance Programme | Provides support in strengthening the process of decentralization and democratization of local governance | GRANT | 1 | USD | [illegible] | [illegible] | [illegible] | 0 |
| 624 | Netherlands | Project preparation and [illegible] | [illegible] Action Plan [illegible] | GRANT | 1 | USD | [illegible] | [illegible] | 0 | [illegible] |
| 625 | Netherlands | Strengthening capacities in the Western Balkans | [illegible] | GRANT | 1 | USD | [illegible] | [illegible] | [illegible] | [illegible] |
| 626 | NETHERLANDS | Support Project (Phase II) | builds on the accomplishments achieved by the [illegible] in its first phase of support to the Albanian | GRANT | | EUR | | | | |
| 627 | Netherlands | Strengthening Public Expenditure Management | Strengthening Public Finance management/MTBF | GRANT | [illegible] | EUR | [illegible] | [illegible] | [illegible] | [illegible] |
| 628 | Netherlands | Institutional Support to MJAFT | Strengthening institution building MJAFT organization | GRANT | 50 | EUR | [illegible] | [illegible] | [illegible] | [illegible] |
| 629 | Netherlands | [illegible] | [illegible] planning | GRANT | 30 | EUR | [illegible] | [illegible] | [illegible] | [illegible] |
| 630 | Netherlands | small grants programme [illegible] | various projects | GRANT | | EUR | [illegible] | | [illegible] | [illegible] |
| 631 | Netherlands | Parliamentary Support I | Strengthening Albanian Parliament in alliance with OSCE | GRANT | [illegible] | EUR | [illegible] | [illegible] | [illegible] | [illegible] |
| 632 | Netherlands | Good Governance projects | various projects | GRANT | | EUR | [illegible] | [illegible] | | [illegible] |

**Një nga pyetjet më të shumta që ngrihet nga shoqëria civile në Shqipëri është se pse Veliaj u mbështet kaq shumë nga holandezët?**

Në fakt kjo përgjigje që do të shtjellohet më gjerë në numrat në vazhdim të gazetës Sot, përbën një skandal real jo vetëm për Shqipërinë por në radhë të parë për vetë Holandën. Sepse këto fonde që burojnë nga taksapaguesit holandez nuk ju dhanë thjesht Erion Velisë, por në radhë të parë Fondacionit Soros në Tiranë i cili edhe e prodhoi Velinë! Fondacioni Soros është në të vërtetë "pronari" i ligjshëm i MJAFTËVE pasi vetë Lëvizja MJAFT është ngritur mbi shtratin e ANDA e cila është themeluar si spinoff i Soros në Shqipëri që në vitin 2000. MJAFT është një instrument i Fondacionit Soros për të shkretuar shoqërinë civile dhe për të tharë dhe përfituar fondet e ambasadave të huaja në Tiranë dhe e gjitha kjo si pjesë e kapjes së shoqërisë civile në Shqipëri si pjesë e planit për kapjen e gjithë shtetit nga Oktapodi Sorosian.

Pyetja që shtrohet përsëri është, pse shoqërisë civile shqiptare iu hoqën 2 miliardët e destinuara për ta nga taksapaguesit holandezë për tiu dhënë një strukture të Soros në Shqipëri?

*Hollanda është një Mbretëri, dhe çdo mbretëri ka një familje mbretërore. Dhe familja Mbretërore holandeze ka një Princeshë. Dhe kjo Princeshë është Drejtoresha Ndërkombëtare e Fondacionit Soros për të gjithë Europën:* ***Princess Mabel of Orange-Nassau, Mrs. Van Amsberg (emri i vërtetë i të cilës është Mabel Martine Eisse Smit)***

Në numrat e ardhshëm do të lexoni se si kjo Princeshë ka ndikuar që fondet e taksapaguesve holandezë të financojnë zyrat e miliarderit Soros në Shqipëri dhe se si këta njerëz po ndihmojnë Ramën të kapë shtetin, se si fondacioni Soros është i përfshirë në planet e Ramës për të betonizuar Tiranën, dhe se si struktura ndërkombëtare janë të përfshirë në afera të pista në politikën shqiptare.

Këshilltarët e Edi Ramës, biznesmenë qindramilionësh

# Partnerët e Velisë, Endri Fuga dhe Arbian Mazniku 111 milionë lekë biznes në kompaninë ALBANIAN COMMUNICATION GROUP sh.p.k

Gazeta SOT ka disa ditë që ka marrë përsipër botimin e një dosieri për aferat e qendrës MJAFT. Kjo qendër është krijuar nga një grupim njerëzish, të cilët të katapultuar nga qarqe të caktuara jashtë Shqipërisë, kanë ideuar dhe organizuar një lëvizje që kërkon të largojë politikën e vjetër. Pa i paragjykuar për idetë e tyre brilante, gjithsecili nga ne ka pasur të drejtë të mrekullohet nga ky shembull i këtij grupimi djemsh të rinj që kanë qëllime kaq fisnike për të ardhmen e Shqipërisë. Në fund të fundit të gjithë shqiptarët këtë ëndërr kanë, një Shqipëri me standarde dhe ndryshe nga ato që kemi parë këto tetëmbëdhjetë vjet tranzicion. Por, pas kaq kohë aktiviteti të kësaj lëvizje shikojmë se drejtuesit kryesorë si Erion Veliaj, Arbjan Mazniku dhe Endri Fuga gjenden papritur të pasuruar dhe me kapitale për të nisur biznese. Nga njerëz idealistë dhe të vendosur për ndryshimin e politikës, kemi të bëjmë me një grupim njerëzish që me fonde të destinuara për shoqërinë civile shqiptare, kanë rregulluar mirëqenien e tyre. Erion Veliaj këto ditë na është shfaqur si armiku më i madh i biznesmenëve, duke lëshuar deklarata populiste, na del i implikuar me fonde të dhuruara nga ndërkombëtarët, të cilat i kalojnë 6 deri në 7 milionë euro. Si për çudi vëllai i Erion Velisë, Arbër Veliaj, na del me biznes kozmetike, me numër nipti K81206040B, i regjistruar në zyrën e tatimeve në datën 06.03.2008, ndërkohë që ortakët e Erionit na dalin me biznes të madh pas disa vitesh punë në organizatën MJAFT, punë që presupozon një rrogë normale. Pikërisht dy partnerët e Erion Velisë, Arbjan Mazniku dhe Endri Fuga, zotërojnë aktualisht kompaninë ALBANIAN COMMUNICATION GROUP sh.p.k me numer Nipti K62225006P, kompani e cila ka filluar aktivitetin e saj me 111 milionë lekë të vjetra. Të dy drejtuesit e rëndësishëm të MJAFT dhe G99, kanë krijuar këtë biznes me kapitalin themeltar 111 milionë lekë të ndarë sipas përqindjeve, ku zoti Mazniku Arbian ka 30 përqind të aksioneve dhe ka financuar 33.3 milionë lekë, ndërkohë që Endri Fuga zotëron 70 përqind të aksioneve me vlerë 77.5 milionë lekë. Kjo shumë është derdhur në 25 qershor të vitit 2008 nga të dy ortakët si shtesë kapitali për kompaninë ALBANIAN COMMUNICATION GROUP sh.p.k. tashmë drejtuesit e MJAFT zotërojnë kompaninë e mësipërme në përqindjet që thamë më lart dhe kanë filluar një biznes në kushte shumë të favorshme me shumën 111 milionë lekë të vjetra. Në fakt, personazhi Veliaj të cilin e kanë quajtur "Lejfen", në fakt nuk mbledh gozhdë dhe bullona nëpër rrugë por paska aq para sa të hapë revista dhe firma kaq të fuqishme me ortakët e tij në lëvizjen MJAFT. Veliaj, i cili këto ditë e ka paraqitur veten si një personazh që lufton biznesmenët me një zhargon fyes, të kujton ata djemtë e vegjël të organizatave anarkiste marksiste-leniniste që i shpallnin luftë kapitalit duke kërcënuar biznesin si gjakpirës të masave. Ky populist dhe mashtrues i vogël është bërë biznesmen duke abuzuar me paratë e donacioneve të ndryshme. Gjuha mashtruese e Velisë, duket se nuk ka futur velenin për biznesmenët e organizatës së tij patriotike MJAFT, apo të G99. Erion Veliaj është modeli i politikanit të futur në politikë me para dhe me biznese të pista, pa provuar një ditë punë në jetën e tij. G99 dhe MJAFT, janë sot organizatat më pak transparente në Shqipëri, janë organizata të cilat kanë qarkulluara para taksapaguesish të huaj dhe shqiptarë, duke fshehur izoluar çdo të dhënë mbi fondet e financimit të formacioneve të tyre. Megjithëse Veliaj deklaron se ka dymijë anëtarë që kanë dhuruar lekë duhet t'i deklarojë se kush janë këta njerëz që po mbajnë një parti me kosto skandaloze shpenzimesh. Biznesmeni Veliaj i cili ka deklaruar këto ditë varfërinë e tij, nuk mund të fshehë as firmën e vëllait të tij të shitjes së kozmetikëve dhe as kompaninë e ortakëve të tij Mazniku dhe Fuga. Gjuha e Lejfenit modern, Veliaj, përveçse është gjuhë rudimentare dhe e lodhur nga panic e shumta që ka kryer me të, nuk është në gjendje të na sqarojë asnjë nga akuzat e hedhura këto ditë në tregun mediatik. Veliaj ka për detyrë para shqiptarëve të tregojë se kush janë fondet që financon partinë e tij politike dhe të heqë dorë nga mashtrimet publike sipas të cilave ka hequr dorë para shqiptarëve. Në ditët në vazhdim gazeta SOT do të publikojë se si qëndron e vërteta e kompanisë se ortakëve të Velisë dhe kush janë ambasadat që përkrahin Lejfenin e vogël që në vend të gozhdëve na mbledh para.


II KAPITALET E VETA DHE KAPITALI THEMELTAR
KONKLUZION
EKSPERT KONTABEL I AUTORIZUAR
"K&L"
TIRANE ALBANIA

3 bizneset e 3 politikanëve të Rinj të G99, modeli i Politikës së Re

# Erion Veliaj, biznese fiktive për të mbushur fatura justifikuese për MJAFT

Erion Veliaj që përbetohet në media si politikan që distancohet nga biznesi, duke mbajtur poza dhe duke lëvizur buzët si top modele e bukur para fotografëve, është një ndër biznesmenët më të rinj të Shqipërisë. Prej vitesh MJAFT faturon milionla lekë duke mbushur librat financiarë me faturat e bizneseve që vetë kanë krijuar ai me politikanët e rinj të MJAFT. Që në mars të vitit 2003, kur Ambasada Hollandeze, Fondacioni Soros dhe disa donatorë të tjerë i vunë para detyrimit që të shpenzonin me urgjencë brenda 4 muajve mbi 400 milionë lekë, Erion Veliaj dhe Arbian Mazniku, regjistruan nëpërmjet Denis Behlulit një biznes në Gjykatën e Tiranës me emrin e çuditshëm CP&R. Denis Behluli, miku i ngushtë i Velias dhe Maznikut që në shkollë të mesme kur shkonin në kishën baptiste në Tiranë, (vëllai shpirtëror i Arbian Maznikut) ishte njeriu i besuar i dyshes Veliaj - Mazniku. Ky Biznes që u regjistrua në Gjykatë në të njëjtën kohë me fillimin e Fushatës MJAFT në 15 Mars 2003, faturoi në mënyrë fiktive qindra miliona lekë të Velisë dhe Manzikut, ndërkohë që këto shuma nuk u pasqyruan në tabelat financiare të Drejtorisë së tatim Taksave duke krijuar rrugën e gjatë 6 vjeçare të evazionit fiskal dhe të vjedhjes së qindramilionë lekëve të destinuara nga taksapaguesit europianë për shoqërinë civile shqiptare. CPR është biznesi i parë që krijuan politikanët e rinj Erion Veliaj dhe Arbian Mazniku ndërkohë që me kalimin e viteve edhe oreksi erdhi duke u rritur. Për këtë qëllim, Veliaj duke parë se kishte filluar të binte në sy tek financierët e donatorëve emri i përsëritur pafundësisht i CPR në dhjetëra miliona lekë çdo vit, u detyrua të diversifikonte faturat e MJAFT duke futur në lojë të vëllain. Kështu Erion Veliaj krijoi biznesin e tij Grafik Propaganda të përfaqësuar nga i vëllai i tij Arbër Veliaj. Që nga ajo ditë, faturat e MJAFTEVE të Velisë dhe të Maznikut kishin 2 vula të ndryshme të vëllezërve të tyre. Por pas 1 viti, Endri Fuga ndihej i shqetësuar se ai nuk kishte biznesin e vet ndërkohë që dy shokët e tij të armëve tashmë qarkullonin qindra miliona lekë në bizneset që kishin krijuar dhe që u bënin marketing pranë të gjithë institucioneve ndërkombëtare në tenderë dhe prokurime ku futeshin miq Veliaj dhe Mazniku. Me qindra miliona lekë kryesisht kesh fuqizonin bizneset e Velisë dhe Maznikut. Për këtë arsye, në 5 Tetor 2006, me numër vendimi 37027 në Gjykatën e Tiranës në marrëveshje të tre musketierët e MJAFTEVE që kontrollonin 5 vula shoqatash dhe 2 vula biznesesh, pranuan shtimin e një vule të re: atë të Biznesit të ri të Endri Fugës me emrin Albanian Comunication GROUP

### Kush është Arbër Veliaj (marrë nga websiti zyrtar i MJAFT www.mjaft.org në 2003)Arbi VELIAJ, Webmaster

Arbi është nxënës i vitit të tretë në shkollën e mesme "Sami Frasheri" në Tiranë. Është i dhënë pas dizanjit grafik si dhe kryesisht eeb dhe multimedia authoring. Administron një sërë faqesh Interneti për organizata kombëtare e ndërkombëtare duke përfshirë Lidhjen Rinore Ballkanike si dhe Delegacionin e Komisionit Evropian në Shqipëri. Arbi ka marrë pjesë në Institutin e Lidershipit Rinor, në Gusht 2002 si menaxheri i multimedias në të. Arbi, pjesëtari më i ri në moshë i skuadrës së MJAFT!-it, përdor mjeshtëritë e tij të dizanjit grafik për të shprehur protestën e tij kundër kushteve të Shqipërisë përmes Fushatës MJAFT! Shumë nga animacionet dhe fotografitë e faqes së Internetit janë produkte të protestës së tij. e-mail: aveliaj@gmx.net

"A.C.G."Një vit më vonë duke qenë se qindra milionë e qarkulluar mund të ngjallnin xhelozinë e Velisë dhe Maznikut, Endri i shet 30% të aksioneve Maznikut. Që nga ajo ditë 3 kryetarët e shoqërisë civile, Erion Veliaj, Arbian Mazniku, dhe Endri Fuga, ishin kthyer në Aktivistë Biznesmenë si prelud i hyrjes së tyre në politikë si 3 politikanë biznesmenë të cilët u pasuruan duke përdorur paratë e taksapaguesve europianë të destinuara për shoqatat rinore në Shqipëri.

### Paratë e USAID për Shqipërinë faturohen nga bizneset e Velisë & CO

Si përdoren bizneset e politikave të G99 për të faturuar paratë e USAID. Siç shihet në faqen online të monitorimit të gjykatave nga Qëndra MJAFT (e cila drejtohet nga 7 drejtues të Kryesisë se G99: Erion Veliaj, Arbian Mazniku, Endri Fuga, Marinela Lika, Milva Ekonomi, Alken Myftiu dhe Klotilda Ferhati (Bushka) me emrin www.unëvotoj.com, paratë e taksapaguesve amerikanë faturohen nga biznesi i krijuar në 2003 nga grupi i Velisë dhe Manziku "CPR" e cila përfaqësohet në Gjykatë nga bashkëpunëtori i tyre i ngushtë Denis Behluli.

Siç shihet në këtë pamje, projekti që i jep kontrollin e gjobvenies dhe marrjes në kontroll të gjykatave shqiptare nga Grupi Elektoral G99 dhe Edi Rama, faturohet nga bizneset e Velisë duke majmur kështu bizneset e Velisë me shokë. Që nga viti 2003, kur u krijua ky biznes nga drejtuesit e rinj të MJAFT deri më sot, rezulton se ky Biznes ka faturuar me qindra fatura më së shumti fiktive në raportimet ndërkombëtare të Erion Velisë me shokë. Kështu prej 6 vjetësh, që kur u themelua MJAFT, vula e CPR-së që ka faturuar për dhjetra donatorë milionat e Velisë dhe Maznikut, tashmë ka filluar të faturojë edhe për USAID fondet e taksapaguesve amerikanë të destinuarta për shoqërinë civile në Shqipëri.

Tashmë projekti i Fondacionit Soros www.unëvotoj.com ka filluar të thithë nga donatorë europianë dhe amerikanë me qindra miliona lekë që faturohen nga CP&R dhe Grafik Propaganda e Velisë.

http://www.unevotoj.com/index2.php

Në asnjë rast në shoqërinë civile nuk ekziston një precedent i ngjashëm ku drejtuesit e shoqatave të krijojnë biznese të posaçme për të faturuar paratë e donatorëve të huaj të destinuara për shoqërinë civile shqiptare. Rasti i tre biznesmenëve Veliaj Mazniku, dhe Fuga, është një model i ri i kapjes së politikës nga biznesmenë që vijnë nga shoqëria civile.

Diplomati gjerman, marketing për kryesocialistin dhe kryenëntëdhjetëenëntëshin

# Ambasadori gjerman i implikuar në fushatë politike me Edi Ramën dhe Erion Velinë

Ambasada Gjermane vazhdon të mos prononcohet për rolin e Ambasadorit Gjerman në promovimin e Lëvizjes Politike të Erion Velisë. Siç është bërë e ditur edhe nga të dhënat e publikuara këto ditë, rezulton se Ambasadori Gjerman është përfshirë drejtpërdrejtë në mbështetjen e partive politike me paratë e taksapaguesve gjermanë të destinuara për shoqërinë civile në Shqipëri. Siç rezulton nga analizimi i të gjithë filmave që prodhuar nga ESI me fonde publike për të gjithë Europën Juglindore, projekt që është shitur nga Erion Veliaj një vit më parë si projekti që do të promovojë imazhin turistik të Shqipërisë në botë. Filmi "Rilindja Shqiptare" është realizuar në konflikt të pastër interesi. Siç shihet edhe nga filmat e tjerë për vendet e ndryshme të Ballkanit, rezulton se vetëm në Shqipëri, organizata partnere e projektit ka arritur që të orientojë përmbajtjen e filmit në favor të vetvetes. Në çdo vend tjetër, filmi është realizuar një subjekt drejtua rnjë subjekti jashtë vetes por në Shqipëri, Filmi "Rilindja Kombëtare" që flet për rilindësit e rinj Rama, Veliaj, Mazniku, Lika, Spiropali dhe ish-spiunin e sigurimit Remzi Lani, është realizuar duke u drejtuar rreth vetes. Me skenarin e filmit kanë punuar Spiropali e MJAFT, Veliaj dhe Lani duke i devijuar fondet e taksapaguesve të huaj për Shqipërinë, drejt realizmit të një spoti shumë të shtrenjtë elektoral që po përdoret në fushatën zgjedhore në Shqipëri që duket se ka filluar shumë më herët se afatet ligjore. Vetë Ambasadori Gjerman që është një ndër miqtë më të ngushtë të Velisë dhe Ramës, është përfshirë publikisht në një skandal politik duke marrë pjesë publikisht në mbështetje dhe promovim të politikanëve të njërës forcë politike dhe të rehabilitimit ndërkombëtar të një spiuni të Sigurimit të Shtetit.

Bizneset faturuese të lekëve të MJAFT, pronë e Velisë & Co

# Bizneset e mëdha multimilionere të Velisë dhe Manzikut, qindra miliona lekë nga shteti dhe ambasadat e huaja

Ne 15 Mars 2003, kur filloi për herë të parë fushata MJAFT (e projektuar që në 6 Janar 2002 në zyrat e Soros Tiranë), Erion Velisë i duhej të faturonte 350 mijë euro të donatorëve të huaj të cilat duhej të shpenzoheshin brenda 4 muajve sepse Fushata (e dy organizmave të krijuara nga Soros Tiranë) ishte planifikuar të transformohej në Lëvizjen MJAFT, dhe kështu duheshin xhiruar mbi 100 mijë dollarë të tjera me urgjencë para se të mbyllej viti 2003 sepse duhej të fillonte lëvrimi i shumës së re të 2004.

Për këtë arsye u regjistrua në Gjykatën e Tiranës Biznesi CP&R i cili përgatë vitit 2003 mbuloi të gjithë faturat e qindra mijë eurove për postera, volantina, bluza, banesa, fletëpalosje, etj. Që emrat e personazheve të diversifikoheshin, u desh që personi që do të drejtonte biznesin të ishte një njeri i besuar dhe këtë askush s'mund t'a bënte më mirë se Denis Behluli, vëllai baptist i Arbian Maznikut. Denisi i punësuar deri në atë moment nga Drejtoresha e Soros Tiranë Valdete Sala me kërkesë të Arbian Maznikut, në zyrën e informacionit studentor pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës (një nga gropat më tipike financiare të Soros në Tiranë sepse ishte një qendër interneti pa internet, dhe gëlltiste çdo vit dhjetëra mijë dollarë duke mos ofruar asgjë), ishte njeriu më i besuar i Arbian Maznikut (vëllai baptist) dhe Endri Fugës, por kishin miqësi të vjetër edhe me Erion Velinë. Siç dihet, lidershipi i MJAFT dhe Grupimit Politik G99, janë të gjithë anëtarë të sektit fetar baptist Tiranë në kishën e të cilit mësuan edhe anglishten dhe të folurën publike me pastorë amerikanë, pavarësisht se një vit më parë Erion Veliaj u konvertua publikisht në protestant (në një emision TV të Top Channel).

Me qindra mijë euro u faturuan me një shpejtësi marramendëse dhe kështu biznesi i vëllait baptist të Maznikut arriti të siguronte fitime të paimagjinueshme të cilat shërbyen edhe si kapital fillestar i rrugës së gjatë të grupimit politik G99. Deri më sot diskutohet që ky biznes që u ngrit me ndihmën e Velisë, Maznikut, Fugës, Pustinës, etj. arriti të kapë klientelë pranë Ambasadave dhe Donatorëve më të rëndësishëm në Shqipëri duke përfshirë Këshillin e Europës, Delegacionin e Komisionit Europian, OSBE-në, Ambasadën Britanike në Tiranë, UNDP, etj. Ky biznes miliardësh i djemve të MJAFT dhe G99, sot përfaqëson një kompani të konsoliduar në treg dhe klientela e saj zgjerohet çdo ditë.

Ndërkohë që nga 2004 u fut në treg pjesë pjesë edhe biznesi i Erion Velisë, i përfaqësuar nga Arbër Veliaj, biznesi i të cilit mbante dy emra: "Grafik Propaganda" dhe "Fshati Urban". Vëllai i Erion Velisë, Arbër Veliaj, i njohur në media në 2006 nga fotografitë e tij ku pozonte i veshur si femër në festat e MJAFT, me biznesin e tyre mbulojnë prej vitesh një numër të madh klientësh publikë, ndërkombëtarë dhe private.




Nga të dhënat e mbledhura për Biznesin e Erion Velisë që herë prezantohet me emrin Grafik Propaganda dhe herë Fshati Urban, rezulton se Veliaj ka marrë para nga edhe nga taksapaguesit shqiptarë siç është rasti i Bashkisë Tiranë dhe Bashkisë Durrës. Nuk dihet shuma e përfituar nga Edi Rama dhe kryetari i Bashkisë Durrës, por është fakt se klientët e biznesit të Erion Velisë janë edhe institucione ndërkombëtare si Banka Botërore apo UNICEF. Siç shihet edhe nga faqja e publikuar nga Arbër Veliaj, rezultojnë mbi 54 klientë të rëndësishëm por ndërkohë nuk gjendet as në Gjykatë dhe as në databasen e QKR asnjë e dhënë për këtë biznes multimilioner. Ajo që të bën përshtypje nga investigimi i Gazetës Sot, është se ky biznes e ka filluar jetën e tij sipas të dhënave të publikuara nga MJAFT nëpërmjet 4000 dollarëve që Milva Ekonomi dhe Klotilda Ferhati, dy themelueset e regjistruara në gjykatë të MJAFT dhe Grupimit politik G99 nëpërmjet fondeve që MJAFT ka shpërndarë si mikrokredi në mënyrë të paligjshme në vitin 2005 - 2006. Por kjo është një çështje që do të prezantohet në ditët në vazhdim. Rasti i vëllait të Erionit që prezantohet nga një djalë i vogël dhe i varfër (sipas kushteve të dhënies së mikrokredisë) që e nisi me 4000 dollarë dhe përfundoi me 54 klientë të rëndësishëm (që normalisht duhet të qarkullojë çdo vit të paktën 100 milionë lekë duke siguruar të ardhura në disa qindra mijë euro) e rreshton vëllain e Velisë si një nga njerëzit më të suksesshëm të Shqipërisë. Problemi qendron se Lëvizja MJAFT ka derdhur shuma të pallogaritshme parash në biznesin e Velisë dhe kjo tregon edhe një nga mënyrat e akumulimit fillestar të kapitalit të biznesmenëve të rinj të politikës shqiptare që vijnë nga shoqëria civile. Siç rezulton nga të dhënat tona, janë mbi 250 mijë euro të inkasuara vetëm nga projektet e MJAFT në këtë biznes, para që donatorët e huaj i kanë sjellë në Shqipëri për të ndihmuar shoqërinë civile. Por siç del nga të dhënat tona, ky biznes që ka kontrata me UNICEF, Bankën Botërore, Bashkinë Durrës, etj. nuk gjendet i regjistruar në gjykatën e Tiranës dhe as në QKR. Ka dyshime reale se biznesi i Velisë Fshati Urban (e prezantuar online nën emrin Grafik Propaganda) është një biznes i paregjistruar fare në gjykatë dhe as në QKR duke përbërë një nga skandalet më të mëdha financiare të biznesit politik në Shqipëri. Ndërkohë që shifrat e pallogaritshme financiare që ky biznes ka qarkulluar në Shqipëri, e vënë Erjon lejfenin në top listën e evazionit fiskal. Nëse Veliaj do ta kishte regjistruar Fshatin e tij Urban që bën trafiqe propagande si biznes të vogël, atëherë ai e ka kaluar me kohë kufirin e evazionit fiskal por nëse ky biznes nuk është regjistruar fare duke u lejuar nga Drejtoria e Tatim Taksave të Bashkisë Tiranë të punojë në të zezë, atëherë kemi të bëjmë me një rast të paprecedent të abuzimit të hapur në bashkëpunim midis Erion Velisë dhe shefit të tij Edi Rama.

Paratë që ka faturuar CR&R i ngritur me ndihmën e tre drejtuesve të G99, Erion Veliaj, Arbian Mazniku, Endri Fuga, dhe Fshati Urban i Velisë, për llogari të ambasadave të huaja në kuadër të projekteve të MJAFT, kapin shifra mbi një miliard lekë. Këtu në shumë projekte përfshihen edhe Fushata MJAFT, Karvani MJAFT, Votoj, Jeto Gjelbër, Blini produkte shqiptare, Shkunde Votën, Festivali i Aktivizmit, MJAFT Feste (6 vjet rresht), Punësimi Rinor, Monitorimi i Zgjedhjeve, Monitorimi i Pushtetit Lokal, Parlamentit, Ministrive, dhe tashmë së fundi edhe Gjykatave me paratë e USAID, përcakton një nga rastet më të rënda të abuzimeve në Shqipëri. Siç rezulton nga të gjitha të dhënat e deritanishme, me paratë e taksapaguesve të shteteve të ndryshme, të destinuara për shoqërinë civile në Shqipëri, janë ushqyer bizneset e tre politikanëve të rinj Erion Velia, Arbian Mazniku dhe Endri Fuga. Në këtë mënyrë është e mundshme të kuptohet se si arritën që këta djem të rinj, të kenë shtëpitë më të shtrenjta në Tiranë me qindra metra katrorë, me pishina që ndodhen në tarraca pallatesh 11 kateshe.

Këta tre biznesmenë të rinj multimilonerët të politikës shqiptare që vijnë nga shoqëria civile, janë fytyra më e shëmtuar e korrupsionit dhe abuzimit financiar në Shqipëri. Backgroundi i tyre ekonomik vërteton katërcipërisht se politika e re e Edi Ramës bazohet pikërisht në këto principe abuzivizmi dhe korrupsioni. Tre musketierët Veliaj, Mazniku dhe Fuga nën leksionet e Dardajanit Edi Rama, kanë shpikur lojëra manipulative financiare me paratë e destinuara për shoqërinë civile shqiptare, duke i shpërdoruar këto para dhe krijuar benefice për vete dhe familjarët e tyre. Modeli i mësipërm është një nga modelet më të frikshme të politikanëve të rinj që pretendojnë të futen në politikë. Duke qenë kaq të inkriminuar me afera shpërdorimesh në shoqata të cilat kanë njëfarë kontrolli nga donatorët, i frikshëm do të jetë momenti nëse paratë e shqiptarëve do menaxhohen nga qeveritarë të këtij modeli.

## Si faturohen paratë e taksapaguesve amerikanë në projektin e Monitorimit të Gjykatave

Siç ju kemi vënën në dijeni në numrat e shkuar, USAID i ka dhënë të drejtën politikanit të ri biznesmen të shoqërisë civile Erion Velia, dhjetëra mijë dollarë për të kontrolluar gjykatat shqiptare për llogari të Edi Ramës. Projekti i Velisë, paratë e të cilit kontrollohen nga ai në numrat e tij bankar, synon që të monitorojë gjykatat në këto drejtime: Vëzhgimi i deklarimit të pasurisë së gjykatësve në gjykatat e rretheve Shkodër dhe Vlorë, si dhe gjykatësve të Gjykatës së Apelit në Tiranë. Vëzhgimi i marrëdhënieve mes Gjykatësve dhe Partive Politike të përfshirë në një çështje të caktuar për të shmangur ose denoncuar rastet e Konfliktit të Interesit. Ofrimi i ndihmës për qytetarët, për të denoncuar publikisht një padrejtësi që kanë hasur nga gjykata. Denoncimi publik i rasteve të Konfliktit të Interesit.

Ashtu siç ndodhi me projektin e të njëjtës linjë, monitorimi i Parlamentit Shqiptar ku Erion Veliaj ka vënë dhe vazhdon të vejë gjoba, siç ka bërë me deputetët e LSI-së Pellumb Xhufi dhe Ndre Legisi, të dhënat e të cilëve janë falsifikuar drejtpërdrejt nga Erion Veliaj, po ashtu siç bëri me projektin e pushtetit lokal, ku iu vunë këto ditë gjoba publike Bashkisë së Policanit të drejtuar nga LSI. Në fakt problemi kryesor që ekziston nga zbatimi i këtij projekti është edhe implikimi politik i lëvizjes MJAFT, lëvizje që ka shef të saj Erion Velinë i cili është edhe kryetari i G99. Duke pasur të drejtën e kontrollit të gjykatave një organizatë politike si ajo e Velisë, e cila është në koalicion me Edi Ramën, gjykatat vihen nën kontroll total të politikës e cila do të vendosë gjoba për gjyqtarët që monitoron. Vënia e gjykatave në monitorim nga një parti politike shkel dhe destinacionin e parave të taksapaguesve të cilët paguajnë për përfshirjhen e shoqërisë civile në procese monitorimi dhe jo të partive politike si ajo e zotit Veliaj. Edhe në këtë rast Veliaj ashtu edhe në rastin e deklarimit të pasurive do të do të vendosë gjoba për llogari të Ramës për të gjithë ata gjykatës që nuk i përgjigjen interesave të Ramës.

Bizneset e Velisë & Co rezultojnë të paregjistruara

# Ja ambasadat që bëjnë biznes me Erion Velinë

Tashmë duket se problemi i Velisë nuk është vetëm para donatorëve të huaj, paratë e të cilëve të destinuara për shoqërinë civile shqiptare janë faturuar nga bizneset e posaçme të krijuara për te faturuar paratë e MJAFT. Tashmë problemi më i madh për Velinë & Co është drejtësia shqiptare. Sepse biznest e Velisë & Co nuk rezultojnë gjëkundi të registruara në QKR me emrat CP&R dhe Fshati urban apo Grafik Propaganda. Në asnjë rast këto emra nuk figurojnë në asnjë dokument ligjor që vërteton se këto biznese të jenë persona juridik apo që këto biznese të jenë të regjistruara pranë Drejtorisë së Tatim Taksave apo pranë Sigurimeve Shoqërore. Siç duket kemi të bëjmë me raste të rënda evazioni fiskal dhe e gjitha kjo në sytë e ambasadave të cilat edhe kanë bërë biznes me Velinë. Siç rezulton nga investigimi i Gazetës Sot, C&PR-production apo me emër të gjatë "Communication & Public Relations" ("Komunikim dhe Marëdhënie Publike") "është një studio dizenjimi dhe prodhimi, që ofron një gamë të gjerë produktesh dhe shërbimesh në fushën e komunikimit dhe të marrdhënijeve publike. CPR-production ka realizuar produkte dhe shërbime të ndryshme për një sërë biznesesh e organizatash. Besojmë se cilësia dhe përpikmëria jonë janë dy faktorët më të rëndësishëm që na bëjnë ndër studiot më prestigjoze në këtë treg." (marrë nga ëebsiti zyrtar http://www.cprstudio.com)

### Kush janë klientët e C&PR sipas ëebsitit të tyre zyrtar:

"Shërbimet që ofrojnë për klientët përfshijnë një gamë të gjerë në fushën e komunikimit dhe marrëdhënieve me publikun. Kjo është një fushë e rëndësishme për organizatat e huaja që kontribuojnë me projektet e tyre në zhvillimin e vendit. Disa nga këto organizata kanë zgjedhur CPR Production për dizenjimin dhe hartimin e shtypit. Nga këto mund të përmendim ITAP, Komisioni Europian, Partners Albania, UNDP, OSCE, ambasada britanike dhe zyra e informimit të Këshillit të Europës. Gjithashtu, disa nga kompanitë dhe organizatat e mirënjohura që kanë zgjedhur CPR për të realizuar dizenjimin e shtypit të tyre, në kuadër të marrëdhënieve me publikun, janë edhe AMC, R&T Dataservice dhe Tirana International, Kryqi i Kuq Shqiptar dhe fondacioni "Ambraham Linkoln". Një pjesë e klientëve të saj kanë zgjedhur shërbimet e krijimit të logos nga kjo firmë. Për shembull lëvizja "Mjaft!", Tirana International Hotel, Birra Arfi dhe Youth Link Lidership Institute për dizenjimin e logos dhe elementeve të tjera përbërëse janë asistuar nga CPR Production."

Ajo që të bie në sy në këtë rast është që ky biznes i krijuar nga Velia & Co ka arritur të bëjë biznes me ambasadat dhe organizatat donatore përfshi edhe biznesin e madh pavarësisht se ky biznes është krejtësisht i jashteligjshëm dhe i paregjistruar në zyrën e tatim taksave. Se si ka mundur Veliaj & Co të fusin në tregun e ambasadave këtë firmë kjo mbetet e dyshimtë sepse dihet se standartet e kontraktimit nga ambsadat kanë proçedura shumë të qarta dhe korrekte. Nëpërmjet lançimit të këtij biznesi faturues për paratë e MJAFT, Veliaj në takimet e ndryshme që ka pasur me diplomatë dhe drejtues të organizatave donatore duket ka arritur ti bindë me mënyrat e veta për cilësitë e veçanta të C&PR-production. Fakti që ambasadat dhe organizatat donatore kanë bërë biznes me një biznes të paligjshëm mbetet një nigmë e madhe që vetëm ata mund t'a shpjegojnë se si e qysh ka ndodhur dhe se çfarë roli ka pasur Veliaj në këto marifete. Ajo që dihet me fakte është se lloji i shërbimeve që biznesi i krijuar për të faturuar paratë e MJAFTit, ka një kosto shumë të lartë dhe duke pasur parasysh numrin e madh të klientëve dhe potencën që ata kanë, është e qartë se sasia e parave që janë qarkulluar ngo kjo firmë nuk mund të jetë nën 8 milionë lekë ashtu sic parashikon edhe ligji biznesin e vogël.


OKR
EKSTRAKT HISTORIK I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT "PERSON FIZIK"
GJENDJA E REGJISTRIMIT FILLESTAR
Aktiv
HISTORIKU I REGJISTRIMIT

Mjafton ti referohemi gazetës Biznesi në dt 21/09/2005 në artikullin dedikuar C&PR Production "Shërbime publiciteti për kompanitë e mirënjohura" (shkrim i postuar nga vete C&PR në ëebsitin e saj)dhe deklarohet një numër i madhe të punësuarish të cilët janë "një numër të madh te rinjsh të shkolluar jashtë shtetit". Se kush janë këta të rinj nuk merret vesh por duke qenë se kjo kompani deklaron vetëm "Denis Behluli - manager, design, Henri Manushi -design, Eltion Metko - programues, Altin Behluli - design, production, rezulton se numri i vërtetë i madh i të rinjve duhet të jenë Erion Veliaj vetë (pasi ai ka studiuar jashtë shtetit). Gjithsesi mbetet çështja e deklarimit të të puënsuarve të C&PR në të zezë apo në të bardhë. Në fakt biznesi që lindi për të faturuar paratë e ambasadave dhe fondacioneve, nuk ekziston gjëkundi i regjistruar me këtë emër bombastik. Në fakt Denis Behluli i cili prezantohet si "manager, design" (http://www.cprstudio.com/contacts.htm) rezulton i regjistruar në Gjykatën e Tiranës me Numër Vendimi 23343, në 7 Shkurt 2003 (gjatë kohës që po lançohej dhe po kontraktohej media për të prezantuar fushatën MJAFT) si "person fizik" me numër Nipti K31521685 të regjistruar në Drejtorinë e Tatim Taksave. Problemi është se ky person fizik mund të ketë shërbyer për të mbuluar vulën dhe faturat e "C&PR - Production". Ajo që të bën përshtypje se kjo firmë e re, që në vitin e parë rezulton se ka fituar një konkurs kombëtar dizajni (ku gjithmonë fitonte Bashkia e Tiranës dhe Fondacioni Soros vendin e parë) si studioja me dizajnin më të mirë për një nga kompanitë m të mëdha të Shqipërisë. Në fakt ky biznes i ngritur nga Velia & Co duke mos deklaruar në Drejtorinë e Tatim Taksave qarkullimin real të parave, dhe që dukshëm ka kapërcyer që në vitin e parë shumën prej 8 milionë lekësh, ka arritur që të behet një konkurrent i fuqishëm në një treg ku të tjerët jo vetëm paguajnë taksat dhe tatimet, por edhe sigurimet shoqërore dhe shumë shpenzime të tjera të domosdoshme që kërkon ligji. Kjo mënyrë e shmangies së pagesës së detyrimeve të tatim taksave nga biznesi Veliaj ka sjellë një konkurencë të pandershme në treg dhe siç reklamohet në ëebsitin e kësaj firme inekzistente ligjore, në 2005, "C&PR - production" ka qenë një konkurrent i fortë përballë "DDB Albania, Delta Publicity, Imazh, Dynamic Media, Iceberg Publicity, Quick, R&T Advertising, Fasada Studio, Artgraf, Eest Grafik, Pro Studio, Everest, Visi Design etj," biznese të cilat kanë paguar rregullisht tatim taksat dhe cdo detyrim tjetër të ligjshëm. "Ky numër kaq i madh konkurrentësh mund të përballohet vetëm duke qenë i përpiktë, serioz dhe profesional në punët e krijuara. Vetëm duke qenë i tillë mund të dalësh mbi konkurrencën e ta fitosh klientelën besnike." Sic shihet, aftësia e biznesit të Velisë & Co për t'iu shmangur detyrimeve fiskale ka sjellë një dëm real në tregun e studiove të reklamave prej qindra miliona lekë të fituara pa të drejtë nga një firmë e paligjshme.

Por nuk ngelet më mbrapa biznesi tjetër i Velisë i cili prezantohet me dy emra në shërbimet që i afrohen disa ambsadave, bashkive të Tiranës dhe të Durrësit, vetë KESH: "Grafik Propaganda" dhe "Fshati Urban". Ky biznes nuk ekziston në asnjë formë dhe në asnjë përmasë juridike në asnjë lloj regjistrimi në QKR. Ky biznes që përfaqësohet nga vëllai i Erion Velisë është agjencia bazë e cila mbulon shumicën e punëve të MJAFTit dhe të jgithë MJAFTëve që ka krijuar Erion Veliaj me shokë. Ky biznes i cili ka mbuluar prej kohësh edhe faqen zyrtare online të Partisë Socialiste (fakt i zhdukur këto ditë me urgjencë për të mos treguar se si Veliaj bën biznes me paratë e Partisë Socialiste apo që mund të burojnë edhe nga taksat e Bashkisë Tiranë) dhe që deklaron 54 klientë në faqen e tij zyrtare http://www.fshatiurban.com/who-we-are.htm nuk ekziston gjëkundi i regjistruar në QKR. Nuk dihet se si ky biznes që nuk ndodhet në QKR të arrijë të inkasojë jo vetëm qindra milionë lekë të dhëna MJAFTËVE të Velisë nga ambasadat e huaja, por edhe të bëjë biznes vetë me këto ambasada dhe donatorëve. Partnerët më tipik të Velisë nder ambasadat e huaja janë UNICEF dhe Banka Botërore ku përfaqësues janë Ajola Xoxe (UNICEF) dhe gruaja e Drejtorit të Soros Tiranë, Ana Gjokutaj (Banka Botërore). Ajo që të bën përshtypje në gjithë këtë klientelë VIP, është se si ka mundësi që gjithë këto para të qarkulluara të mos kenë një referencë të regjistrimit juridik si biznes në QKR. Në fakt i vetmi biznes i regjistruar në QKR është ai i parfumeve që shet vëllai i Erion Velisë (I njohur tashmë në median shqiptare prej fotove të tij të shpeshta i veshur si femër në festat e çuditshme të MJAFT). Ky biznes i cili është i regjistruar si person fizik (po ashtu siç bëri miku i tij i ngushtë në prag të fushatës MJAFT, Denis Behluli), i regjistruar në 2008 nuk mund të përdoret dot për marëdhënie kontraktuale me 54 klientët paratë e të cilëve i inkason prej 5 vjetësh. Duke mos rezultuar i regjistruar në QKR si biznes, Fshati Urban i Velisë rezulton të jetë një Vrimë e Zezë jo vetëm për paratë e destinuara për shoqërinë civile shqiptare që MJAFT i ka gëlltitur në vite për llogari të Velisë & Co, por edhe për paratë që duhej t'i paguante drejtorisë së tatim taksave. Numri i madh i klinetëve VIP dhe lloji i shërbimeve me kosto të lartë të japin përshtypjen se kemi të bëjmë me një tejkalim të kufirit të sasisë së parave prej 8 milionë lekësh që ka të drejtë të qarkullojë një person fizik.

**Disa klientët vip të C&PR - Production:**

- Komisioni Europian,
- OSBE,
- Ambasada Britanike,
- UNDP,
- Këshilli i Europës,
- ITAP (Deparatamenti i Administratës Publike pranë Këshillit të Ministrave),
- Fondacioni Abraham Lincoln, etj

**Fusha e veprimit të agjencisë së marketingut dhe reklamave të Velisë**

Fusha e veprimit të agjencisë së marketingut dhe reklamave të Velisë që prezantohet online në http://www.fshatiurban.com/who-we-are.htm synon të krijojë një marëdhënie të ngushtë midis kompanive, organizatave, individëve dhe klientëve të tyre. "Kjo është një qendër që ne bëjmë gjithshka në një kohë që ndryshon kur e synojmë kontrollin e konsumatorëve, medias dhe shoqërisë multietnike".

Paturpësia Veliaj dhe manipulimi keqpërdorues i imazhit OBAMA!

# Veliaj vendos sloganin e tij elektoral "Do t'ja dalim" në hyrje të librit të Obamës me paratë e Withers

Disa ditë më parë, Erion Veliaj pati paturpësinë që të përdorte emrin e Obames për të fshehur korrupsionin e tij prej 5.4 milionë eurosh që ka bërë me projektet e MJAFT nëpërmjet dy bizneseve të paligjshme që ka krijuar ai me shokë, C&PR dhe Grafik Propaganda (Fshati Urban). Në mënyrë krejt të paturpshme, Erion Veliaj që është denoncuar për korrupsion fiskal dhe mashtrim me faturat e donatorëve të cilët në mënyrë të habitshme i kanë kaluar 5.4 milionë euro në llogaritë e tij bankare edhe pas maskaradës së dorëheqjes së tij false, kërkon të fshihet pas emrit të Obamës si personazh i ndryshimit.

Javë më parë, Ambasada Amerikane mbështeti financiarisht publikimin e librit 'Guximi për të shpresuar" i Barak Obamës, presidenti i parë amerikan me ngjyrë që është kthyer edhe në simbol të qytetarit të thjeshtë që guxoi dhe kandidoi për tu bërë president i vendit më të fuqishëm të botës. Në publikimin e këtij libri, mbiu edhe Erion Veliaj i cili u emërua me një emër të harruar që nga koha e komunizmit, redaktor politik. Ky libër i përkthyer nga Diana Ndroqi (Dibra) dhe redaktore letrare Violeta Kongo, ka edhe një shpikje të re parazitare: Erion Veliaj në emrin e padëgjuar: Redaktor Politik! Erioni ka kryer punime në këtë libër me vetëm një ndryshim në faqe 9-10 ku ka bërë hyrje jo për Barack Obamën por për veten e tij dhe partinë e tij G99. Çuditë e Velisë nuk kanë pushim në fushën e korrupsionit, por kjo e librit të Obamës ku ai ka përdorur një punim politik të dikujt mijëra kilometra larg që sot është bërë simbol i ndryshimit në botë dhe përfaqësues i demokracisë më të besueshme, për tu identifikuar me presidentin e amerikës kapërcen çdo lloj kufiri të delirit të madhështisë dhe përcakton qartë nevojën e kurimit psikologjik të këtij deliranti dhe oportunisti të papparë deri më tani.

Erion Veliaj i cili ndyu në mënyrë të pamoralshme librin e Obamës me lavdet vetidentifikuese delirante për vete dhe aksionin e tij demagogjik, përbën një precedent të rrezikshëm për keqpërdorimin e fondeve të taksapaguesve amerikanë. Në faqen e internetit të G99, paratë e taksapaguesve amerikanë, reklamohen si mbështetje politike për grupimin G99. Historia e përdorimit të parave të taksapaguesve të huaj të destinuara për shoqërinë civile shqiptare që përdoren për mbështetjen elektorale të veprimtarive partizane duke shkelur çdo parim dhe të drejtë ndërkombëtare tashmë është bërë rrugë në Shqipëri. Sipas websitit të G99, "Libri 'Guximi për të shpresuar" i presidentit të zgjedhur amerikan, Barack Obama, tashmë i përkthyer në shqip u promovua sot në një ceremoni të bashkëorganizuar nga G99, Universiteti 'Marin Barleti' dhe ambasada amerikane." Ambasadori amerikan që merr pjesë në një aktivitet të prezantuar si aktivitet i një grupimi politik në Shqipëri, që pretendon se do të marrë pjesë në zgjedhje (sipas Zërit të Amerikës) përbën një shkelje të hapur të principeve amerikane të shpenzimeve të parave të departamentit të shtetit.

Ndërkohë karikatura delirante e shkruar nga Veliaj në hyrjen e këtij libri, flet vetë për keqpërdorimin që mund ti bëhet emrit të Obamës nga një njeri pa identitet dhe i pagëzuar këto ditë nga klasa politike shqiptare si Lejfeni i korrupsionit të shoqërisë civile. Por Veliaj nuk mund të fshihet pas asnjë Obame për të mbuluar faturimin korruptiv të 5.4 milionë eurove të MJAFT nëpërmjet 2 bizneseve familjare të MJAFT. Sipas Velisë, në promocionin e librit në prani të Ambasadorit Amerikan, politikanëve të PS dhe G99, "Obama është frymëzim për të gjithë ata të rinj që në betejën e angazhimit publik ndihen të kërcënuar nga përbaltja. Ne deshëm të sillnim sado pak nga ajo frymë e politikës së re që pamë në konventën demokrate në Denver dhe me këtë libër ja kemi arritur". Veliaj nuk është përbaltur nga media, por nga dosja korruptive e tij që tashmë është pronë e Drejtësisë shqiptare dhe e auditëve ndërkombëtare dhe asnjë libër s'mund ta shpetojë, sepse korrupsioni i Veliaj ka qelbur me erën e vet një pjesën jo të vogël të trupit diplomatik në Tiranë dhe auditët ndërkombëtare sapo po fillojnë.




## Për të shmangur çdo keqinterpretim të budallallëqeve që ka shkruajtur lejfeni shqiptar ne kemi vënë të plotë të gjithë hyrjen e "Redaktorit Politik" (term lejfenist) Erion Veliaj

**Parathenie e librit nga Erion Veliaj:**

Një vit më parë e ca më parë fillova të insistoj me miqtë e mi, kundër të gjitha gjasave, se Obama do të ishte udhëheqësi i Botës së Re me arsyetimin se Barack Obama ishte një etalon i 'politikës së re', prova e gjallë e aktivizmit që mund apatinë, shembulli shpresëplote se historia e të rinjve në politikë nuk mund të diskreditohet nga industria e shëmtuar e shpifjes dhe sharjes, ekzemplari më i ri e drithërues i ëndrrës amerikane.

Më duhet të rrëfej, se një pjesë të grishjes për të avokuar fenomenin Obama e kisha nga kërkimi personal gjatë themelimit të G99-ës për prova se politika nuk është e tëra e pistë, se kalimi nga shoqëria civile në politikë nuk është mëkat, dhe se puna e ndershme e përpjekjet e sinqerta për ndryshim janë kura më e mirë për skepticizmin e cinizmin kronik. I lindur nga një baba zezak, i rritur vetëm nga nëna dhe gjyshja e tij, jeta e Barack Obamës është një dëshmi - kundra gjithë gjasave - e besimit për të realizuar gjëra që të tjerët para tij nuk guxonin t'i ëndërronin, e besimit që njerëzit bashkohen më fort nga dashuria dhe shpresa se nga urrejtja dhe frika.

Obama na konfirmon sesi në Shqipëri dhe në SHBA, apo edhe kudo në botë, njerëzit aspirojnë për të njëjtat gjëra: jetë të shëndetshme, edukim cilësor, një familje të fortë, pension dinjitoz, si dhe respekt, solidaritet e liri të shprehjes. E ndonëse shumë nga këto gjëra njerëzit i arrijnë vetë, në sajë të talentit, sipërmarrjes e punës së tyre të ndershme, të gjithë e ndjejnë nevojën e shtetit në orën e tyre të mirë të një ideje të re që kërkon përkrahje apo në dekikën e tyre të keqe të një dështimi që injekton dëshpërim, në hapat e parë të jetës së pavarur prej prindërve apo në muzgun e një jete të jetuar plot mundime, në përpjekjen për të jetuar në një vend më të mirë apo për t'u ndjerë më mirë në vendin ku jetojmë.

Si aktivist i shoqërisë civile në Chicago, Obama dëshmon rolin e pazëvendësueshëm të organizatave jo-qeveritare në avokimin e atyre nevojave të cilat qeveritë shpesh zgjedhin t'i injorojnë. Organizatat e shoqërisë civile, grupet komunitare, sindikatat e zejeve dhe unionet e punetorëve janë të gjithë penjtë që mbajnë bashkë stofin e shoqërisë tonë, ndaj është e rëndësishme që ato jo vetëm të ekzistojnë, por të gëlojnë. Si në rastin e Obamës, ato janë shpesh një para-shkollë politike, mënyra më e mirë për të shtrënguar duart, prekur hallet e mësuar dertet e atyre që të lodhur e zhgënjyer kërkojnë një përfaqësim më të denjë në politikën që vendos të ardhmen e tyre.

Për secilin djalë a vajzë të re që sot aspiron jetën publike, por nuk guxon ta provojë sepse pas cepit të angazhimit publik e pret egërsia dhe injoranca e tregtarëve të vjetër të frikës e baltës, suksesi i Obamës ofron një over-dozë me kurajë! Kurajë, dhe nëse nuk keni lindur në një familje të pasur apo të lidhur me elitën politike. Kurajë, dhe nëse idetë tuaja nuk janë shumë popullore në fillim. Kurajë, dhe nëse rrëzoheni herën e parë a të dytë që e provoni. Lajmi i mirë nga fenomeni Obama është se me kurajë, dinjitet e punë të palodhur për të mirën publike gjithçka është e mundur. Si shqiptarë, ka më shumë gjëra që na bashkojnë sesa ato që na ndajnë, nuk ka arsye pse të mos e kthejmë kombin tonë në një histori suksesi. Unë jam i bindur se të gjithë bashkë, me shumë besim, kurajë dhe guxim: Do t'ia dalim!

"Rilindja Shqiptare", produkt i aferave skandaloze

# Standardet që na propozon ambasadori gjerman janë: Spiuni Lani, lejfeni Veliaj, dhe i korruptuari Rama

Prej ditësh Gazeta Sot denoncon Filmin "Rilindja Shqiptare" i prodhuar me paratë e taksapaguesve gjermanë dhe austriakë, si një suport i hapur dhe i paligjshëm për partitë politike në Shqipëri, nën mbështetjen personale të ambasadorit gjerman. Ky film i cili manipulon të vërtetën historike të shqiptarëve në tranzicion, manipulon të vërtetën historike të 18 viteve të fundit duke paraqitur Lëvizjen MJAFT dhe politikanët Edi Rama, Erion Veliaj dhe ish-spiunin e Sigurimit të Shtetit Remzi Lani, si njerëzit që shpëtuan Shqipërinë nga Kriza e '97. Subjekti i filmit përpiqet të paraqesë këta tre heronj si rilindësit që po shpëtojnë Shqipërinë. Remzi Lani në dokumentar paraqitet si njeriu më premtues i komunitetit të medias në Ballkan dhe përfaqësues i fjalës së Lirë. Edi Rama paraqitet si lideri që gjelbëroi qytetin duke fshehur faktin e madh publik që gjatë viteve të fundit shumica e lulishteve dhe hapësirave të gjelbra në Tiranë u betonizua dhe u ngushtua deri në ekstrem. Përpos që ky njeri po akuzohet nga qytetarët si grabitës i pronave publike të tyre. Glorifikimi i ngjyerjeve të fasadave me ngjyrat e ylberit (si simbolikë e koloritit gay) në vend që të shihet masakra urbane e Mister Betonit, është pjesë e skenarit që u përgatit me aq kujdes nën asistencën e ish-spiunit të Sigurimit të Shtetit Zoti Remzi Lani. Por elementi më tipik i falsifikimit të së vërtetave historike ka të bëjë me mënyrën "artistike" të prezantimit të Rilindjes Shqiptare Rama&Veliaj&Lani! Filmi paraqet një Shqipëri kaotike të 1997 dhe paraqet si 3 njerëzit shpëtimtarë, heronjtë Rama, Veliaj dhe Lani! Duke injoruar rolin krejtësisht minor të këtyre hiçave në kapërcimin e situatës së krizës '97. Këta personazhe, që s'kanë asnjë lidhje me ringritjen e Shqipërisë pas '97, paraqiten si heronj. Në fakt, ky film të kujton kinodokumentarët e Kinostudios "Shqipëria e Re" që glorifikonin dhe shpiknin histori për kooperativistët, karrocierët dhe sharrëxhinjtë e Byrosë Politike, të cilët në vitet '80, u trajtuan në Fjalorin Enciklopedik Shqiptar njësoj me Rilindasit Sami Frashëri, Vaso Pasha dhe Naum Veqilharxhin. Por e vetmja lidhje që mund të ketë rilindasi postmodern Erion Veliaj me rilindasin e vërtetë Sami Frashërin, është vetëm emri i shkollës së mesme të Velisë.

Një nga përrallat "dokumentare" të filmit, është edhe historia e krijimit të MJAFT nga disa të rinj, që u mblodhën në një kafe dhe diskutuan plot pasion për fatet e vendit dhe kështu iu mbush mendja që të bënin revolucionin MJAFT. Në fillim mësuan nga Banka Botërore se në Shqipëri paska varfëri dhe IOM iu mësoi se në Shqipëri paska trafik, dhe pastaj kuptuan se halli qenka tek apatia! Dhe për pasojë, direkt pas kafesë u paraqitën në ambasadën holandeze dhe e bindën ambasadorin t'u jepte 245 mijë euro si kapital fillestar për Lëvizjen e madhe qytetare (që në fakt inkasoi nëpërmjet lojërave me spinoffe sorosiane 5.4 milionë euro të destinuara për shoqërinë civile shqiptare). Në fakt përrallat me mjaft kapin edhe statistika qesharake si shifra prej 8000 anëtarësh të MJAFT, që nuk mbledh dot as 20 vetë në protestat milionere para kryeministrisë, pavarësisht faktit që këta të 20 nuk mungojnë në xhirot me jahte në bregdet me paratë e ndihmave humanitare të OXFAM.

Rilindasi Veliaj shpik një histori shumë interesante për veten e tij në film. Sipas tij, ai dhe mamaja e vet, u ndërgjegjësuan për të mbështetur refugjatët kosovarë, pasi morën në shtëpi një çift kosovarësh dhe kështu ai shkoi aty ku e thirri atdheu, në Peshkopi që të ndihmojë në frontin më të vështirë bashkatdhetarët e vet. Në fakt kushdo e di që në 1999, Veliaj ishte student në një kolegj komunitar 3vjeçar me një bursë të vogël të kishës baptiste dhe kur mori vesh se kisha baptiste donte përkthyes anglisht - shqip (të cilët për të hir të vërtetës paguheshin shumë) u nis me shpejtësi të punonte për misionarët amerikanë. Gjithashtu mashtrimi i Veliajt me dorëheqjen nga Lëvizja MJAFT, vazhdon edhe në film pavarësisht se edhe paratë që kaluan në numrat e llogarisë bankare për organizatën partnere (MJAFT), kontrolloheshin nga Veliaj & Co. Por e vërteta e Veliajt në këtë film është pjesë e skenarit artistik që të kujton një titull të famshëm të një filmi egjiptian që transmetohej në fund të viteve 80 në televizionin shqiptar: "Zbukuroj por nuk gënjej".

**7 filmat që u realizuan me paratë gjermane dhe austriake për imazhin Europian të 7 vendeve të Ballkanit:**

Serbia - Exit Europe
Montenegro - Wild Beauty
Kosovo - Cutting the lifeline
The Albanian Renaissance
Macedonian Wedding
Bosnia - A miracle Which does not shine
Istanbul: Truth, fear and hope

### Konflikti i interesit të Veliajt paratë e taksapaguesve europianë

Ajo që e bën filmin Rilindja Shqiptare një turp financiar dhe filmik, është pikërisht glorifikimi deri në delir madhështie i vetvetes. Veliaj & Spiropali & Lani në vend që të asistonin realizimin e një filmi për imazhin e Shqipërisë, në konflikt të pastër interesi i orientuan paratë e taksapaguesve gjermanë dhe austriakë drejt një paçavureje krejtësisht mediokre dhe falsifikuese të historisë. Veliaj i njohur për parimin "gënje, gënje se diçka do mbetet", i shumëpaguar si një ndër ekspertët kryesorë të Iniciativës së Paktit të Stabilitetit (ESI) bashkë me Elisa Spiropalin dhe me asistencën e palodhur dhe të përhershme të ish-Spiunit të Sigurimit Remzi Lani (që futi në burg mësuesin e tij sepse lexonte Biblën), janë autorët e të vetmit film dokumentar ndër gjashtë që u prodhuan në Ballkan, i cili fliste për autorët! Filmat Maqedonë, Boshnjakë, Kosovarë, Turkë, Malazez dhe Serbë që u prodhuan brenda të njëjtit program milionësh euro, nuk flasin për organizatat partnere, por për vendet e tyre. Filmi malazez flet për bukurinë turistike malazeze duke i përdorur kështu paratë gjermane dhe austriake për të shtuar numrin e turistëve gjermanë dhe austriakë në plazhet e Budvës dhe Kotorrit. Filmi maqedonas flet për një paqe midis shqiptarëve dhe maqedonasve, çka e bën Maqedoninë të besueshme për Europën. Filmi Turk flet për një Turqi që meriton të jetë pjesë e Europës dhe kështu me radhë. Ndërsa filmi shqiptar flet për një Shqipëri në hall që po e shpëton Edi Rama, Erion Veliaj me ekipin e Lejfenëve dhe natyrisht, me kontributin e madh të "figurës më premtuese të Ballkanit" spiunin Remzi Lani.

# Veliaj përpiqet të fshehë provat e korrupsionit, zhduk faqet e internetit

Veliaj & Co prej një jave po përpiqet të fshehë gjurmët e mashtrimeve me paratë e taksapaguesve të huaj që ai i ka thithur në bizneset e tij private.

Janë disa faqe online që po shuhen për të fshehur të dhënat komprometuese për bizneset private të Veliajt & Co për të cilat janë hedhur shume para të cilat po zhduken çdo ditë nga interneti për të fshehur gjurmët. Po ashtu, logot e bizneseve të Velisë po zhduken edhe nga faqet online më komprometuese siç është edhe faqja e Partisë Socialiste.

Në këto faksimile paraqiten imazhe se si kanë përfunduar disa faqe online këto ditë dhe se si kanë qenë disa muaj më parë. Gazeta Sot ka dokumentuar një numër të madh faqesh që janë realizuar me paratë e donatorëve të destinuara për shoqërinë civile që janë shpenzuar nga Veliaj nëpërmjet bizneseve private që nuk rezultojnë të regjistruara në gjykatën e Tiranës dhe as në QKR.



Kjo është një faqe për të cilën janë harxhuar dhjetëra mijë dollarë për punësimin rinor e cila u zhduk para 3 ditësh nga interneti për të fshehur të dhënat komprometuese të cilat i disponon gazeta Sot.



Kjo eshte faqja e Fondacionit MJAFT që tregon se si thithen paratë e donatorëve në një numër bankar amerikan nëpërmjet një zyre të Erion Velisë që ndodhet në SHBA (BYL).



Kjo faqe e fondacionit MJAFT është zhdukur nga interneti

### Zhduket fondacioni, ambasadat të implikuara në zhdukjen e qindra mijë USD

# Paratë e Fondacionit MJAFT në llogaritë bankare të Erion Veliajt në Amerikë

Prej ditësh Gazeta Sot po publikon pjesë pjesë dosjerin e një nga skandaleve më të mëdha të shoqërisë civile në Ballkan dhe pa dyshim skandalin më të madh në Shqipëri, skandalin MJAFT&G99. Ajo që është publikuar deri më tani nuk vetëm maja e ajsbergut të korrupsionit të një prej spinoffeve më të errëta të Fondacionit Soros në Tiranë. Prej ditësh gazeta Sot po tregon me fakte të pakundërshtueshme të dhëna skandaloze për lejfenët e rinj të politikës së re përtej të majtës dhe të djathtës së Edi Ramës.

Sot do të publikojmë një të dhënë të re: se si Erion Veliaj ka aplikuar një nga lojërat më tipike të mësuesit të tij virtual, të kalimit të parave të tij nga njëra dorë në tjetrën, dhe se si i fsheh gjurmët e korrupsionit virtual.

Prej ditësh, Erion Veliaj po përpiqet të fshijë gjurmët online të një prej vrimave më të zeza të shoqërisë civile në Shqipëri: Fondacionit MJAFT. Faqe të tëra online fshihen dhe dëmtohen nga vetë ata që i kanë ndërtuar, sepse ato paraqesin me fakte dhe prova, teknikën e pastrimit të paligjshëm të parave nga shoqëria civile drejt financimit të qëllimeve elektorale. Siç paraqitëm edhe dje, Faqja zyrtare e Fondacionit MJAFT është fshirë plotësisht nga interneti, por fatmirësisht, Gazeta Sot disponon të gjitha faqet të ruajtura dhe të paprekura (me të gjitha të dhënat origjinale), në një CD e cila ka ardhur në redaksi. Sipas kësaj faqeje online, rezulton se Fondacioni MJAFT është krijuar në 2004 dhe ka shërbyer si degë filantropike e Lëvizjes MJAFT. Në fakt disa nga donatorët e Fondacionit MJAFT rezultojnë të jenë: Ambasada Gjermane, Ambasada Hollandeze, Ambasada Britanike, USAID, UNICEF, Fondacioni Soros në Shqipëri dhe Fondacioni Soros në Kosovë, Robert Bosch Foundation, Balkan Trust for Democracy, Banka Botërore, Balkan Youth Children Foundation, International Youth Foundation dhe diaspora shqiptare në SHBA. Shifrat që ka inkasuar kjo organizatë nga të dhënat e deritanishme, i kalon 1 milion euro dhe në ditët në vazhdim do të tregojmë se si ka funksionuar teknikisht kjo vrimë e zezë e parave të donatorëve të destinuara për shoqërinë civile në Shqipëri.

Prej disa muajsh ky Fondacion është zhdukur dhe nuk gjendet asnjë gjurmë e tij. Faqja prezantuese online është zhdukur, të dhënat bankare nuk publikohen më askund, raportet as që bëhet fjalë, dhe mbi të gjitha nuk ka asnjë deklaratë zyrtare për zhdukjen e tij. Nëse do të kërkonim në Gjykatën e Tiranës të dhëna për këtë Fondacion nuk do të gjendet asnjë urdhër për mbylljen dhe likuidimin e detyrimeve të tij përpara donatorëve dhe kreditorëve.

Të dhënat se kush është ky Fondacion, ku dhe kush e përfaqëson janë të përshkruara online në adresën www.mjaftfondation.org (faqja e të cilës është fshirë) sipas këtyre të dhënave:

VeVe Center Room 305, Tirana,

Email: info@mjaftfoundation.org

Executive Director: Jona Repishti (mailto:j.r@mjaftfondation.org)

Program Manager: Anisa Kaltanji (mailto:ak@mjaftfoundation.org)

Në fakt në këtë faqe si Drejtoreshë paraqitet Jona Repishti por nga të dhënat që disponon Gazeta Sot, përfaqësues i këtij Fondacioni është paraqitur në dokumente të tjera Z. Endri Fuga.

Këta persona, rezultojnë deri tani si persona përgjegjës dhe Gazeta Sot do t'u kërkojë prononcim për të shpjeguar se si u zhdukën qindra mijë euro një ditë të bukur papritur dhe pakujtuar, kur auditët kërkuan informacion se ku ndodhet ky Fondacion që u zhduk pa lënë gjurmë. Në zyrat ku duhet të ndodhej Fondacioni MJAFT nuk ka kush të përgjigjet, sepse personat, kompjuteri i financave dhe vetë zyra janë zhdukur.

Nuk ka asnjë gjurmë. Një Fondacion që ka qarkulluar mbi një milion euro deri para një viti, nuk i gjendet asnjë gjurmë. Gjurmët e projekteve të fundit të Fondacionit MJAFT të mbështetura nga UNICEF dhe Ambasada Gjermane gjenden online por vetë Fondacioni është zhdukur.

Pyetja që shtrohet është pse u zhduk ky Fondacion në kulmin e veprimtarisë së vet?

Përgjigja është shumë e thjeshtë dhe gjendet në një faqe online që tashmë është fshirë nga interneti por ndodhet e depozituar në Gazetën Sot.

**Në faqen ku prezantohet kërkesa për të thithur fondeve nga Fondacioni MJAFT (http://www.mjaftfoundation.org/fundraising_tool.htm) rezultojnë këto të dhëna:**

**BY CHECK:**

145 Swiss Ave., San Francisco, CA 94131 (Payable to BYL, memo Mjaft) or,

Payable to Mjaft Foundation, Rruga Elbasanit, Nr. 77.Tirana, Albania

**MONEY TRANSFER TO OUR BANK AÇOUNT:**

Credins Bank, Swift Code: CDISALTR For the beneficiary - Mjaft Foundation - Açount Number: 10198-01 Address: Rr. Ismail Qemali, Nr 21, Tirana, Albania

If you are a donor from the US the money will be payable to Balkan YouthLink (memo to Mjaft Foundation). Balkan YouthLink is our local partner is the United States.

Sipas këtyre të dhënave rezulton se paratë e Fondacionit MJAFT kanë përdorur si numër llogarie një numër bankar në Shtetet e Bashkuara në San Francisko, për llogari të BYL e cila siç shpjegohet më pas është Balkan Youth Link, e cila siç dihet ka si përfaqësues Erion Velinë. Kjo lojë e qarkullimit të parave për Fondacionin Mjaft në numrat e llogarisë së Erion Velisë, është një lojë e shkëlqyer qarkullimit të parave nga njëra organizatë tek tjetra me qëllim për të përfunduar në numrat e Erion Velisë. Veliaj, ky djalë i ri 23 vjeçar në 2004 (kur u krijua Fondacioni MJAFT) na paraqitet si një maestro i qarkullimit të parave në llogari të ndryshme bankare për të zhdukur gjurmët. Duke pasur parasysh se Fondacioni MJAFT një ditë të bukur, në kulmin e donacioneve të veta u zhduk pa lënë gjurmë (duke i lënë me gisht në gojë shumë donatorë që prisnin raportet që tregonin se si ishin shpenzuar paratë e veta), pyetja që shtrohet është se mund të kontrollohet numri bankar i Erion Velisë në San Francisko? Përgjigja është e thjeshtë: askush s'mund ta kontrollojë atë numër përveçse me vendim të formës së prerë të Byrosë Federale Amerikane, vendim i cili nuk asnjë gjasë të ndodhë.

Shifra e saktë se sa para ka qarkulluar Fondacioni MJAFT s'ka për t'u marrë vesh kurrë. Arsyeja është shumë e thjeshtë. Në një faqe tjetër të këtij Fondacioni shprehet hapur garancia që jep kjo organizatë shqiptare për të fshehur gjurmët e parave duke shkelur hapur ligjin shqiptar të kontrollit të pastrimit të




**Deklarata që ka nënshkruar stafi ndalon transparencën e fondeve**




**Numri Bankar ne san francisko**

fondacioni të zhdukur, në titullin "A do të japë Fondacioni MJAFT informacion për donacionet e tij?" në kapitullin Pyetje - Përgjigje, deklarohet:

"Absolutisht jo. Fondacioni MJAFT do t'i trajtojë të gjithë informacionin mbi donatorët në mënyrë konfidenciale. Kur ju të jepni donacion për Fondacioni MJAF, do të ndjeheni konfident, dhe çdo informacion për ju do të jetë në një database të sigurt që përdoret nga anëtarët e stafit me të cilët kemi firmosur një kontratë konfidencialiteti"

Siç shihet nga këto të dhëna fillestare që po publikojmë, Fondacioni MJAFT që ka qarkulluar mbi 1 milion euro, me një numër llogarie në San Francisko të kontrolluar nga Erion Veliaj, është zhdukur duke lënë gjurmë ka asgjësuar të gjithë të dhënat financiare. Por sipas ligjit shqiptar përderisa ky Fondacion vazhdon të jetë i regjistruar në Gjykatën e Tiranës dhe ka llogari të hapura me shumë donatorë, të cilët prej kohësh po presin të dinë se ku vajtën paratë e tyre. Erion Veliaj që ka detyruar anëtarët e zyrës së financave të këtij Fondacioni të nënshkruajnë një deklaratë konfidencialiteti (që do

nuk mund të mbulojë "diellin me shoshë". Sepse pavarësisht zhdukjes së kompjuterit të financave të Fondacionit, kontrollit që ka mbi numrat e tij bankar në Shqipëri dhe në Amerikë, ligji shqiptar përcakton qartë detyrimin e deklarimit të burimeve financiare dhe 2 vajzat që kanë përfaqësuar virtualisht fondacionin nuk mund të fshehin asgjë pasi ligji shqiptar i pastrimit të parave është shumë i qartë. Numrat e llogarisë së Fondacionit MJAFT që kanë qarkulluar mbi 1 milionë euro me lojëra spinoffesh sorosiane të modeluara nga mëkëmbësja financiare e Georg Soros në Shqipëri, Milva Ekonomi, nuk mund të fshihen të paktën në Shqipëri. Kemi të bëjmë me një histori të pastër "pastrimi" të parave nga një dorë në tjetrën dhe kështu kemi filluar ti japim lexuesit të nderuar teknikën e pasurimit të menjëhershëm të disa pionerëve të cilët themeluan biznese multimilionere dhe sot kanë blerë superapartamente gjigande me pishina në tarracë, me dy kate brenda pallatit, që lëvizin me automjete të shtrenjta, dhe që i kalojnë pushimet në vendet më të shtrenjta turistike të Mesdheut apo deri në Karaibe.

### Çfarë lidhje ka Marti Ahtisaari me Fondacionin Mjaft i cili është zhdukur në mënyrë misterioze

# Fondacioni i Erion Veliaj, si fondacioni i Sudes i jep kredi vëllait pa licencë

*"Fondacioni MJAFT qenka si i Sudes? Nuk e dija qe Maarti Ahtisaari themelon të tilla fondacione, po do sigurohem që t'ia them tani që e kemi më shpesh në rajon. Jam që jam, po i them dhe për ato piramidat që shokët e tij administruan para se të bëheshin milionerë e kështu kompletohet fotografia."*

*Erion Veliaj*

*Marrë nga shkrimi i Erion Velias "Mero Baze, me ne fund dhe PD-ja e ka gjetur Xhoanën e vet" botuar në gazeten Koha Jonë në 28 Tetor 2005.*




Këto ditë Gazeta Sot po paraqet një dossier të plotë mbi vrimën e zezë të Fondacionit MJAFT, i cili u zhduk nga Erion Veliaj për të fshehur gjurmët e korrupsionit galopant me donacionet ndërkombetare të destinuara për shoqërinë civile shqiptare. Një ndër pikat më të erreta të këtij Fondacioni është "zhdukja" pa lënë gjurmë e vet Fondacionit bashkë me qindra mijë eurot e tij, të cilat mund te kenë fluturuar një ditë të bukur në numrin që kontrollon Erion Veliaj në San Francisko, "145 Sëiss Ave., San Francisco, CA 94131 (Payable to BYL, memo Mjaft)". Një ndër arsyet kryesore që ky Fondacion u zhduk një ditë të bukur pa lënë gjurmë, është edhe se Fondacioni MJAFT ka gëlltitur një shumë të pallogaritshme parash (nga të dhënat paraprake rezultojnë rreth 400 mijë euro) nga Balkan Children and Youth Foundation (BCYF), (fondacion i themeluar edhe me mbështetjen e Fondacionit Soros), International Youth Foundation (IYF), Youth Business International (YBI), The Prince of Wales International Business Leaders Forum (Fondacioni i themeluar nga djali i Princeshës Lady Diana të Anglisë).

#### Parimi i konfliktit të interesit si mekanizëm korrupsioni për mbështetjen e Politikanit Erion Veliaj

Në 2004, Erion Veliaj zgjidhet si anëtar i Bordit të Balkan Youth Children Foundation, një Fondacion ndërkombëtar që u krijua me qëllim mbështetjen e iniciativave rinore në Ballkanin e pasluftës së Kosovës dhe ku President Nderi u zgjodh personaliteti i shquar Maarti Ahtisaari. Propozimi për zgjedhjen e Velisë si përfaqësues i Shqipërisë në krye të këtij Fondacioni, erdhi nga themeluesi i Fondacionit Soros në Shqipëri, shqiptaroamerikani Fron Nazi, i cili njihet si një ndër ekspertët kryesorë të Sorosit në Ballkan. Ky është njeriu që zgjodhi celulën e parë të Soros të përbërë nga ish-spiuni i Sigurimit të Shtetit Remzi Lani, Valdete Salen (ish-Sekretarja e Parë e Komitetit Qëndror të Rinisë të Universitetit të Tiranës "Enver Hoxha"), etj.

Në vitin 2004, sapo Erion Veliaj bëhet anëtar Bordi, një lumë donacionesh të destinuara për shoqatat rinore në Shqipëri të cilat aplikonin më kot për fonde, shkuan për MJAFT-ET e Velisë. Per këtë arsye po atë vit, u regjistrua në Gjykatën e Tiranës Fondacioni MJAFT, një organizatë e cila kërkonte të diversifikonte poliktikën e fund raising (mbledhje fondesh) nga donatorë të ndryshëm për MJAFT, pasi shumë donatorë i kishin rënë në erë lojës sorosiane të spinoff-eve, të cilët krijoheshin më qëllim për të thithur çdo lloj fondi që ekzistonte për shoqërinë civile në Shqipëri. Fondacioni MJAFT u prezantua në nivelin ekzekutiv me 2 emra vajzash të reja: Jona Repishti dhe Anisa Kaltanji, dy nga aktivistet kryesore të MJAFT në atë kohë, të cilat Veliaj i ka nën kontroll, pasi ato kanë nënshkruar një deklaratë konfidencialiteti që nuk i lejon të flasin për fondet e fondacionit (deklaratë që nuk njihet nga ligji shqiptar). Dhe megjithatë këto dy vajza mbajnë përgjegjësi të plotë çdo firmë që kanë vënë në transferimin e parave të këtij fondacioni në numrat e llogarive që ka përcaktuar Erion Veliaj.

Ajo që të bën më shumë përshtypje në qarkullimin e qindra mijë eurove të Fondacionit MJAFT, është loja e pokerit financiar të Velisë me shokë e shoqe, të cilën do e kenë mësuar nga Kryetarja e Bordit të Fondacionit MJAFT, Milva Ekonomi, (maestro e të gjithë parave dhe spinoffeve të George Soros që qarkullojnë në Shqipëri dhe Kosovë)

Sipas të dhënave të dokumentuara nga gazeta Sot, rezulton se Erion Veliaj i zgjedhur në vitin 2004 si anëtar i Bordit të Balkan Children and Youth Foundation, në krye të të cilit ishte zgjedhur personaliteti i shquar Maarti Ahtisaari, në konflikt të pastër interesi propozon, mbron dhe voton projektin e parashikuar nga Fondacioni MJAFT: "Youth Business Albania (YBA)" ("Biznesi Rinor Shqiptar"). Duke shkelur çdo parim të konkurrimit të barabartë për projektpropozime (pasi ishte jashtë çdo lloj kriteri të aplikimeve), i gjithë fondi i BCYF shkretoi të gjithë buxhetin bazë të këtij fondacioni. Shumë përfaqësues të shteteve të Ballkanit Perëndimor u ankuan, por Drejtori i asaj kohe (I propozuar dhe i punësuar me propozim të Fron Nazit, njeriu kryesor i Soros në Rajonet shqiptare) ua mbylli gojën duke i kërcenuar me përjashtim nga Fondacioni pasi kjo mbështetje ishte kërkesë e drejtpërdrejtë e Ahtisaarit (!).

Problemi bazë i pakënaqësisë ballkanike me emrin Veliaj, ishte konflikti i hapur i interesit që kishte një anëtar Bordi me mbështetjen e strukturës së tij. Sipas CV së Erion Velisë në Bordin e BCYF, ai prezantohet edhe si Drejtor Ekzekutiv i BalkansYouthLink, e cila kontrollon edhe numrat bankar të Fondacionit MJAFT në San Francisko (e cila sipas të dhënave të websitit të zhdukur të fondacionit MJAFT është më e rekomandueshmja për çdo transfertë donacionesh pasi është "pa taksa").

Problemi më i madh që kishte projekti i "Biznesi Rinor Shqiptar" ishte mënyra e harxhimit të parave. Ky projekt synonte dhënien e mikrokredive për të rinjtë, para të cilat do t'u jepeshin me grante deri në 4000 Euro për çdo biznes të ri dhe më pas me paratë që do të kthenin së bashku me përqindjet të kredituarit e parë do të kreditoheshin të tjerë të rinj dhe kështu me radhë do të krijohej një Bankë Rinore e cila do të funksiononte si subjekt i shoqërive të mikrokreditit. Kjo fushë përcaktohet si dhënie kredish dhe fondacionet që japin para me përqindje klasifikohen nga ligji shqiptar si piramida nëse nuk kanë një licencë të dhënë nga Banka e Shqipërisë.

Paratë e donatorëve më të rëndësishëm në botë, përfshirë Familjen Mbretërore Angleze, International Youth Foundation (IYF), Youth Business International (YBI), të cilat njihen botërisht për mbështetjen që i japin bizneseve dhe vetëpunësimit të të rinjve nëpërmjet fondeve të mikrokreditit, iu dhanë një organizate pas asnjë lloj eksperience në këtë fushë, pa asnjë lloj ekspertize të domosdoshme dhe të detyrueshme që kërkon fusha e mikrokreditit. Fondacioni MJAFT rezulton nga të dhënat e dokumentuara në gazetën Sot se nuk ka plotësuar asnjë kërkesë për t'iu njohur e drejta e dhënies së mikrokrediteve pranë Bordit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, as sipas ligjeve të para shkurtit 2007 dhe as ato pas shkurtit 2007. Fondacioni Mjaft nuk është licencuar nga Banka e Shqipërisë për të dhënë mikrokredit.

Në vitin e parë, shuma prej 55,800 dollarësh amerikanë, iu dha 15 bizneseve të reja, të cilat duhej ta kthenin me përqindje më të lartë për të shërbyer si kreditim i besueshëm dhe jashtë çdo risku. Personat që morën shumën ishin anëtarët e Lëvizjes MJAFT të cilët në kundërshtim me ligjin për OJF-të, e kthyen organizatën e tyre në një organizatë që ndan fitime. Por ajo që përcaktoi konfliktin më tipik të interesit, ishte kreditimi nga Erion Veliaj, i vëllait të vet Arbër Veliaj i cili edhe mori grantin maksimal prej 4000 eurosh. Ky operacion i paligjshëm financiar dhe i dënueshëm nga legjislacioni shqiptar, ndodhi nën hundën e Bankës së Shqipërisë, Ministrisë së Financave duke përfshirë në shkeljen e ligjit mbi piramidat e '97 edhe zyrtarë të lartë të kohës.

Problemi kryesor që pati grandi i parë i mikrokreditit, ishte zhdukja pa lënë gjurmë një dite të bukur e të gjithë fondit të mikrokredit rinor prej qindra mijë eurosh, fakt që ka implikuar në këtë lojë të shëmtuar vetë zyrtarët e BCYF. Këta zyrtarë gjatë këtyre ditëve që po plas ky skandal janë vënë në siklet se nuk po dinë si t'ë raportojnë dështimin e tyre dhe vrimën financiare me emrin Fondacioni MJAFT. Ata prej ditës së djeshme kanë hequr një link online në format pdf (të cilën e disponon gazeta Sot prej disa kohësh), në të cilën paraqiten të dhënat komprometuese se kush kontribuoi për paratë e mikrokreditit të paligjshëm rinor në Shqipëri, kush i mori dhe mbi të gjitha në formë spektakolare, tregohet Arbër Veliaj duke marrë paratë në një ceremoni zyrtare nga vetë i vëllai Erion Veliaj.

Qindra mijë euro të kontribuara për Shqipërinë nga komuniteti ndërkombëtar dhe të zhdukura nën hijen e rëndë të personalitetit Marti Ahtisaari, janë një nga rastet që tregon se si kanë abuzuar këta pionerë të politikës së re të korrupsionit galopant. Erion Veliaj dy vjet më parë i kujtoi Mero Bazes që e kishte akuzuar Fondacionin MJAFT si Fondacioni i Sudes, se po akuzonte Fondacionin që e paska krijuar Marti Ahtisaari. Tashmë i ngelet Ahtisarit ti përgjigjet pyetjes: a është ai krijues i fondacionit të Sudes në Shqipëri me emrin Fondacioni MJAFT numrin e llogarisë bankare në San Francisko të të cilit e kontrollon Erion Veliaj?

Kush është biznesi që qarkullon paratë e G99?

# Erion Veliaj, skemë për të fshehur burimin e financimit të forcës së tij G99

Skandali i këtyre ditëve që ka plasur në mënyrë ekskluzive Gazeta Sot me Mjaftin dhe G99 e Erion Velisë ka përfshirë në faqet e veta një numër të padëgjuar ambasadash dhe institucionesh ndërkombëtare duke formatuar vrimën më të zezë të parave të shoqërisë civile që ka funksionuar deri më sot. Prej ditësh gazeta Sot paraqet se si Politikani i Politikes së e të korrupsionit dhe mashtrimit, Erion Veliaj dhe shokët dhe shoqet e tij kanë abuzuar me paratë e donacioneve për Shqipërinë të destinuara për shoqërinë civile në Shqipëri. Nga të dhënat e para të botuara këto dy janë rezultojnë një numër shumë i madh donatorësh duke përbërë edhe një rekord fundraising (thithje fondesh) si për nga sasia e parave ashtu edhe nga numri i donatorëve. Emra ambasadorësh dhe drejtuesish organizatash ndërkombëtare me shumë reputacion implikohen çdo ditë në faqet e gazetës sot me praktika të paligjshme dhe korruptive si në kontratat e donacioneve për OJF të e Erion Velisë ashtu edhe për kontratat me bizneset e tij. Erion Veliaj sot drejton një organizatë e cila në kundërshtim me ligjin shqiptar për Partitë Politike financohet në mënyrë të paligjshme dhe krejtesisht jotransparente nga paratë që vijnë nga burime të dyshimta ndërkombëtare duke shkelur si legjislacionin shqiptar ashtu edhe atë nderkombëtar. Partia e re multimilionere e Erion Velisë i siguron qindra miliona lekë nëpërmjet teknikave te pastrimit të parave dukë përdorur numra bankarë jashtë Shqipërisë. Një nga rastet më tipike të numrave jashtë Shqipërisë është edhe numri i llogarisë bankare i dhurimeve që G99 ka publikuar online. Sipas të dhënave të faqes zyrtare të G99 (www. Erion Veliaj me vëllain e tij ka shpikur një teknikë të re të fshehjes së burimeve financiare të partisë së tij milionere. Veliaj ka krijuar një derdhje online parash per Grupimin e tij politik G99 drejt një biznesi privat me qendër në SHBA Mozaik.shpk me Adresë: 3450 Acworth Due Eest Rd, në, Suite 150, Acworth GA 30144, USA me nr tel: (1) 404-468-8554 dhe me adresë në Tiranë Adresa: Rr. Dervish Hima, P. Leskov 1/5,Tirane ,Tel: (+355) 42227877, biznes i cili funksionon në Shqipëri në fusha të shit-blerjes online dhe një ndër fushat e shërbimeve të saj është edhe realizimi i pagesave dhe transferove online. Arsyeja pse është zgjedhur nga Veliaj ky biznes për të derdhur paratë e G99 është shumë e thjeshtë. Mjafton të lexosh politikën e privacisë së ketij biznesi dhe kupton shumë:

"Tek Mozaik Sh.P.K., ne kuptojme mire ceshtjen e ruajtes se informacionit personal. Perdoruesit e internetit jane gjithmone te shqetesuar me te drejte se si apo ku do perfundoje informacioni i tyre.

Ne respektojme informacionin tuaj personal dhe e trajtojme ate me nje rendesi te veante. Ne nuk japim informacion mbi klientet tane asnje pale te trete per asnje arsye, perve në rastet ku bashkepunojme me organet e ligjit kur eshte kryer nje shkelje ligjore kunder kompanise sone.

Informacioni juaj personal eshte i sigurt me ne. Ky eshte premtimi yne per ju.

Informacioni personal i klienteve ruhet i kriptuar per siguri maksimale."



Ja dhurimet e paligjëshme online të G99



Ja detyrimi i Mozaik. sh.p.k për të mos treguar se ku i çon paratë e G99

Arsyeja pse Veliaj ka zgjedhur këtë kompani për të derdhur paratë e G99 online është pikërisht garancia që ka ai për të ruajtur në mënyrë sekrete llogarinë bankare të G99, e cila në mënyrë krejtësisht jo transparente nuk tregon destinacionin. Në asnjë të dhënë nuk jepet një numër bankar se ku përfundojnë paratë e G99. Nuk tregohet asnjë bankë apo nr bankar brenda apo jashtë Shqipërisë se ku depozitohen këto para. Por ajo që është më kryesorja është se burimet nga mund të financohet G99 mund të jenë edhe jashtë Shqipërisë dhe kjo është një shkelja e hapur e ligjit shqiptar për mbështetjen e forcave politike. Burime nga mbi 150 shtete mund të kontribuojne për forcen politike të Erion Veliajt dhe Ligji Shqiptar për partitë politike është shumë i qartë: nuk lejohet asnjë mbështetje nga jashtë. Ndaj dhe Veliaj me një gur ka vrarë 3 zogj. Duke zgjedhur një biznes amerikan që ruan me përpikmëri privacinë e klientit (G99 së Velisë), nuk lejon asnjë informacion mbi sasinë dhe kontribuuesin e transfertave financiare të klientit dhe aq më pak destinacionin e tyre. Kështu nuk prezantohet as minimumi i transparencës financiare, që është numri bankar ku depozitohen këto para. Veliaj ka krijuar kështu partneritet me një biznes i cili kryen transferuat e G99 por nuk mund të tregojë se ku i dërgon sepse ka kontratë privacie me maestron Veliaj. Siç shihet edhe nga faqja e internetit të Mozaik.shpk, ky biznes që është krijuar në Shqipëri, një vit pas krijimit të MJAFT, drejtohet nga një biznesmen amerikan dhe është i fokusuar në shërbime shit-blerjesh online. Klienti më i ri i tij është Erion Veliaj dhe G99, të cilet përdorin Mozaik.sh.p.k për të kryer transferta financiare të cilave nuk u gjendet as nami dhe as nishani.

Tashmë është e qartë se si funksionon gjithë mekanizmi i financimeve të G99, financime të padeklaruara deri më sot, të fshehura pas komedisë së Erion Velisë në Hotel Tirana në një asamble, ku sipas Velisë u bë transparencë financiare. Erion Veliaj u mbështet te transparenca e 1mijë lekëve të reja që kishin paguar 99 anëtarët ku vetëm salla (dhe shpenzimet e saj) e prenotuar nga G99, kushton më shumë se vetë kontributi i pjesëmarrësve. Veliaj, nuk tregoi kur bëri "transparencën" se ku i ka gjetur rreth çerek milioni euro kosto të G99. Veliaj as atëherë dhe as tani, nuk tregon se nga financohet Partia e tij e paligjshme e regjistruar si OJF në Gjykatën e Tiranës, një teknikë kjo për të siguruar financime nga burime që i ndalon legjislacioni shqiptar për forcat politike dhe sidomos legjislacioni për pastrimin e parave. Kjo forcë politike e paligjshme, e regjistruar si OJF, i shmanget kështu fuqisë së veprimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, i cili është edhe organi kompetent që kontrollon financat e forcave politike. Po kështu duke i kryer transfertat me një biznes të shitjeve online, që ka detyrim të fshehë çdo të dhënë mbi G99, Velija kërkon të manipulojë çdo raport financiar si të dëshirojë ai. Duke mos treguar numrin e llogarisë bankare të G99, ku duhet të përfundojnë këto para, është e pamundur të bëhet transparencë ligjore. Duke futur në lojë forcën e tij politike G99 si OJF, Veliaj siguron transferta financiare nga të gjitha vendet e botes, duke shkelur çdo parim ligjor, si në fushën e partive politike ashtu edhe në atë të pastrimit të parave. Kështu Veliaj, mund të shpikë çdo lloj kontributi mbi burimet e çerek milioni eurosh duke shpikur burime online. Të gjitha opsionet e transparencës "Made in Veliaj" janë një hapësirë e paparë korrupsioni dhe pastrimi të parave.

**Është e qartë se kush janë teknikat e Veliajt & Co:**

- numra llogarish bankare në Amerikë ku fluturojnë qindra miliona lekë të Fondacionit të Sudes me emrin Fondacioni MJAFT duke përfshirë të gjithë detyrimet financiare të mikrokrediteve që Veliaj i fsheh në mënyrë mashtruese pas emrit të nobelit të paqes Maarti Ahtisaari.
- krijim biznesesh të posaçme per faturime të parave të OJF ve të tij nëpërmjet njerëzve te tij të afërt, biznese të regjistruara si persona fizikë apo të paregjistruara fare duke qarkulluar në mënyrë të dyshimtë qindra miliona leke të donacioneve të huaja për shoqërinë civile apo edhe kontrata biznesi të dyshimta me vetë ambasadat
- shpenzime fiktive për aktivitetet e donatorëve të huaj dhe zhdukje të parave të donatorëve të huaj, në mënyrë të hapur duke implikuar vetë donatorët në lojën e tij të shëmtuar.

Sot forca politike G99 përcakton një model të qartë të politikës së re përtej të majtës dhe të djathtës, të fshehjes së financimeve multimilionere që kanë implikuar vetë ambasadorët e huaj.

Sot Erion Veliaj, Arbian Mazniku, Marinela Lika, etj, brenda një periudhe rekord që çdo amerikan do ta kishte zili, kanë blerë superapartamente dupleks në qendër te Tiranës, me pishina në tarracë, kanë super makina, kalojnë pushimet në plazhet më të shtrenjta të Mesdheut, bëjnë një jetë luksi që vetëm multimilionerët mund ta arrijnë.

### A është G99 transparente para qytetarëve

# Përse zgjodhi Erion Veliaj biznesin Mozaik.sh.p.k. për të qarkulluar paratë e formacionit politik G99?

Skema se si kanë qarkulluar 5.4milionë Euro të Lëvizjes MJAFT dhe se si financohet Formacioni Politik G99 po dekonstruktohet përditë nga Gazeta Sot nëpërmjet fakteve dhe faksimileve, link-eve online dhe fotografive duke hedhur dritë në një prej rrjeteve merimangë më të errëta të shoqërisë civile dhe politikës në 18 vitet e fundit. Mënyra se si janë krijuar 6 organizata jofitimprurëse, që kanë qarkulluar miliona euro, biznese të shumta në fusha të ndryshme nga Veliaj & Co, shmangiet juridike dhe fiskale të bizneseve personale, biznesi i tyre me projektet e Mjaft dhe biznesi i drejtpërdrejtë me ambasadat dhe organizatat ndërkombëtare, qarkullimi dhe fluturimi i parave brenda dhe jashtë Shqipërisë, krijimi i skemave të dhënies së kredive dhe ngritjes dhe zhdukjes së fondacioneve të paligjshme të mikrokreditit, duke kryer shkelje të hapur të ligjit për fondacionet piramidale, si dhe skemat e fshehjes së financimit të formacionit politik G99, po ravijëzojnë pak nga pak rrjetën e një merimange financimesh të paligjshme të politikës së re përtej të majtës dhe të djathtës.

E gjithë historia e Velisë & Co është një rast precedent që do të shërbejë në të ardhmen edhe si një kazus studimor në analizat politike dhe gjeopolitike të rajonit dhe më gjerë. Rasti Veliaj është një rast i cili meriton një vëmendje të veçantë për të kuptuar në miniaturë se si kanë funksionuar skemat e spinoffeve të George Soros në Europën Juglindore dhe madje në të gjithë botën. Rasti Veliaj dhe mënyra se si u katapultua ai në shoqërinë civile shqiptare dhe hap pas hapi, parazitizmi i tij bashkë me Edi Ramën në krye të "opozitës" shqiptare, do të jetë një model i mjaftueshëm për studentët e shkencave politike në vende të tjera për të kuptuar disa fenomene të reja politike në kohën e globalizimit.

Erion Veliaj, u katapultua në politikën shqiptare nëpërmjet një eksperimenti sorosian i fshehur pas komunitetit ndërkombëtar të përfaqësuar në vitin 2003 nga Ambasada e Mbretërisë së Hollandës, ku princesha e familjes mbretërore është edhe Drejtoresha e Marrëdhënieve Ndërkombëtare të Fondacionit Soros për gjithë Europën me qendër në Mbretërinë e Bashkuar (Britani). Qindra mijë euro të dhëna disa të rinjve të panjohur, ku i vetmi informacion për ta që kishin ambasadorët e huaj ishin fotografitë e tyre të veshur si femra, i lançuan ata në media në mënyrë të sforcuar dhe milionë pas milioni u krijua një skemë e re politike në të cilën financimet e huaja nuk mund të funksiononin dot më. Sipas ligjit shqiptar, partitë politike e kanë të ndaluar financimin nga donatorë të huaj, çka solli edhe nevojën e krijimit të skemave të fshehta të mbështetjes financiare për Lëvizjen e Mjaftit Elektoral me emrin e dyshimtë G99.

Vite më parë u krijua Fondacioni MJAFT, një fondacion që u zhduk bashkë me qindra mijë euro pa lënë gjurmë, i cili kishte një numër llogarie bankare në Amerikë të kontrolluar nga organizata tjetër e Erion Velisë Balkan Youth Link (BYL). Ky fondacion, "gjeneroi" një numër biznesesh për aktivistët e MJAFT, të cilët do të futeshin në politikë nëpërmjet skemave të spinoffeve sorosiane, duke e shtrirë këtë model spekulativ të shpikur nga Soros në Bursën e Wallstreet-it, nga shoqëria civile në terrenin e organizimit elektoral. "Grafik Propaganda" apo "Fshati Urban" i familjes Veliaj, një biznes i dyshimtë i implikuar në të gjitha faturimet e projekteve të Mjaftëve të Velisë, por i njohur për bizneset e shumta me institucione ndërkombëtare dhe me Bashkitë e kontrolluara nga PS, po ashtu si dhe Albanian Comunication Group sh.p.k. e regjistruar në 2 Tetor 2006 ne Gjykatën e Tiranës me kapital fillestar 111 milionë lekë nga Endri Fuga edhe nga "ortaku" Arbian Mazniku, janë vetëm maja e Ajsbergut se si qarkullojnë paratë e lidershipit të ri të politikës së re përtej të majtës dhe të djathtës. Fondacioni MJAFT kreditoi një numër ende të panjohur plotësisht biznesesh të aktivistëve dikur të MJAFT për t'i dhënë mbështetje financiare sot drejtimit të G99.

Këto skema që përdorën paratë e shoqërisë civile të dhëna bujarisht nga qeveritë e mike të Shqipërisë dhe disa fondacione filantropike të njohura në botë, për të krijuar kapitale për të mbështetur politikanët e rinj të skemave sorosiane po zbardhet pak nga pak nga ky dosjer i Gazetës Sot, dosjer që ka për qëllim t'i mësojë publikut shqiptar dhe jo vetëm, se si funksionojnë skemat mafioze në politikën e re në kohën e shoqërive të hapura përtej të majtës dhe të djathtës.

Në numrin e fundit të Gazetës Sot, nën titullin "Erion Veliaj, skemë për të fshehur burimin e financimit të forcës së tij G99" dhe nëntitull "Kush është biznesi që qarkullon paratë e G99" tregoi se si paratë e G99 faturoheshin online nga një biznes m emrin e çuditshëm por jo dhe aq të pakuptimtë: MOZAIK sh.p.k.

G99 duke u regjistruar si OJF në gjykatën e Tiranës për t'iu shmangur detyrimeve ligjore si të gjitha partitë e tjera për regjistrimin e 500 anëtarëve, supervizimi nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, si dhe më kryesorja: moslejimi i financimit nga subjekte apo individë jashtë Shqipërisë, përdorte në biznes si një urë lidhëse midis donacioneve online dhe financave të G99.

Erion Veliaj ka prezantuar disa herë në media se si ai kishte krijuar një parti aksionere ku anëtarët e tij (në fakt në Shtator ai kishte vetëm më pak se 100 anëtarë në Asamble ndërsa në gjykatë janë të regjistruar vetëm 9 anëtarë) financokan partitë e tyre me kuotizacione dhe një mënyrë "shumë demokratike" është sipas Veliajt, "modeli Obama" ku simpatizantët "dhurojnë online" (!)



http://www.ndnvirtualschool.org/generation5.htm



http://www.albmozaik.com/rrethnesh.aspx

Në fakt keqpërdorimi dhe abuzimi i hapur i Veliajt me imazhit Obama, apo i nobelit për paqe në botë Marti Ahtisari, është bërë praktikë e rregullt e tij. Dikur Veliaj kërkoi të fshihte skemën piramidale Fondacioni MJAFT, duke mashtruar sikur këtë fondacion e kishte krijuar Ahtisari. Vetëm para 1 jave, Veliaj deshi t'i fshihej denoncimit për skema korruptive, duke thënë se Obama e kishte mësuar të mos pyeste për përballjet e medias, por që do të përdorte Obamën për të justifikuar një nga skemat më të errëta të financimit të formacionit të tij politik G99, kjo ishte me të vërtetë e ekzagjeruar.

Është e vërtetë që Obama ka përdorur dhurimet online për të financuar fushatën e tij por po aq është e vërtetë, që dhurimet Obama i pranonte konform legjislacionit amerikan duke përjashtuar çdo qytetar joamerikan dhe dhurimet online ishin 1 $. Ndërkohë që edhe ky 1 $ ishte transparent sa edhe çdo shumë tjetër . Ndërsa skema Veliaj, shkel çdo parim të legjislacionit për formacionet politike, por edhe çdo parim të legjislacionit për pastrimin e parave.

Sepse skema Veliaj e gjoja "dhurimeve online", në faqen e internetit të "Mozaik" sh.p.k, është një shkelje e hapur e rregullave të financimit të formacioneve politike jo vetëm për legjislacionin shqiptar, por edhe për çdo vend tjetër. Sepse, përveç faktit që dhurimet mund t'i kryejë çdo kush që nga Antilet Holandeze e deri në Pakistan, sasia e parave nuk limitohet në asnjë shifër. Dhe kështu Veliaj e ka të kollajtë nesër të justifikojë milionat e G99, si buxhet i ligjshëm elektoral i dhuruar nga simpatizantët e tij qytetarë të ndershëm, studentët dhe adoleshentët që votojnë për herë të parë. Se si mund të dhurojë një qytetar buxhetor para për aktivitete në hotelin më luksoz të Himarës në kulmin e sezonit turistik, këtë vetëm ndonjë pensionist naiv mund ta besojë.

E vërteta therëse është se Erion Veliaj ka "shpikur" (ka mësuar nga mësuesit e tij të vjetër) një skemë të re të fshehjes së burimit të financimit të formacioneve politike shumë të rrezikshme për zgjedhjet e ardhshme, duke sofistikuar teknikat sorosiane të spinoffeve në fushatën e re zgjedhore 2009.

Sepse biznesi ku Erion Veliaj ka "besuar" të thithë paratë e kontributorëve dhe dashamirësve online, është një biznes që drejtohet nga personi "përgjegjës i menaxhimit financiar dhe i cilësisë së projekteve të MJAFT" (sipas Curiculumit të tij të prezantuar në faqen http://www.ndnvirtualschool.org/generation5.htm). Ky person është Endrit Kromidhja, një nga anëtarët dhe të angazhuarit e vjetër të MJAFT, Shoqata Kombëtare e Debatit (ANDA) e krijuar nga Fondacioni Soros në 2000 dhe që ishte organizata kryesore që krijoi MJAFT dhe konsulent në krijimin e skemës piramidale të kredive të paligjshme të Fondacionit MJAFT.

Në kohën kur fillon veprimtarinë kreditimi nga Erion Veliaj i shokëve të protestave, përgjegjësi i Lëvizjes MJAFT për financat dhe konsulenti i Fondacionit MJAFT, Endrit Kromidha, krijoi në vitin 21.10.2005 biznesin e tij të konsulencave dhe të ndërmjetësimit si person fizik (me nr vendimi 33881 të gjykatës Tiranë), dhe në 23.03.2007 emërohet si Administrator dhe përfaqësues ligjor i shoqërisë "MOZAIK" sh.p.k. me nr K71618010T e cila themelohet nga John Moore (i prezantuar online si President i shoqërisë) dhe Erion Vogli, të dy shtetas amerikanë që jetojnë në Amerikë. Kjo kompani është prezantuar si kompani amerikane, ndërkohë që sipas dokumentacionit rezulton të jetë kompani shqiptare. Presidenti i Mozaik ka një problem të vogël me legjislacionin shqiptar: nuk tregon në të dhënat e tij datelindjen megjithëse i prezantohet pasaporta. Këtu krijohet një paqartësi: pse shtetasi amerikan me emrin John Moore nuk ka datelindje? Ai ka nr pasaporte amerikane Nr.159718335. Por ska datelindje. Përse noterja nuk i ka kërkuar ditëlindjen shtetasit amerikan që është paraqitur sipas noterit për përgatitjen e dokumenteve? Por mund të behet edhe një pyetje tjetër: a ka qenë prezent ky shtetas amerikan para noterit? Apo vetëm nr i pasaportës i ardhur me SMS? Kush është ky president amerikan pa datelindje (kusht noterial para gjykatës) i kësaj kompanie që faturon paratë e Erion Veliajt? A ekziston me të vërtetë ai?

Ja si zbërthehet organigrama e oktapodit SOROS në Shqipëri, i cili dirigjohet nga celulat e PPSH

# MJAFT, pjellë e një grupimi njerëzish që zbatojnë skemat e SOROS

Shumë njerëz pasi shikojnë shkrimet e hedhura në gazetën SOT mbi lëvizjen MJAFT, pyesin se pse kjo gazetë i jep kaq rëndësi këtij grupimi pionieresh apo debatikasish pa identitet? Nëse e shikon nga jashtë gjithë këtë histori, mund tu jepet të drejtë lexuesvë, por, kur shikon se si po i shtrin këmbët në shoqërinë shqiptare oktapodi sorosian, del se këta njerëz janë rrezik serioz për shoqërinë dhe demokracinë e brishtë shqiptare. Përpara nesh kemi një grupim financiaro-politik-ekonomik që ka në llogaritë e tij bankare miliona Euro, mos të themi qindra milionë euro. Organigrama që u botua një ditë më parë nga gazeta SOT zbërthente skemën se si ka funksionuar ky grupim. Brenda këtij grupimi, kemi aparatçikë të Partisë së Punës, pjella të politbyrosë, si dhe spiunë të sigurimit të shtetit, të cilët hynë fuqishëm në shoqërinë civile, në politikë, dhe sferat e tjera financiare, duke dominuar dhe helmuar që në embrion zhvillimin demokratik të vendit. Në fakt kush është skema e krijimit të këtij oktapodi gjigand, i cili ka krijuar njërën nga meduzat e tij lëvizjen MJAFT dhe grupimin elektoral G99?

Në vitet '90 kur Fondacioni Soros krijoi Qendrën e Medias (Remzi Lani) Qendrën e Gruas (Delina Fico), Qendrën e Rinisë (Olsi Rama vëllai i Edi Ramës), Qendrën e Drejtësisë (Piro Misha), Programin AEDP (Milva Ekonomi) etj, u projektua pak nga pak nëpërmjet milionave euro të programeve operacionale, një influencë dominante në "tregun" e shoqërisë civile. Kjo influencë u konkludua në fund të viteve '90, dhe në fillim të viteve 2000 me krijimin e organizatave joqeveritare "të pavarura" të themeluara nga "Themeluesi" (d.m.th vetë George Soros i përfaqësuar ligjërisht nga Milva Ekonomi, Valdete Sala, Çapajev Gjokutaj, Agim Isaku, Piro Misha, Delina Fico, etj). Një ndër to ishte edhe Organizata Kombëtare e Debatit ANDA, e cila trashëgoi edhe backgroundin e Qendrës së Rinisë së Fondacionit Soros në Tiranë, dhe hapi i parë filloi me qindra mijë dollarë në bankë. Kjo organizatë u përfaqësua nga Arbjan Mazniku dhe Klotilda Ferhati, Endri Fuga, Florian Pustina, që siç njiheshin nga të gjithë në fund të viteve 90 si "fëmijët e Valdete Salës" për hir të besueshmërisë që ata kishin fituar. Për t'i dhënë influencë të fortë këtyre personazheve në tregun e OJF rinore, ata administronin çdo vit rreth 1.5 milionë euro të Fondacionit Soros për rininë që jepeshin në formë grantesh për organizatat rinore. Kështu këta studentë të viteve të para administronin dhe firmosnin, nën "supervizimin e rreptë" të Valdete Salës, të gjithë buxhetin e rinisë shqiptare për vite të tëra deri sa krijuan lëvizjen MJAFT. Paralel me shoqatën e tyre, këta komsomolas të rinj sorosian ndihmuan Erion Velinë që të krijonte me disa Debatikas të tjerë (siç e quanin veten këta drejtues të Shoqatës Kombëtare të Debatit) Lidhjen Rinore të Ballkanit (Balkan Youth Link), organizatë e cila u prezantua fillimisht si organizatë ndërkombëtare, por që në fakt Drejtor Ekzekutiv kishte Erion Velinë. Kjo organizatë nuk u krijua me themelues "Themeluesin" Soros, por, nëpërmjet asistencës së Valdete Salës, Arbjan Maznikut, Endri Fugës dhe Florian Pustinës, u konvertua në një spinoff sorosian. Motivet e mbështetjes bazoheshin në vëllazërinë e ngushtë që ekzistonte midis këtyre të rinjve debatikas që ishte krijuar në Kishën Baptiste Tiranë, pasi gati të gjithë ishin anëtarë të kësaj kishe. E gjithë skuadra e dy spinoffeve, në fakt, funksiononte si një team në çdo projekt, sepse njëra dorë lante tjetrën dhe aktivitetet i kishin të përbashkëta. Në 2002, pasi krijohet edhe Instituti i Lidershipit Rinor (një spinoff i spinoff-eve të BYL-A dhe ANDA), Erion Veliaj, nën një mbështetje të jashtëzakonshme të koordinuar nëpërmjet Remzi Lanit, Valdete Salës dhe Ambasadës Holandeze, organizojnë një shou ndërkombëtar në Chateau Linza në periferi të Tiranës të quajtur YLLI 2002, ku pas orës 11 të darkës pasi ishin larguar të gjithë personalitetet ndërkombëtare seriozë dhe kishin ngelur vetëm ata të tipit hollandez, u organizua një nga maskaradat më groteske, ku drejtuesit e rinj meshkuj debatikas u veshën si femra dhe çdo gjë u dokumentua gati për të fituar besimin e të gjithë zyrtarëve të donatorëve me prirje homoseksuale. Paralelisht me këtë proces, rrjeti Soros në Shqipëri kishte filluar përgatitjen e terrenit të lindjes së Lëvizjes MJAFT, duke rekrutuar nga njëra anë "individualitete" të shoqërisë civile që do të shërbenin si Bordi i Madh i kësaj Lëvizjeje dhe nga ana tjetër të spastronin shoqërinë civile nga organizata konkurente apo jo-sorosiane që nesër mund të pengonin "zgjerimin" e MJAFT në nivele lokale, në fund raising dhe në influencën mediatike.




Pas "suksesit" të YLLI 2002 para ambasadorëve dhe diplomatëve (në nivel profesionaliteti apo homoseksualiteti, pa fyer kërkënd për prirjet homoseksuale, pasi ne e respektojnë zgjedhjen e gjithsecilit se si e përdor veten), në periudhën Shtator - Dhjetor 2002 të gjithë drejtuesit e spinoffeve "të pavarura" sorosiane në Tiranë dhe rajon (Remzi Lani, Piro Misha, Valdete Sala, Milva Ekonomi, Delina Fico, etj.) u hodhën në sulm për të prezantuar YLLI-n e vërtetë të së ardhmes së rinisë shqiptare: "mesian e kthyer nga Amerika për të shpetuar Shqipërine", "njeriun që braktisi karrierën në OKB për të punuar në varfëri të plotë në atdheun e tij të dashur": Erion Veliaj.

Në numrin e ardhshëm do të tregojmë se si ky YLLI i shoqërisë civile themeloi dhe drejtoi në fillim MJAFT-in "duke biseduar në një kafe të Tiranës me shokët e tij" debatikas të kishës baptiste.

## Skema e krijimit të spionffeve sorosian dhe aktivizimi i Edi Ramës si përfaqësuesi politik

George Soros është shpikësi i modelit të spinoffeve në bursën e Wallstreett, një instrument i lindjes dhe zhdukjes së subjekteve të tipit ofshore të cilat Soros i ka përdorur për të ngritur gracka spekulative në lojën e tij të "vjedhjes" legale të parave të të tjerëve. Pas një suksesi spektakolar, për të cilat janë shkruar edhe libra në përdorimin e spinoffëve, Soros në mes të viteve 90 filloi të aplikojë lojën e spinoffëve edhe në rrjetin e fondacioneve të veta të shtrira kryesisht në Europën Lindore. Spinoff-et e shoqërisë civile janë organizata jo-qeveritare apo jo-fitimprurëse që krijohen nga zyrat e Soros dhe shfaqen në publik sikur janë të pavarura pavarësisht dokumentacionit të drejtpërdrejtë apo të fshehur të pronësisë në aktin e themelimit. Sipas modelit të Soros, organizatat spinoff janë organizata që themelohen dukshëm apo fshehur nga Soros, por në publik shfaqen si organizata të pavarura. Këto organizata bija të fondacioneve lokale Soros, kanë të gjitha një karakteristikë të përbashkët: nuk mund ta tradhtojnë kurrë themeluesin dhe janë bij që nuk plangprishen dot, për arsye jo thjesht të dokumentacionit por se janë "të besueshme". Që të jesh pjesë e spinoffit duhet të kesh të ngjashme "10 cilësitë e komunistit", pasi edhe personazhet që janë rekrutuar nga SOROS vijnë nga majat e organizatave bazë të Partisë së Punës. Personazhet që bëhen të besueshëm për t'ju dhënë e drejta për të administruar një spinoff sorosian, duhet të arrijnë që të bëjnë një figurë të mirë përballë hierarkisë vertikale të Soros që nga ekzekutivi nacional, ai rajonal (Budapest), ai në Londër (që e drejton Princesha e Hollandës Von Miss) e deri në zyrat e NeëYork ku ndodhen zyrat e OSI (Instituti i Shoqërisë së Hapur) që ndodhet disa kate nën një ndër korporatat më famëkeqe në botë, Soros Management Fund. Mund të ndodhë që vetë George Soros të dëgjojë për këtë personazh por ndonjë "fatlum" mund të ketë dhe fatin të takohet me vetë "Themeluesin". Mund të ndodhë që edhe të bëhet mik por ky është rast unik. Në Shqipëri këtë fat e kanë pasur dy vetë: Edi Rama dhe Milvà Ekonomi. I pari u bë mik në 1996, si pasojë e ironisë dhe më pas humorit që shkëmbyen kur dy personazhet po hanin supë në një drekë pune në një hotel luksoz të Budapestit (Soros po prezantohej me Bordin e Fondacionit të tij në Shqipëri) dhe tjetra në rrethana të paqarta por vetëm kur demonstroi një sukses të paparë për të inkasuar midis dy krizave të '97 dhe '99 në xhepat e George Soros mbi 100 milionë dollarë të destinuara për Shqipërinë nga komuniteti ndërkombëtar por edhe nga buxheti i shtetit shqiptar. Këta të dy kanë qenë dy personazhet më të afërt të Soros në Shqipëri i cili vjen vazhdimisht këtu (më shumë se në çdo vend tjetër Ballkanik) sepse edhe ka fituar më shumë këtu se kudo tjetër.

Lëvizja e organizuar nga Veliaj punësoi rrethin familjar

# 7 Ambasada sponsorizuar krijimin e MJAFT, hollandezët financuan 245 mijë Euro

Në filmin "shockumentary", të financuar nga taksapaguesit gjermanë dhe austriakë me qëllim promovimin e imazhit të Shqipërisë në Europë, "rilindasit e rinj" Erion Veliaj, Endri Fuga, Arbjan Mazniku, me shokë na tregojnë në sinkronizim të plotë historinë e lindjes së idesë së krijimit të MJAFT në një kafe të Tiranës në javën e parafundit të Dhjetorit 2002. Veliaj dhe Mazniku kërkojnë t'u mbushin mendjen shikuesve të filmit, se disa të rinj që vinin nga jashtë u mblodhën për të diskutuar hallet e Shqipërisë dhe bënë pyetjen e madhe se pse nuk bëhet Shqipëria? Këta të rinj, të cilët të kujtojnë këngën e Gino Paolit "Quattro amicci", shkuan pyetën në UNDP dhe ata u thanë se ka varfëri, pastaj shkuan pyetën te IOM dhe ata i thanë se ka trafik, ndërsa ata të UNEP iu thanë se ka probleme ambientale. Por në fund, Erioni e zbuloi përgjigjen e pyetjes së shekullit, e cila ishte apatia qytetare. Kështu i bie që andej nga fundi i Janarit (sepse periudha e Krishtlindjeve deri ne javën e parë të Janarit është pushim tek organizatat donatore) të jetë paraqitur projekti i Fushatës MJAFT pranë Ambasadës holandeze dhe 7 ambasada të tjera. Brenda 27 Shkurtit projekti i bie që të jetë paraqitur për aplikim në 7 ambasada, shto këtu edhe Fondacionin Soros, të jenë miratuar 245mijë euro vetëm nga Ambasada Holandeze dhe një shifër e pacaktuar nga 7 donatorët e tjerë, të jetë krijuar Bordi i 7 Ambasadorëve, te jenë përfunduar të gjitha. Në asnjë rast në historinë e shoqërisë civile në Shqipëri përveç kohës së krizës së Kosovës, nuk ka arritur një projekt të propozohet (jashtë aplikacioneve të rregullta), të jetë miratuar pranë 7 Ambasadave, të jetë miratuar, të jenë kaluar fondet prej qindra mijë eurosh, të jetë bërë gati struktura menaxheriale, të ketë filluar puna e produksionit gjigand të spoteve TV (numri më i madh i prodhuar ndonjëherë), dhe mbi të gjitha të jetë krijuar edhe një Bord me 7 Ambasadorë.

Në fakt i bie që Nadiri i Shoqërisë Civile, Erion Veliaj, t'i ketë bërë magji gjithë ambasadorëve.

Por këtu s'ka asgjë për tu habitur sepse kemi të bëjmë thjesht me një mashtrim.

Projekti i Fushatës MJAFT është shkruar nga Erion Veliaj në 6 Janar 2002, 12 muaj para mashtrimit të filmit Rilindja Shqiptare. Ky projektpropozim dështoi që në fillim sepse asnjë ambasadë nuk mund të mbështeste një projekt kaq absurd për nga shpenzimet e propozuara prej qindra miliona lekësh për postera dhe spote. Kjo solli edhe një angazhim të madh të strukturave të Soros në Shqipëri dhe Holandë, duke promovuar aktivitetin e famshëm YLLI 2002 ku meshkujt u veshën si femra.

Pas një lobimi të jashtëzakonshëm të Remzi Lanit, Valdete Salës, Çapajev Gjokutaj dhe sidomos të strukturave holandeze pranë të gjitha ambasadave dhe donatorëve në Tiranë, u prit dhe rasti i dëshiruar kur Qeveria Holandeze mori presidencën e radhës së OSBE në fillim të 2003. Duke qenë se Ambasada Holandeze nuk mund të influenconte dot pranë Ambasadës së SHBA, Ambasadës së Britanisë së Madhe, Ambasadës Gjermane, UNICEF, UNDP. Këtë rol e mori OSBE në Tiranë e sapo kryesuar nga Mbretëria e Holandës, e cila iu kërkoi që të mbështesnin dy organizatat e krijuara nga Soros, nëse donin të mbështesnin "të drejtat e njeriut, demokracinë dhe qeverisjen e mirë". Kështu kuptohet mekanizmi se si u përfshinë të gjithë donatorët më të rëndësishëm të Shqipërisë nëpërmjet Ambasadës Holandeze në mbështetjen e dy spinoff-eve sorosiane në Tiranë për të krijuar Lëvizjen MJAFT.

Siç shkruhet në një artikull të kohës të Revistës Javore LOBI të Maqedonisë (shkrim i shkruar nga Ardi Pulaj 1 ditë pas shpalljes së fushatës MJAFT) "Me financim të rëndësishëm nga Ambasada e Vendeve të Ulëta në Tiranë, iniciativa tregon edhe një herë përpjekjet e kryesueses së radhës së OSBE-së, Holandës, për të mbështetur të drejtat e njeriut, demokracinë dhe qeverisjen e mirë. Gjithashtu Ambasada Amerikane, e Mbretërisë së Bashkuar, Gjermanisë, UNICEF, PNUD, si dhe Fondacioni i Shoqërisë së Hapur për Shqipërinë, ishin partnere të kësaj faze të zbatimit në praktikë të MJAFT!-it."

Kështu që nëpërmjet mbështetjes politike të së OSBE së drejtuar nga holandezët, mbështetjes financiare të Ambasadës Holandeze dy spinoff-et sorosiane në Shqipëri: Organizata Kombëtare e Debatit (përfaqësues Arbjan Mazniku) dhe Lidhja Rinore e Ballkanit - Shqipëri (Drejtor Ekzekutiv Endri Fuga dhe Kryetar i Rrjetit Ndërkombëtar Erion Veliaj), arritën që të thithin kapitalin e parë fillestar për maratonën e tyre të gjatë drejt krijimit të MJAFT Elektoral G99.

Historia e bisedës në një kafe të Tiranës midis Velisë, Maznikut dhe Fugës për të iniciuar MJAFT në krishtlindjet e 2002, është një përrallë që i tregohet publikut për të fshehur të vërtetën e mbështetjes reale holandeze dhe sorosiane të lindjes së MJAFT. Kështu paratë e taksapaguesve gjermane të dhëna për promovimin e imazhit të Shqipërisë në Europë u përdorën për të fshehur përfundimisht pas 5 vjetësh të vërtetën e lojës sorosiane me mbështetje holandeze të vitit 2002-2003 për të krijuar një skemë të rrezikshme e cila do të përdorej për qëllimet politike të njeriut të Soros në Tiranë Edi Rama.

Ajo që nuk u tha në filmin e promovuar nga ambasadori gjerman "Rilindja Shqiptare" ishte se 40 ditë pas kafesë së famshme të Erion Velisë me Maznikut dhe Fugën, në 7 Shkurt 2007 u krijua në Gjykatën e Tiranës biznesi i personit fizik Denis Behlulit (vëllai baptist i Arbian Maznikut), biznes i prezantuar me emrin e famshëm C&PR Production që faturoi me shpejtësi të madhe një pjesë të majme të 245 mijë eurove të Ambasades Holandeze dhe të ambasadave të tjera, duke krijuar edhe modelin e ri të sorosianëve shqiptarë, ku shoqatat spinofe krijojnë biznese spinoffe që faturojnë qindra miliona lekë.

Ajo që nuk tregoi Mazniku në filmin Rilindja Shqiptare ishte se motra e tij u bë Financierja e Lëvizjes MJAFT ndërsa gruaja e tij Administratore, duke krijuar në cikël krejtësisht të mbyllur të të gjithë financimeve dhe faturimeve qindra milioneshe të Ambasadave. Kështu milionat vinin në numrat bankarë të kontrolluar nga Erion Veliaj si Drejtor Ekzkeutiv i Projektit, shpenzoheshin nga Arbian Mazniku, gruaja e tij dhe e motra, dhe faturoheshin nga vëllai i tij baptist Denis Behluli dhe vëllai i Erion Velisë: Arbër Veliaj (i cili punonte si partner i Denis Behlulit në C&PR). Kështu, dhjetëra mijë euro kartëmonedha konvertoheshin në fotokopje faturash me vula pa TVSH duke iu dorëzuar ambasadave nga Erion Veliaj.

A u audituan ndonjëherë paratë që inkasoi Veliaj & Co në 2003? Si u raportua faturimi i miliona lekëve nga një biznes person fizik (kur ligji shqiptar dhe ai ndërkombëtar kërkon fatura me TVSH duke iu referuar shifrave përkatëse dhe çdo biznes i vogel që qarkullon mbi 8milionë lekë kalon direkt në person juridik)? Po fakti që motra e Maznikut dhe anëtarë të tjerë të familjes qarkullonin të gjitha paratë e MJAFTit a iu bëri përshtypje ndopak? Përse disa vite më vonë motra e Arbër Manzikut u detyrua të jepte dorëheqje?



MJAFT, gropa e zezë e parave të donatorëve dhe taksapaguesve shqiptarë

# Ja skema se si Erion Veliaj mori 400 milionë lekë nga KQZ pa tender dhe me urdhër te Celibashit

Në vazhdim të serialit të prezantimit real para shqiptarëve të fenomenit MJAFT&Veliaj, mund të themi me plot gojën se në financimet për aktivizimin e kësaj bicim organizate është i përfshirë edhe shteti shqiptar. Përveç diplomatëve, të cilët tashmë heshtin për paratë që ju zhdukin taksapaguesve të tyre për të na implementuar figurën e si ErionVeliajt, si shembëlltyrën e njeriut që do ndryshojë Shqipërinë, në lojë është ngatërruar edhe shteti shqiptar që ka dhënë plot 400 milionë lekë nga pratë e taksapaguesve. Këto para janë dhënë për të ushtruar zanatin politik ky pinjoll i vogël i diplomatëve profesionistë, deri në momentin që e transformoi lëvizjen e tij nga lëvizje ambasadorësh, edhe në lëvizje të kryetarit të bashkisë së Tiranës, ose kryetarit të biznesit të lejeve të ndërtimit. Tashmë kjo lëvizje e cila na u paraqit deri dje si shoqëri civile, është shndërruar në kamikaze të politikës së Edi Ramës, Gramoz Ruçit, Namik Dokles, Fatmir Xhafës etj. Goxha politikë e re kjo, me ish ministrin e brendshëm të shtetit diktatorial enverist, apo me sekretarin e Komitetit Qendror të Rinisë Xhafa dhe me kandidatin për president në shtein monist të Ramiz Alisë. Politika ndërkombëtare perëndimore e mbështetur në eksperiencën komuniste ka nxjerrë tashmë në skenë edhe embrionin e ri të politikës së qoftëlargut zotin Veliaj.

Për të kuptuar mekanizmat që po përdor sot Erion Veliaj për të thithur paratë e donatorëve të huaj për mbështetjen financiare dhe institucionale të Formaçionit të tij Politik sorosian G99 nëpërmjet MJAF në zgjedhjet e 2009, duhet të kuptojmë se si është "stërvitur" dhe mbështetur ai nga "investitorët holandezë" të Tiranës në zgjedhjet e kaluara.

Në Korrik 2003 sapo ishin harxhuar 245 mijë euro të Ambasadës Holandeze dhe rreth 150 mijë euro të tjera nga institucionet e tjera ndërkombëtare të Tiranës të organizuara nga OSBE që drejtohej nga holandezët (kohë e cila u prit me ankth 12 muaj nga strukturat e Soros në Tiranë dhe vetë holandezët e Tiranës me qëllim sigurimin e influencës institucionale në të gjitha ambasadat e Tiranës për ti bindur për mbështetjen e MJAFT). As një muaj pas harxhimit me urgjencë të qindra milionë lekëve për vetëm 4 muaj të faturuar nga biznesi që vetë kishin hapur me emrin C&PR Production që drejtohej nga Denis Behluli, Ambasada Holandeze, e mbështetur nga OSBE e cila drejtohej nga Presidenca Holandeze, lëvron edhe një shumë tjetër për Fondacionin Soros jashtë çdo procedure aplikimi. Rreth tridhjetë milionë lekë të tjera për xhiro me autobus për realizimin e një projekti me metodologji të vjedhur. Kjo eksperiencë turistike e MJAFT që kushtoi në total mbi 110 milionë lekë, synonte të stërviste politikanët e rinj të G99 për procesin e zgjedhjeve dhe vendosjen e raporteve me partitë politike. Një vit më pas, MJAFT, me ndërhyrje të fortë nga Ambasadori holandez, OSBE dhe drejtuesit e Soros në Tiranë, nëpërmjet një strategjie të ashpër për të hequr qafe të gjithë konkurrentët e MJAFT nga fusha e projekteve të zgjedhjeve, krijojnë një lidhje të ngushtë me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve të drejtuar në atë kohë nga Ilirian Celibashi. Qëllimi i forcimit të lidhjeve midis Veliajt dhe Celibashit, bazoheshin tek shuma e madhe e parave që në atë kohë Celibashi merrte nga donatorët ndërkombëtarë për realizimin e zgjedhjeve në Shqipëri. Në atë kohë Celibashit i lëvrohen rreth 350 mijë euro për edukimin e votuesve për herë të parë, fonde të cilat duhet ti përdorte në bashkëpunim me OJF e specializuara për edukimin e votuesve. Ky fond nuk u tenderua në asnjë rast sipas procedurave të ligjshme që kërkonte KQZ dhe institucionet qeveritare, por nëpërmjet një marrëveshje të përbashkët midis OSBE dhe KQZ, që ky fond binte i gjithi në duart e Erion Velisë. Kjo shumë i bashkëngjitej edhe shifrës prej 39 mijë eurosh të ambasadës holandeze për sondazhin e famshëm të Gallupit të pavërtetë, shifër që i bashkangjitej edhe 120 mijë eurove të tjera të shumë donatorëve të tjerë për të cilët lobonte OSBE, Ambasada Hollandeze dhe Fondacioni Soros Tiranë. Ndërkohë që totali i shifrës që lëvroi Mbretëria e Holandës për edukimin e votuesve dhe sondazhin ishte 276 mijë euro, Mbretëri, Princesha e të vilës është edhe Drejtoreshë e Fondacionit Soros për Europën me qendër në Londër.

Kështu 400 milionë lekë të dhëna shtetit shqiptar, Erion Veliaj i mori pa tenderim apo prokurim, thjesht me një marrëveshje, megjithëse këto fonde ishin pronë e shtetit shqiptar për organizimin e zgjedhjeve. Edhe vetë sondazhi i famshëm, i cili pavarësisht mashtrimeve të mëvonta të Velisë për saktësinë e tij, (fakt krejtësisht i pavërtetë pasi Veliaj bën lojëra fjalësh siç e ka zakon), ishte pjesë e mbështetjes të institucioneve të huaja për infrastrukturën e organizimit të zgjedhjeve dhe edukimin e pjesmarrjes së qytetarëve në votime. Duke pasur 3 lobistë kryesorë në tregun e donatorëe dhe mbështetjen e drejtpërdrejtë të Ilirian Celibashit të KQZ, Veliaj vazhdoi të faturonte qindra miliona lekë jo vbetëm me biznesin e tyre C&PR Production por edhe me futjen në lojë të biznesit të ri Grafik Propaganda që drejtohej nga familja Veliaj (biznes i cili nuk rezulton të jetë regjistruar ndonjëherë në Gjykatën e Tiranës). Kështu, i vetmi tender që u bë në atë kohë ishte vetë përqindja e sondazhit, përqindje të cilat Veliaj i tenderoi në netë të tëra duke biseduar me disa diplomatë të rëndësishëm në Tiranë, por temën e sondazheve dhe monitorimeve të MJAFT do t'a trajtojmë një herë tjetër.

Ajo që ka rëndësi në këtë histori dhe duhet theksuar ka të bëjë me mekanizmat e thithjes së fondeve të zgjedhjeve, ku funksionarë të lartë përdoren për kalimin e fondeve të destinuara për institucionet qeveritare pa proçedura prokurimi apo tenderimi siç e kërkon ligji, por nga ana tjetër edhe për të identifikuar aktorët holandezo-sorosianë që kanë lobuar për Velinë dhe Lëvizjen e tij paraelektorale MJAFT.










Paratë që u hodhën në atë kohë nga donatorët e tjerë ishin të shumta për proçesin zgjedhor, por më tipiket janë financimet që u nëpërmjet OSBE nga Ambasada Gjermane (60 milionë lekë), Norvegjia, Italia, Japonia, etj.

Në uebsitin e KQZ ndodhet edhe një kopje e projektit "FilloVoto", por nuk tregohet asnjë proçedurë e ndjekur për superfinancimin MJAFT, dhe mbi të gjitha është fshirë faqja që tregon buxhetin dhe sasinë e parave që duhet ti jepeshin MJAFT. Në faqen e KQZ nuk tegohet se si raportuan qindra miliona lekë, sa nga këto u faturuan nga personi fizik Denis Behluli (i fshehur nën emrin e C&PR Production) sa u faturuan nga Arbër Veliaj (vëlai i Erion Velias), dhe çfarë faturash janë përdorur për këtë qëllim me TVSH apo jo.

Vetëm një vit më vonë, Celibashi u shpërblye nga Veliaj i MJAFT dhe Capajev Gjokutaj i Soros për shërbimin e kryer duke përfituar dhjetra miliona lekë nga Fondacioni Soros dhe donatorë të tjerë që siguroi Veliaj & Co për monitorimin e zgjedhjeve 2007, ku kandidonte "babai" i tij shpirtëror siç ka filluar të quajë Edi Ramën në rrethet diplomatike.

Se si u shpenzuan paratë e MJAFT në fushatat elektorale 2003, 2005, 2007 këtë e dinë më mirë bizneset e tyre familjare që i faturuan ato duke maksimalizuar gamën e mbulimit të zërave të ndryshëm, por është një fakt që dihet që numri i vëzhguesve të MJAF që pretendon se ka 8000 anëtarë ishte më pak se 200 persona megjithë lajmërimet e shumta që u bënë në Shqipëri dhe në diasporë. Të rinjtë nuk kanë besuar kurrë tek Veliaj & Co ndaj dhe e kanë braktisur gjithmonë në protestat e tij me pak persona, apo edhe në aksionet elektorale të G99 që me zor mbledh megjithë insistimin e drejtuesve sorosianë të universiteteve private, drejtorëve të donatorëve që telefonojnë shoqatat kudo munden deri duke iu bërë të qartë se nëse nuk mbështesin Velinë do të ngelen pa fonde, por edhe kjo është një çështje që do të trajtohet në ditët në vazhdim.

Ajo që duhej theksuar në këtë material është se teknikat e thithjes së parave për fushatat elektorale të Erion Velisë janë mbështetur dhe superfinancuar nga holandezet e ambasadës dhe lobimi politik i OSBE holandeze të Tiranës (që jo rastësisht drejtohet nga një holandez pikërisht kur Veliaj ka më shumë nevojë se kurrë për OSBE në për thithjen e fondeve).

Veliaj ka thithur në 3 fushatat elektorale të kaluara rreth 1 miliardë lekë por në 2009 ai ëndërron të bëjë goditjen e madhe duke shpresuar se do të sigurojë me projektet e MJAF të kontrolluar ende prej tij, rreth 1 miliardë lekë (deri tani Gazeta Sot ka të dhëna për disa projektaplikime që kapin shifrën prej 500 mijë eurosh por këtu nuk përfshihen fondet që do ti kërkohen Fondacionit Soros dhe partnerëve të tij të ngushtë në Perëndim).

# Erion Veliaj, nëpërmjet Mjaft i kërkon ndërkombëtarëve 500 mijë euro për monitorimin e zgjedhjeve të vitit 2009

Prej disa ditwsh gazeta Sot ka zbardhur skemën e qarkullimit të parave të donatorëve të huaj të destinuara për shqoërinë civile shqiptare të cilat u përdorën nga një grupim i krijuar nga Fondacioni Soros në Shqipëri për të hedhur në tregun politik spinoff-in e parë elektoral në Shqipëri: Lëvizjen G99. Ky formacion politik i regjistruar në Gjykatën e Tiranës si OJF me qëllim thithjen e fondeve duke iu shmangur legjislacionit shqiptar për financimin e partive politike dhe thithjen e fondeve nga jashtë Shqipërisë, përfshin brenda vetes edhe Qendrën MJAFT (Drejtor Ekzekutiv dhe Kryetar i të cilit është njëkohësisht ende Erion Veliaj), organizatën e regjistruar në SHBA Ballkan Youth Link (Drejtor Ekzekutiv është Erion Veliaj), Instituti i Lidershipit Rinor dhe Ballkan Youth Link (Drejtor Ekzekutiv është Endri Fuga), Instituti Agenda (Drejtor Ekzekutiv sapo është emrëruar Arbjan Manziku sepse Milva Ekonomi duket se ka planifikuar të bëhet Drejtore Ekzekutiv e Fondacionit Soros pas dorëheqjes së Çapajev Gjokutaj për tu bërë Drejtor Ekzekutiv i spinoffit tjetër sorosian Fondacioni ABC), dhe shumë OJF të tjera sorosiane, të cilat po krijojnë një precedent të padëgjuar më parë për devijimin e fondeve të donatorëve ndërkombëtarë drejt financimit të partive politike.

Lëvizja G99 apo ky MJAFT Elektoral, i qarkullon paratw nëpërmjet një biznesi me emrin Mozaik sh.p.k. i cili drejtohet nga Endrit Kromidhja i cili ka mbuluar konsulencën financiare në politikat e mikrokreditit të paligjshëm të dhëna nga Fondacioni piramidal MJAFT (i zhdukur pa lënë gjurmë me gjithë qindra mijë euro që nuk dihet se ku kanë shkuar). Ky biznes i krijuar në të njëjtin vit me G99 i shërben Erion Velisë për garantimin e privacisë së burimeve të fondeve të G99, por edhe si koperturë për të mos treguar se ku i gjen qindra milionë lekë kjo parti e re e "njerëzve të ndershëm dhe të përkushtuar" që kanë ulëritur me vite për transparencën e politikanëve dhe partive politike, ndërsa sot nuk tregojnë se nga i gjen qindra milionë lekë shpenzime ky formacion milionerësh të shoqërisë civile.

Ndërsa gjatë kohës së qarkullimit të miliarda lekëve të MJAFT Erion Veliaj & Co përdornin 2 bizneset e tyre të posaçme C&PR Production dhe Grafik Propaganda për të fryrë faturat që të justifikonin miliardat e donatorëve që i administronin anëtarët e familjeve të grupit të tyre, modeli i ri i Mozaik sh.p.k. i përgjegjësit të financave të MJAFT shërben për të kundërtën, për të fshehur burimet reale të milionave të G99.

Problemi më tipik i financimeve të G99 është loja me regjistrimin juridik si OJF e cila i jep mundësi Velisë që të inkasojë shuma parash që do t'i shërbejnë atij për të financuar fushatën e tij elektorale. Para 6 muajsh Erion Veliaj së bashku me Remzi Lanin u nisën për në Shtetet e Bashkuara të Amerikës sipas një agende të përgatitur nga OSI (Instituti i Shoqërisë së Hapur i Rrjetit të Fondacioneve Soros me qendër në NeëYork). Sipas websitit të G99 (www.g99.org) të përgatitur nga i vëllai, Erion Veliaj "zhvilloi takime me disa nga filantropitë amerikane si fondacionin Soros, Carnegie Endowment, National Endowment for Democracy (NED), dhe Freedom House. Gjatë këtyre bisedave ish-aktivisti i shoqërisë civile, kërkoi rritje të interesit nga filantropitë amerikane për shoqërinë civile në Shqipëri duke e konsideruar tranzicionin në Shqipëri 'një punë të papërfunduar ende'." Siç dihet MJAFT, Drejtor Ekzekutiv dhe Kryetar i të cilës ende është Erion Veliaj, duke kontrolluar kësisoj të gjitha paratë në numrat dhe llogaritë bankare brenda dhe jashtë Shqipërisë, është një proces aplikimi për rreth gjysmë milionë euro, të cilët do të shërbejnë për të mbështetur G99 në zgjedhjet parlamentare të 2009.

Është e qartë se Veliaj dhe Ekonomi duke pasur mbështetjen miliardere të Soros dhe Ambasadës Hollandeze nuk kanë dhe aq nevojë për këto para, por ajo që duket se i intereson më shumë Veliajt është prestigji i financimeve për ti përdorur si argument të mbështetjes së tij ndërkombëtare. Një ndër projektet më tipike që po kërkon MJAFT të realizojë për llogari të G99, është edhe transparenca e xhepave të kandidatëve në zgjedhje. Në fakt ky projekt i intereson tek mase Velisë për të imunizuar grupimin e tij të dyshimtë që kërkon të fshehë bizneset multimilionere që ka denoncuar gazeta Sot gjatë ditëve të shkuara. Kështu Veliaj duke pasur bandën e tij të "MJAFT Boys" (siç i quan pranë ndërkombëtarëve) me një gur vret dy zogj: nga njëra anë godet kundërshtarët me gjobat e tij tipike siç ka bërë me projektin www.unevotoj.com duke falsifikuar të dhënat për kundërshtarët e vet politikë si në rastin e Pëllumb Xhufit (të cilit i falsifikuan pasurinë), ashtu edhe në rastin e Ndre Legisiti (që i shpikën qindra mungesa pa arsye). Ndërkohë një nga hallet kryesore të G99 është edukimi i votuesve të rinj, të cilën Veliaj e synon si elektorat duke planifikuar përdorimin e riaktivizimit të fushatës së tij "ShkundeVotën" me një emër më të përshtatshëm elektoral të tipit "Do t'ja Dalim". Sipas materialeve që grupi i Veliaj po lobon rezulton se qindra mijë dollarë dhe qindra mijë euro po shpresohet të thithen nga donatorë amerikanë dhe evropianë, një pjesë e të cilëve mund të kalojë drejpërdrejtë për partinë luksoze sorosiane G99. Tashmë i gjithë vëzhgimi i zgjedhjeve është pjesë e planit monitorues të




Faksimile nga faqa g99.org ku tregohet për takimet e Erion Velisë dhe Remzi Lanit në SHBA për të kërkuar mbështetje.

kontrolluar nga G99, si një mekanizëm personal i Edi Ramës çka e komprometon plotësisht procesin vëzhgimin zgjedhor.

Tashmë pas shkretimit të shoqërisë civile në Shqipëri nëpërmjet spinofflëve sorosianë duke zbehur çdo zë alternativ dhe monopolizuar të gjithë zërat e shoqërisë civile në strukturat e Soros dhe G99, vëzhgimi duket qartë se do të merret nën kontroll të strukturabe të krijuara nga Soros të cilat do të synojnë që të fusin në mënyrë të sforcuar Velinë me disa shokë në Parlamentin e ardhshëm.

Të gjithë njerezit e Soros në Shqipëri po punojnë për thithjen e fondeve nga jashtë Shqipërisë për të financuar Velinë dhe për të marrë nën kontroll monitorimin e zgjedhjeve si një armë e Edi Ramës për të vjedhur votat e kundërshtarëve të vet politikë.

Plani për heqjen qafe të kundërshtarëve të Ramës nëpërmjet projekteve të "shoqërisë civile", duket qartë në vetë kronikën që ka përgatitur Erion Veliaj dhe ish-spiuni Remzi Lani gjatë ditëve të para të Majit 2008 në Uashington D.C. ku siç pretendohet nga këta të dy, ish-Ambasadorja e SHBA në Shqipëri, Marisa Lino, "inkurajoi pjesëmarrjen e të rinjve në politikë. Lino përshëndeti reformën e re elektorale si një fitore për shqiptarët dhe humbje e mirëpritur për partitë 'private' pa elektorat." Duke iu referuar sloganit të Erion Velisë për LSI si një "parti private" nuk është e qartë nëse është Mariza Lino apo Veliaj është ai që ka cituar këto fjalë. Por tashmë bëhet e qartë se reforma elektorale e denoncuar nga LSI, si një përpjekje për të vjedhur votat e veta nga Edi Rama, paska pasur një fushatë të organizuar nga Fondacioni Soros në Shtetet e Bashkuara të Amerikës për neutralizimin e faktorit amerikan nëpërmjet dy figurave sorosiane të Tiranës Remzi Lani dhe Erion Veliaj.

Investigimi dhe zbulimi që i ka bërë këto ditë mënyrat e kontrollit të parave të MJAFT dhe G99, kontrolli i plotë ligjor dhe financiar i dy organizatave nga lidershipi i G99 i përfaqësuar nga Erion Veliaj, Arbjan Mazniku, Endri Fuga, Marinela Lika, Milva Ekonomi, Klotilda Ferhati dhe Alken Myftiu, ka sjellë një kaos të vërtetë administrativ dhe komunikativ në këto dy organizata. Rrjeta e merimangës e thurur me aq kujdes prej vitesh dhe në mënyrë të veçantë gjatë 2008 nga Veliaj, Lani, Ekonomi, Fondacioni Soros Tiranë dhe New York, implikimi i drejtpërdrejtë i shumë diplomatëve të huaj për të krijuar një "goditje" të madhe financiare si mbështetje për G99 nëpërmjet MJAFT apo edhe direkt për G99 (pasi ajo është ende e regjistruar në Gjykatën e Tiranës si një OJF) këto ditë është vënë në rrezik.

Shumat e jashtëzakonshme që po kërkohen të thithen këto javë nga donatoret ndërkombetarë janë vënë në rrezik nga skandali që po plas pak nga pak këto ditë në nivele ndërkombëtare dhe me dhjetra sorosianë dhe diplomatë të huaj të implikuar në aferat e Erion Velisë dhe Edi Ramës janë vënë në një aksion të jashtëzakonshëm "diplomatik" për të "trukuar" imazhin e krisur të "rilindasve të rinj". Shumë fondacione amerikane si NDI, Carnegie Endowment, National Endowment for Democracy (NED), Freedom House, Rockfeller Fondation, dhe struktura të tjera evropiane, janë targetuar prej kohësh nga Erion Veliaj & Co si burime potenciale të financimit të formacionit të tyre politik G99, të fshehur pas Lëvizjes MJAFT. Një numër i madh institucionesh qeveritare dhe joqeveritare evropiane janë targetuar nëpërmjet implikimit të diplomatëve të huaj në Tiranë dhe jashtë saj. Lojërat sorosiane të thurura me aq kujdes në vite këto ditë janë vënë në një krizë reale pasi merimanga soros është mësuar të punojë underground në errësirë dhe nuk mund t përballojë dot dritën që hedh e vetmja media e pakontrolluar nga ajo në Tiranë, sepse tashmë jehona e skandalit që ka plasur dhe do të plasë në ditët në vazhdim Gazeta Sot, ka filluar të përhapet pak nga pak në kancelaritë evropiane dhe ato amerikane.

# Për ambasadat dhe donatorët:

## Ja skema e mashtrimit të Erion Veliaj me fondet për shoqërinë civile denoncuar nga Gazeta Sot

Prej javësh, çdo ditë, Gazeta Sot po denoncon skemën e korrupsionit të krijimit dhe të funksionimit të MJAFT-it elektoral nën emrin devijant G99. Denoncimi i Gazetës Sot bazohet në një investigim të plotë të gjithë historisë jotransparente dhe të fshehtë të krijimit dhe mbarsjes së Lëvizjes MJAFT nga strukturat e Soros në Shqipëri, me qëllim, kapjen e paligjshme të politikës nëpërmjet devijimit të parave të taksapaguesve të huaj të destinuar për shoqërinë civile shqiptare. Dosjeri që ka botuar dhe do të botojë vazhdimisht gazeta Sot, për të dekonstruktuar të gjithë skemat sorosiane që kanë implikuar edhe shumë diplomatë dhe zyrtarë të huaj, është bazuar vetëm në fakte dhe dokumente juridike që pasqyrojnë vetëm një pjesë të ajsbergut sorosian të Tiranës, dhe çdo detaj i publikuar është studiuar me vëmendje të madhe nga specialistë të ligjit, financave dhe shoqërisë civile. Çdo fakt që publikohet prej 3 javësh vjen si pasojë e një kërkimi investigativ që do të shërbejë si shembull profesionalizmi dhe kurajë qytetare për të gjithë median shqiptare. Ky dosier demonstron në mënyrë të dukshme pozicionin avangard të Gazetës Sot, në një mjedis mediatik të kapur nga strukturat e Soros, nga Kryetari i Mafies së lejeve të ndërtimit Edi Rama, si dhe të frikësuara nga diplomatët e huaj të implikuar të Tiranës.

Siç ka rezultuar edhe në materialet e publikuara nga Gazeta Sot, vërtetohet me fakte ligjore teknika e fshehjes së financimeve të paligjshme të Grupimit Politik G99, duke përdorur biznese gjoja amerikane të drejtuara nga njerëzit përgjegjës për financat në Lëvizjen Mjaft, persona të cilët garantojnë nëpërmjet marrëveshjeve të garantimit të sekretit të klientëve, fshehtësinë e burimit të financimeve të G99. Të dhënat që ka publikuar Gazeta Sot janë bazuar mbi faksimile ligjore të dokumenteve të regjistruara në Gjykatë dhe në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, mbi deklarime publike mbi politikën e privacisë së klientëve të Biznesit Mozaik sh.p.k. në faqen e tij online www.albmozaik.com, si dhe mbi të dhëna të publikuara nga vetë donatorët e Velisë. Denoncimi i skemave të errëta që fshehin burimin e financimeve të G99 është dokumentuar nga Gazeta Sot, duke iu referuar faqes zyrtare online të G99 dhe çdo e dhënë mbetet e dokumentuar në Gazetën Sot çka e bën të pamundur fshehjen apo fshirjen e provave që vërtetojnë këto skema.

Në ditët e para të denoncimit të Gazetës Sot që përdorte si prova të dhëna zyrtare mbi skemat e korrupsionit dhe konfliktit të interesave të financimeve të G99, Erion Veliaj, vëllai i tij dhe shokët e tyre u përfshinë në një fushatë të dëmtimit dhe fshehjes së provave por kjo përpjekje rezultoi e kotë dhe u denoncua me pamje pasi çdo provë ishte dokumentuar prej kohësh në Gazetë.

Një nga rastet më tipike të fshehjes së provave ishte edhe zhdukja e të dhënave të faqes online të Fondacionit MJAFT, një fondacion që de facto është zhdukur por de jure mbetet akoma person juridik në gjykatë. Fondacioni MJAFT, i cili ka funksionuar si piramidë e ngritur u përfshi në një skemë piramidale të dhënies së parave me përqindje nga Erion Veliaj për vëllain e vet dhe "protestuesit e tjerë vullnetarë" të Lëvizjes MJAFT, duke shkelur një numër të madh ligjesh dhe rregullash të vendosur në Shqipëri që nga koha e ndalimit të fondacioneve piramidale. Ky fondacion që funksionoi në Shqipëri nën hundën e institucioneve mbikëqyrëse bankare si Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, Ministria e Financave, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, dhe struktura të tjera qeveritare dhe hetimore, ka qarkulluar dhe ka zhdukur në mënyrë të errët qindra milionë lekë ndërkohë që mbante një numër llogarie në Kaliforni të Shteteve të Bashkuara, një numër që kontrollohej direkt nga Erion Veliaj nëpërmjet organizatës që themeloi MJAFTin, Ballkan Youth Link. Ky informacion u bë publik nga Gazeta Sot duke paraqitur fakte ligjore mbi paratë e destinuara për kredidhënie të financuara nga Ballkan Children and Youth Foundation, International Youth Foundation, International Youth Busines, Fondacioni i familjes Mbretërore Angleze, etj, fonde të cilat janë zhdukur në një mungesë totale transparence. Gazeta Sot, (megjithëse ueb-siti i Fondacionit MJAFT dhe vetë zyrat janë boshatisur me kohë), ka demonstruar me fakte autentike vetë origjinalin e faqeve online (tashmë offline) që ruhen pranë gazetës Sot, fakte që tregojnë qartazi donatorët, numrat bankarë përfshi edhe ato në Amerikë, përfshi edhe vetë të dhëna që tregonë se kush e drejtonte dhe kush ka qenë politika e fshehjes së burimeve duke kompromentuar rëndë këtë spinoff sorosian të MJAFTit në shkeljen e ligjit të pastrimit të parave. Në ditët e para të denoncimit mbi fondacionin e Sudes, Veliaj & Co, të zënë nën panikun e "zhveshjes lakuriq", fshinë faqen online të ëebsitit www.unëpunoj.com, i cili është një tjetër histori e skemave falsifikuese që implikojnë vetë zyrtarë të institucioneve ndërkombëtare në Tiranë por kjo është një histori tjetër që do të tregohet në ditët në vazhdim. Pas publikimit të pamjeve të faqes origjinale në Gazetën Sot ku tregohej qartë se Fondacioni MJAFT ekzistonte dhe kishte financime të shumta nga donatorët dhe biznese të ndryshme, Erion Veliaj i vënë në siklet para medias dhe ndërkombëtarëve e riktheu atë faqe online.

Po ashtu edhe zbulimi i kontrollit të vulës dhe llogarive bankare të strukturave të MJAFT nga Erion Veliaj & Co diskreditoi rëndë komedinë e mashtrimit të dorëheqjes së Erion Velisë. Me dhjetra fakte publikohen për ditë duke treguar se si Lëvizja G99 është një produkt mashtrimi dhe korrupsioni i lojërave me MJAFT dhe biznese ku shkelen



jo vetëm ligjet e Shqipërisë por edhe ato të vendeve të huaja për destinacionin dhe kontrollin e parave të taksapaguesve të huaj dhe përfshirjen e diplomatëve të huaj në fushatat elektorale të Shqipërisë.

Megjithëse faktet e publikuar nga Gazeta SOT, janë fakte autentike dhe krejtësisht të konfirmueshme, Erion Veliaj dhe liderët e tjerë sorosianë të Tiranës, po ndihmohen nga disa diplomatë të implikuar të Tiranës, në një skemë të re mashtrimi.

Prej javësh Erion Veliaj dhe disa diplomatë në Tiranë po kërkojnë t'u mbushin mendjen diplomatëve të tjerë por mbi të gjitha, zyrtarëve të huaj përgjegjës të hierarkisë së diplomacisë në vendet e tyre për "pavërtetësinë" e fakteve të publikuara të Gazetës Sot.

Sipas të dhënave të siguruara këto ditë pranë disa institucioneve ndërkombëtare në Tiranë rezulton se skema e re e mashtrimit Veliaj & Diplomatë të implikuar, po synon të krijojë një Alibi mbi fatin sorosian të MJAFT&G99. Sipas të dhënave rezulton se denoncimi i Gazetës SOT për mosdorëheqjen e Velisë dhe kontrollin e tij bankar të parave të donatorëve të huaj në banka brenda dhe jashtë vendit, Erioni me ndihmën e disa diplomatëve të Tiranës e kanë "argumentuar juridikisht" si një gabim teknik të Gjykatës së Tiranës pasi drejtuesit e MJAFT e paskan dorëzuar në Gjykatë që në verë dorëheqjen e tij ( që në fakt do të duhej ta kishin bërë që në Shtator 2007) por Gjykata e paska vonuar se paska qenë verë. Ky argument i dalë dhe "i konfirmuar" edhe nga drejtuesit kukulla të Lëvizjes MJAFT, është një mashtrim i trashë juridik pasi nuk ka asnjë mundësi juridike apo teknike që të ndodhë kjo gjë. Këtu pushteti i financuar nga USAID për të kontrolluar gjykatat për konfliktet në gjykatë me partitë politike po keqpërdoret në mënyrën më të shëmtuar të mundshme duke implikuar edhe vetë USAID në këtë skemë mashtrimi. Sipas ligjit shqiptar, çdo dokument që dorëzohet në Gjykatën e Tiranës dhe në mënyrë të veçantë një kërkesë për ndryshim të lidershipit e një personi juridik, dorëzohet në sekretarinë e Gjykatës së Tiranës dhe regjistrohet në databasen e këtij institucioni, pastaj i paraqitet për shqyrtim një gjykatësi të caktuar me short dhe shqyrtohet brenda 3 javësh (maksimumi). Sikur të kishte ndodhur pengesa më e madhe objektive i gjithë dokumentacioni i skandalit Veliaj, do të ishte shqyrtuar maksimumi 2 muaj pas dorëheqjes së tij (Nëntor 2007) apo nëse marrim në konsideratë përrallën e dorëzimit të kërkesës së dorëheqjes në Verë para pushimeve të Gushtit (që i bie të ishte 8 muaj pas krijimit të G99), atëherë i gjithë procesi do të kishte përfunduar në Shtator 2008. Koha kur Gazeta SOT konfirmoi dhe morri kopjen ligjore të dokumentacionit të dokumenteve të MJAFT ishte java e parë e Nëntorit 2008, çka rrëzon çdo mashtrim të Velias dhe diplomatëve të implikuar të tij. Në këtë skemë mashtrimi u përfshi edhe Klotilda Ferhati (Bushka) në rolin e asistentes së anëtares së Gjykatës së Lartë, duke shfrytëzuar këtë ngritje në detyrë për të ndërhyrë me aq sa mundej në këtë mashtrim. Por askush nuk mund t'i mbulojë Diellin me shoshë. Erion Veliaj vazhdon ende të kontrollojë numrat bankarë të strukturave të MJAFT që është regjistruar me emra të ndryshëm në gjykatat shqiptare dhe sipas investigimeve të fundit ka të regjistruar edhe në Shteteve të Bashkuara të Amerikës njërën prej organizatë që përbëjnë Lëvizjen MJAFT: Ballkan Youth Link, në krye të së cilës vazhdon të mbetet. Edhe ëebsiti i kësaj organizate është fshirë për të fshehur gjurmët, por Gazeta Sot disponon në serverin e vet të plota faqet e saj tashmë of-line.

Po ashtu edhe denoncimi i Gazetës Sot për skemat e futurimit të qindra milionë lekëve të donatorëve të huaj nga dy bizneset e posaçme familjare të ngritura nga Veliaj & Co për të justifikuar shpenzimet e miliardere të MJAFT është justifikuar nga Veliaj dhe diplomatët e tij të implikuar si një koincidencë! Në fakt nuk ka asnjë koincidencë dhe Denis Behluli, i cili si person fizik nën emrin qindramilionësh të C&PR Production, është një figurë e njohur e kontraktimeve jo vetëm të MJAFT & Co por edhe të ambasadave dhe donatorëve të tjerë të Tiranës i futur në lojë nga Veliaj dhe për të gazeta SOT disponon dokumente që vërtetojnë raportin e tij me Arbjan Maznikun, Erion Velianë, dhe Fondacionin Soros Tiranë. Po ashtu biznesi i vëllait të Erion Velisë, Arbër Veliaj (i famshëm për fotot e tij mediatike i veshur si femër) i cili nën logon e famshme 3 vjeçare Grafik Propaganda dhe Fshati Urban është regjistruar në gjykatën e Tiranës si person fizik vetëm para disa muajsh si shitës parfumesh.

Dy bizneset familjare, Grafik Propaganda (Fshati Urban) dhe C&PR Production kanë fituruar qindra milionë lekë të Erion Velisë dhe Arbjan Maznikut, duke prodhuar raportime financiare mashtruese për lëvizjen MJAFT në sytë e ndërkombëtarëve, ndërkohë që si Erion Veliaj ashtu edhe Arbjan Mazniku jetojnë në apartamente super të mëdha që asnjë punonjës i OKB nuk mund ta arrijë me 5 vjet punë. I referohemi të ardhurave financiare të punonjësve të OKB duke iu referuar sloganit të famshëm të Velisë në 2003: "Unë hoqa dorë nga karriera e madhe financiare në OKB për të ardhur dhe vuajtur në Shqipëri".

Në lidhje me këto biznese Gazeta Sot ka publikuar të dhëna juridike si në aspektin ligjor ashtu edhe në aspektin publik dhe kontraktues. Janë disa institucione ndërkombëtare që i kanë kontraktuar këto dy biznese dhe tashmë zyrtarët e tyre të implikuar keqazi në çështje të konfliktit të interesave dhe evazionit të pastër po shpikin histori të përditshme justifikimesh.

Por këtu ka një gjë, si zyrtarët e huaj edhe Veliaj, edhe vetë ligji s'mund t'a bëjnë dot: të fshehin të vërtetën e madhe të Skandalit Veliaj, e cila në javët e ardhshme do të marrë përmasat e vërteta ndërkombëtare. Sepse s'ka asnjë diplomat dhe asnjë fuqi sorosiane që të ndalojë të vërtetën e përdorimit të parave të taksapaguesve europianë dhe amerikanë për spinoffet e Sorosit në Shqipëri.

# Bashkia e Ramës me ekolëvizjen private, aktivitet për pastrimin e figurës së betonizimit të Tiranës

Sot Bashkia Tiranë me strukturat e veta të blera të shoqërisë civile organizon një aktivitet parodi në Hotel Rogner për të justifikuar mashtrimin e tij me emrin Plani Rregullues. Siç bëhet e ditur, shoqata pranë Bashkisë "EkoLevizja" e denoncuar nga anëtarë të Aleancës për Hapësirat Publike si kolonë e pestë e Ramës për të sabotuar protestat e shoqerisë civile kundër betonizimit, do të organizojë një tryezë "debati" për Planin Rregullues të Tiranës e cila synon të sigurojë një përkrahje virtuale për Ramën nga Shoqria civile kliente e tij dhe e rrjetit Soros në Tiranë. Siç dihet Ekolëvizja është pjesë e pazareve të Ramës dhe e mbështetjes donatore të lobuar nga Erion Veliaj. Vetëm disa javë më parë, kjo organizatë u favorizua nga Rama & Veliaj në një projekt prej 250 milionë lekësh nga një donator në Tiranë si shpërblim për të gjithë sabotimin e suksesshëm 3 mujor që iu bë nga kjo organizatë dhe bishta të tjerë bashkiako-sorosianë, organizimit të protestave dhe targetimit të Bashkisë së Tiranës nga Aleanca për Hapesirat Publike. Ky është takimi i dytë klientelist që kjo organizatë po bën në favor të Bashkisë së Tiranës duke pozicionuar përfundimisht këtë organizatë dhe disa struktura të tjera donatore ambientaliste siç është REC (drejtuesi i të cilës është themelues dhe drejtues i MJAFT dhe G99), për ti dhënë imazhin e mbështetjes së shoqerisë civile planit betopnizues të Tiranës. Ndërkohe pritet që palët reale të mbrojtjes së Tiranë nga betonizimi të përshkallezojnë aksionin e tyre qytetar kundër Kryetari Betonizues.

Mediat zvicerane parashikuan lëvizjen MJAFT si lëvizje politike me paratë e taksapaguesve

# MJAFT funksionon si kolonë e pestë e Edi Ramës në shoqërinë civile



Prej vitesh Lëvizja Mjaft ka organizuar protesta të ndryshme me anëtarët e stafit apo personat që kreditoheshin nga Fondacioni Piramidal MJAFT. Prej vitesh janë organizuar protesta karakteristikë kryesore e të cilave ka qenë goditja e "korrupsionit" dhe "mosfunksionimit" të institucioneve. Por në të vërtetë organizimi i protestave të Lëvizjes MJAFT ka qenë dirigjuar në mënyrë të vazhdueshme nga Kryetari i Partisë Socialiste Edi Rama. Nëse ndiqet me vëmendje aksioni i Lëvizjes MJAFT nga viti 2004 e deri më sot, rezulton për një koherencë të plotë të "aksionit qytetar" dhe "aksionit politik" të Ramës dhe MJAFTit. Nga të gjitha të dhënat e deritanishme rezulton se që nga protesta e famshme e 8 Janarit 2004 kur u shfaq për herë të parë një MJAFTi agresiv kundër qeverisë Nano, i cili konkludoi me mitingje të mbështetura 100% nga militantë të opozitës së asaj kohë përfshirë Partinë Demokratike dhe LSI, dhe deri më sot sloganet dhe reagimet ishin krye këput koherente me qëllimet fillimisht AntiNano të Ramës dhe deri Anti-LSI sot. Në vitin 2004, Lëvizja MJAFT ndërmori disa aksione dhe prodhoi disa imazhe duke ironizuar me termin "klasa e vjetër politike" në të cilën përfshinte të gjitha figurat kryesore politike duke përjashtuar Edi Ramën si figura e politikës së re. Aktivitet pas aktiviteti, protestez pas protesteze, MJAFTi dhe spinoff-et e tjera të Soros në Tiranë godisnin në një alternim dhe koordinim të plotë të gjithë konkurrentët e Edi Ramës, ndërkohë që ky i fundit konceptonte dhe prodhonte falas edhe vetë banesat e protestës së Erion Velisë me shokë. Autentik si prodhim i drejtpërdrejtë i Ramës mbetet baneri i madh "mirë se na erdhe Nanon Djali - nga kongresmenët" i vendosur në rrugën e Kavajës kur Nano kthehej nga një spital në Turqi.

Ndërkohë megjithese Tirana mbetej një qytet me probleme të mëdha urbane dhe sociale, nuk u shënua kurrë ndonjë protestë e MJAFT ndaj Bashkisë dhe një aksion gjoja kunder Bashkisë në Laprakë për ujin ishte thjesht shprehje e presionit të Ramës ndaj strukturave që menaxhonin infrastrukturën e ujit në Laprakë, të cilat kishin kontradikta financiare dhe menaxheriale me Kryebashkiakun e Tiranës.

Në fakt Lëvizja MJAFT ka qenë gjithmonë "krahu i armatosur mediatik" i Edi Ramës dhe kjo është shprehur në të gjitha prononcimet ndërkombëtare dhe lokale të Erion Velisë, Maznikut dhe Fugës në intervista dhe prononcime mediatike. Nga viti 2004-2007, para se të dilte hapur forumi lëvizja G99 i Velisë, MJAFT në bashkëpunim me strukturat e Soros në Tiranë kanë punuar qartësisht në shërbim të Ramës dhe politikës së tij paradoksale përtej të majtës dhe të djathtës. Të gjitha protestëzat dhe reagimet e MJAFT synonin të glorifikonin Bashkinë e Tiranës, të retushonin pasojat sociale dhe urbane të Ramës duke ia veshur rregullisht përgjegjësinë Ekzekutivit, si dhe të orientonin në media simpatinë dhe antipatinë publike në favor të Ramës dhe në dëm të kundërshtarëve të tij.

Keshtu mbi 5.4 milionë euro të dhëna nga donatorët e huaj për shoqërinë civile shqiptare kanë shërbyer si serum për t'i dhënë pushtet politik njeriut kryesor të Soros në Tiranë, Edi Ramës.

Ndërhyrja e MJAFT në fushaten Zgjedhore 2005 me mbështetjen e veçantë të Holandezëve, Soros, dhe OSBE Holandeze, Ambasadës Gjermane (mbi 400 milionë lekë) nëpërmjet sondazheve të trukuara, edukimit të votuesve për herë të parë, synonte lançimin e figurës së Politikës së Re dhe goditjes së "të vjetërve" çka ishte një ndërhyrje e paligjshme në procesin zgjedhor nga një organizatë e shoqërisë civile me paratë e dontarorëve të huaj që i kaluan MJAFT të Velisë nëpërmjet Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të Celibashit.

Ndërsa ardhja në pushtet e mazhorancës demokrate u shënua me aksionin e ri të drejtuar drejtpërdrejt nga Rama të quajtur Aksioni Civil që ishte një përpjekje për të retushuar emrin e diskredituar në MJAFT në një format të ri të shoqërisë civile.

Ndërkohë në zgjedhjet e 2007, stafi i Mjaft, i përforcuar nga një strukturë e re me emrin ECA, e ngritur për këtë qëllim e drejtuar nga Ilirian Celibashi dhe e mbështetur që në fillimet e veta fuqishëm nga Fondacioni Soros (që po e shpërblente për kalimin pa tender të qindra milionë lekëve për Erion Velinë dy vjet më parë), u organizua drejtpërdrejt nga Rama për të "denoncuar manipulimin" në rast se do të humbte në Tiranë. Fati dhe pazari, e desh që Rama të fitonte në Tiranë dhe kështu paratë e shpenzuar për përdorimin e pajisjeve të komunikimit të drejtpërdrejtë të mos i hynin në punë Veliajt, i cili pas marrjes së informacionit të parë nga KZZ, ku Rama kishte fituar e braktisën punën dhe e lanë për një moment tjetër shpalljen e rezultateve të plota për të cilat kishin marrë edhe paratë.

Ndërkohë që MJAFT ka luajtur edhe një rol shumë të veçantë si Kolonë e Pestë e Ramës në Shoqërisë Civile duke manipuluar dhe orientuar protestat që targetonin Ramën apo që nuk targetonin siç duhet objektivat e Ramës. Kjo ka ndodhur gjithmonë por në rastet që ka rënë më shumë në sy të kohëve të fundit kanë qenë sorollatja nëpër sheshe e pesionistëve dhe invalidëve, të cilët i largonin me mjeshtëri nga dyert e Bashkisë për ti orientuar drejt dyerve të Ministrive, siç ishte rasti skandaloz i rritjes së çmimit të biletave të transportit urban me kerkese së Bashkise se Tiranes dhe refuzimi i statusit të invalidit dhe veteranit në urbanet e Tiranës, të cilat kontrollohen nga pazaret e fëlliqura të Ramës. Një rast tjetër ishte edhe orientimi (që rezultoi i dështuar) i protestave të minatorëve që duhej të protestonin në të njëjtën ore dhe vend me protestat e grevës së urisë së deputetëve për të larguar vëmendjen e Medias dhe opinionit publik nga aksioni i konkurrentëve të Ramës.

Që në vitin 2007 Veliaj e kuptoi se Lëvizja MJAFT nuk mund të shndërrohej haptas në në krah politik, sepse do t'i duhej të prishte kontratat miliardere me donatorët e huaj për Lëvizjen MJAFT. Siç citohej në gazetën zvicerane "Neue Zürcher Zeitung" në 2004, në lidhje me mbështetjen e MJAFT nga paratë e taksapaguesve zvicerane, thuhet: "Mos është kjo valle ndërhyrje në punët e brendshme te Shqipërisë? Pius Rohner, drejtor i zyrës së koordinimit të drejtorisë për zhvillim dhe bashkëpunim, e shikon këtë projekt si eksperiment. Për sa kohë "Mjaft lufton për transparencë dhe kundra korrupsionit me mjete ligjore nuk shikon ndonje problem. Por organizata dhe projekti do te ndiqen me vëmendje. "N.q.s. "Mjaft"- i do te shndërrohej në një parti do ta kalonte vijën e kuqe". Për këtë nuk bëhet fjalë, thotë Veliaj. "Detyra jone është të ndërtojmë ura midis qytetarëve dhe sistemit politik".

Kjo bëri që në vitin 2007 të organizohej komedia mediatike e gjoja tërheqjes së Velisë nga MJAFT, dhe Veliaj & Rama filluan të gatuanin lojën e re me MJAFT Elektoral G99 (që është vetëm një zgjatim i vetë MJAFT të Velisë) për të goditur kundërshtarët e tij te rinj politikë të krahut të vet dhe brenda Partisë. Angazhimi i drejtpërdrejtë i Velisë në luftë me krahun Nano në media e kishte pozicionuar atë si një krah të djathtë të Ramës dhe më pas e pozicionoi atë së bashku me Remzi Lanin e Soros si një "diplomat" që bënte fushata në Europë dhe Amerikë për të mbrojtur Kodin Zgjedhor dhe të godiste "Partinë Private" të Ilir Metës sipas preferencave dhe nevojave të Ramës.

Po ashtu i gjithë materiali i rekomandimeve të Soros u pergatit edhe me mbështetjen e strukturave të MJAFT si një katalizator diplomatik i një reforme përjashtuese për konkurrentët e Ramës.

Vetë protesta e fundit e 10 rrogëtarëve të mbetur të Qendrës MJAFT në Tiranë kundër Berluskonit nuk është gjë tjetër veçse pjesë e skenarit të Ramës për të shprehur pakënaqësinë e tij ndaj injorimit tipik Berluskonian për sharlatanët dhe komedianët e dështuar politikë të tipit Rama.

# Ambasadorët gjermanë të implikuar në financime të dyshimta për interesat e Soros dhe grupimit Veliaj&Co

Prej ditësh Ambasadori Gjerman po përpiqet të fshehë gjurmët e implikimit dhe keqpërdorimit të pushtetit diplomatik dhe financiar, që ai dhe paraardhesi i tij ka dhënë për strukturavë të ngritura nga Fondacioni Soros në Shqipëri, për qëllimet private të miliarderit-peshkaqen të bursës globale me të njëjtin emër. Dihet tashmë se qeveria gjermane përfaqëson një ndër shtetet më të rëndësishme mbështetëse për Shqipërinë si politikisht dhe ekonomikisht dhe ndihma gjermane për Shqipërinë ka qenë e vazhdueshme.

Sipas uebsitit të Ambasadës Gjermane në Shqipëri: "Që prej vitit 1988 Gjermania i ka vënë në dispozicion Shqipërisë në kuadër të bashkëpunimit dypalësh për zhvillim më shumë se 367 mln euro. Kësaj i duhet shtuar edhe pjesa e Gjermanisë në nivel donatorësh shumëpalësh së bashku më BE, Bankën Botërore ose Kombet e Bashkuara. Llogaritur për person, Shqipëria radhitet ndër të parët në grupin e vendeve që përfitojnë asistencë gjermane për zhvillim".

Problemi nuk qëndron tek roli dhe ndihma e Gjermanisë për shqiptarët, por tek keqpërdorimi i rolit dhe mbështetjes gjermane për Shqipërinë dhe shqiptarët nga zyrtarë që, me dëshirë apo të detyruar (për arsye të paqarta), janë implikuar në disa lojëra politike të cilat në fakt kanë mbështetur interesat ekonomike dhe politike të një prej personazheve më famëkeq në botë, George Soros.

Siç ka prezantuar dhe denoncuar prej javësh gazeta Sot, Ambasadori Gjerman aktual në Tiranë, por edhe ai përpara tij, janë implikuar drejtpërdrejt në mbështetjen e spinoff-eve të Soros në Shqipëri si Lëvizja elektorale G99, Lëvizja MJAFT, Instituti Agenda, Fondacioni piramidal MJAFT, Ballkan Youth Link, Shoqata Kombëtare e Debatit, Instituti i Lidershipit Rinor, të gjitha këto struktura që drejtohen nga Erion Veliaj, Arbjan Mazniku dhe Milva Ekonomi (e cila njihet edhe si financierja e pasurive dhe interesave të Soros në Shqipëri dhe Kosovë). Këto organizata me emra të ndryshëm që janë krijuar nga Themeluesi (Soros) për të diversifikuar thithjen e fondeve me qëllim për prodhimin e spinoffit politik G99, kanë krijuar edhe bizneset e pronarëve të tyre si C&PR Production, Grafik Propaganda, të cilat realizojnë edhe "unifikimin" e faturimit të parave të donatorëve të huaj përfshi edhe ata gjermanë në Shqipëri. Siç rezulton nga të dhënat e gazetës Sot, me qindra mijë euro të taksapaguesve gjermanë i janë dhënë me shumicë spinoff-eve të Soros (subjekte të themeluara dhe financuara nga "Themeluesi" Soros të cilat prezantohen në një moment të dytë si subjekte të pavarura për të thithur paratë e të tjerëve) dhe tashmë, përfaqësuesi më i lartë politik i shtetit mik gjerman ka marrë rolin e prezentatorit në spektaklin e promocionit të sorosistëve politik të G99: Erion Veliaj & Co.

Prej ditësh lexuesit e Gazetës Sot bëjnë humor me shockumentary-n "Rilindja Shqiptare" një film grotesk që paraqet si heronj dhe rilindas skuadrën sorosiane të Tiranës: Edi Ramën, Erion Velinë dhe ish-spiunin e Sigurimit të Shtetit, Remzi Lani. Ky film qesharak dhe gënjeshtar që vetglorifikon disa figura të urryera për shumë shqiptarë dhe që janë antipod i rilindasve të vërtetë të Shqipërisë, përbën një rast të pastër të shkeljes së etikës së financimeve dhe profesionalizmit dhe përbën një devijim të pastër të qëllimit për të cilat janë dhënë këto fonde. Duke qenë se këto para të taksapaguesve gjermanë dhe austriakë në vend që të përdoresh për promovimin e imazhit të Shqipërisë në Europë (siç ka qenë edhe qëllimi i tyre fillestar për të cilat janë dhënë, ashtu siç u përdorën në Mal të Zi, Maqedoni, Turqi, etj), u keqpërdorën haptas për përgatitjen e një megaspoti elektoral dhe mashtrues për fushatën elektorale 2009 dhe për rehabilitimin e ish-spiunit të Sigurimit të Shtetit sorosistit të vjetër Remzi Lani (i cili futi në burg në 1979 mësuesin e tij sepse lexonte Biblën). Në vend që Ambasadori Gjerman në rastin më të keq, (sepse në rastin më të mirë do duhej të kishte informuar institucionet donatore për këtë shkelje) t'i qëndronte larg kësaj historie elektorale me ish spiunë, u vu në krye të një fushate promocioni politik të politikanit Veliaj dhe rehabilimit të ish-spiunit Remzi Lani.

Gazeta Sot ka publikuar me foto dhe faksimile përfshirjen e drejtpërdrejtë të Ambasadorit Gjerman në disa aktivitete promocionale për Velinë, Lanin, Ramën dhe megaspotin paçavure "Rilindja Shqiptare".

Se sa para janë shpenzuar për këtë promocion në Shqipëri nuk dihet por tashmë është fakt që ky film është transmetuar në televizionet gjermane ndër më prestigjioze dhe në orët më të shikuara:

ORF (20 Gusht 2008, 23:00)
3Sat (18 Maj 2008, 21:00)

Por implikimi i Ambasadorëve Gjermanë në promovimin e Veliajt & Co si njerëzit e Soros në Shqipëri ka filluar herët, duke filluar që në ditët e para të Lëvizjes MJAFT. Siç rezulton nga faksimilet e publikuara nga gazeta Sot dhe të dhënat zyrtare të transparencës së ndihmave ndërkombëtare për Shqipërinë, ambasada gjermane ka mbështetur fuqimisht Velinë që në ditët e para të Marsit 2003, ku vetë Ambasadori gjerman doli në TV shqiptare (Top Channel) në emisionin "Ora 0", duke mbajtur stemën e dorës së kuqe MJAFT duke promovuar liderin e ri Veliaj i cili "kundërshtonte" ndërhyrjen amerikane në Irak, sepse kështu kishte filluar të bënte edhe George Soros në SHBA. Paratë e taksapaguesve gjermanë nuk pushuan për Velinë e Sorosit të Tiranës duke i hapur kështu punë bizneseve të Velisë & Co, që duhej të faturonin me shumë kujdes paratë e MJAFT, sepse edhe kontrolli i faturave në ambasadën gjermane dihet se si është. Muaj pas muaji, ambasada gjermane financonte njëherë Shoqatën Kombëtare të Debatit, një herë Ballkan Youth Link, Institutin e Lidershipit Rinor, Fondacionin Piramidal MJAFT, Qendrën




MJAFT, Institutin Agenda dhe kështu herë alternoheshin e herë paraqiteshin të gjitha bashkë, dhe ambasada gjermane e njohur për kujdesin e saj në dhënien e parave, u bë shumë tolerante për organizatat sorosiane që i drejtonin drejtuesit e G99: Veliaj, Mazniku dhe Ekonomi. Muaj pas muaji dhe vit pas viti, paratë e taksapaguesve gjermane të destinuara për shoqërinë civile shqiptare përfundonin në faturimet e bizneseve private të VeliaJ & Co, duke krijuar kapitalet e para fillestare të lançimit politik familjar të drejtuesve të MJAFT. Kulmi arriti në Janar 2004 kur Veliaj kërkoi dorëheqjen e Fatos Nanos dhe vuri anash edhe logon e Ambasadës Gjermane duke rrezikuar edhe një incident diplomatik. Dhe sa herë denonçohej Veliaj si instrument politik i Soros apo i shërbëtorit të tij politik në Tiranë, Edi Rama, Ambasadorët Gjermanë bashkë me ata holandezë merrnin rolin avokatit mbrojtës duke mbrojtur karagjozllëqet e Veliaj, si veprimet e një djaloshi idealist që do të ndryshonte Shqipërinë.

Paratë gjermane kështu janë përdorur për fushatën MJAFT 2003, karvanët e Velisë, fushatat Jeto Gjelber, fushatat "edukative" dhe monitorimet e njëanshme të zgjedhjeve, sondazhet e shumëpërfolura, projektet e "kërkimeve", udhëtimet turistike jashtë Shqipërisë, uebsite "punësimi", dhe shumë e shumë e shumë aktivitete që kurrë nuk u bënë transparente për publikun. Dhe të gjitha këto para janë hedhur për mbështetjen e zyravetë Soros në Tiranë.

GAZETA SOT 20/11/2008

"Rilindja Shqiptare", produkt i aferave skandaloze

## Standardet që na propozon ambasadori gjerman janë: Spiuni Lani, lejfeni Veliaj, dhe i korruptuari Rama

Prej ditësh Gazeta Sot denoncon Filmin "Rilindja Shqiptare" i prodhuar me paratë e taksapaguesve gjermanë dhe austriakë, si një suport i hapur dhe i paligjshëm për partitë politike në Shqipëri, nën mbështetjen personale të ambasadorit gjerman. Ky film i cili manipulon të vërtetën historike të shqiptarëve në tranzicion, manipulon të vërtetën historike të 18 viteve të fundit duke paraqitur Lëvizjen MJAFT dhe politikanët Edi Rama, Erion Veliaj dhe ish-spiunin e Sigurimit të Shtetit Remzi Lani, si njerëzit që shpëtuan Shqipërinë nga Kriza e '97. Subjekti i filmit përpiqet të paraqesë këta tre heronj si rilindësit që po shpëtojnë Shqipërinë. Remzi Lani në dokumentar paraqitet si njeriu më premtues i komunitetit të medias në Ballkan dhe përfaqësues i fjalës së Lirë. Edi Rama paraqitet si lideri që gjelbëroi qytetin duke fshehur faktin e madh publik që gjatë viteve të fundit shumica e lulishteve dhe hapësirave të gjelbra në Tiranë u betonizua dhe u ngushtua deri në ekstrem. Përpos që ky njeri po akuzohet nga qytetarët si grabitës i pronave publike të tyre. Glorifikimi i ngjyerjeve të fasadave me ngjyrat e ylberit (si simbolikë e koloritit gay) në vend që të shihet masakra urbane e Mister Betonit, është pjesë e skenarit që u përgatit me aq kujdes nën asistencën e ish-spiunit të Sigurimit të Shtetit Zoti Remzi Lani. Por elementi më tipik i falsifikimit të së vërtetave historike ka të bëjë me mënyrën "artistike" të prezantimit të Rilindjes Shqiptare Rama&Veliaj&Lani! Filmi paraqet një Shqipëri kaotike të 1997 dhe paraqet si 3 njerëzit shpëtimtarë, heronjtë Rama, Veliaj dhe Lani! Duke injoruar rolin krejtësisht minor të këtyre hiçave në kapërcimin e situatës së krizës '97. Këta personazhe, që s'kanë asnjë lidhje me ringritjen e Shqipërisë pas '97, paraqiten si heronj. Në fakt, ky film të kujton kinodokumentarët e Kinostudios "Shqipëria e Re" që glorifikonin dhe shpiknin histori për kooperativistët, karrocierët dhe sharrëxhinjtë e Byrosë Politike, të cilët në vitet '80, u trajtuan në Fjalorin Enciklopedik Shqiptar njësoj me Rilindasit Sami Frashëri, Vaso Pasha dhe Naum Veqilharxhin. Por e vetmja lidhje që mund të ketë rilindasi postmodern Erion Veliaj me rilindasin e vërtetë Sami Frashërin, është vetëm emri i shkollës së mesme të Velisë.

GAZETA SOT 16/11/2008

## Zhduken një milion euro të Qeverisë Gjermane për OJF e Shqipërisë

Projekti "Forcimi i Shoqërisë Civile dhe Përmirësimi i Strukturave Demokratike", projekt i financuar nga Qeveria Gjermane me paratë e taksapaguesve gjermanë, synoi prej 2 vjetësh të forconte shoqërinë civile dhe të rriste rolin demokratik të saj. Megjithëse kanë kaluar dy vjet dhe projekti përfundon vitin që vjen, asnjë organizatë nuk ka idenë e ekzistencës së këtij projekti. Ky projekt drejtohet nga organizata gjermanë GOPA e cila është implementuese e GTZ dhe zyrat i ka pranë Ambasadës Gjermane në Tiranë. Një milion euro janë investuar nga paratë e taksapaguesve gjermanë dhe OJF e kontaktuara sot me telefon nga gazeta Sot, nuk kanë asnjë dijeni për ekzistencën e tij dhe për më tepër janë habitur kur kanë marrë vesh se ky projekt ka vënë në dispozicion të shoqërisë civile rreth 1 milionë euro. Një nga objektivat e këtij projekti ka qenë edhe mbështetja e qeverisë shqiptare për ti vënë në dispozicion të shoqërisë civile rreth 1.2 milionë euro për OJF, shifër e premtuar kjo edhe nga Qeveria Shqiptare.

# Evazioni fiskal i Velise & Co me taksat e projekteve të paguara nga donatorët

Deri më sot kemi trajtuar në dosjerin special që ka publikuar gazeta Sot paudhësitë eVeliajT & Co i orientuar dhe i modifikuar nga drejtuesit kryesorë të Soros në Shqipëri dhe në mënyrë të veçantë nga Edi Rama, një ndër njerëzit më të afërt të George Soros në Shqipëri.

Një ndër pikat më të dobëta juridike të këtij instrumenti të rrjetit underground Soros në Shqipëri është edhe evazioni fiskal i bizneseve familjare që kanë krijuar Veliaj & Co. Por një ndër çështjet e paprekura deri më tani është evazioni fiskal i vetë organizatave të Erion Velisë.

Siç rezulton nga të dhënat e Gazetës Sot që publikohen çdo ditë, sasia e parave të thithura deri më tani nga organizatat e MJAFT kapërcen shifrën e 5.4 milionë eurove dhe këtu nuk përfshihen shumë para që Veliaj ka thithur nga biznesi shqiptar (kompani celulare, qendra të mëdha biznesi, banka, prodhues pijesh), si dhe komuniteti shqiptar nga diaspora, etj. Vetëm MJAFT Fest e anatemuar vazhdimisht nga dëshmitarë okularë si festë marihuane dhe alkooli, ka pasur deri më tani 28 sponsorizime private. Por këto të dhëna nuk janë përfshirë në shifrën prej 5.4 milionë eurosh të MJAFT-eve të Velisë.

Sasia e donatorëve të dokumentuar të Velisë deri më tani arrin në 43 donatorë duke thyer çdo rekord të njohur financimesh në shoqërinë civile [illegible] vjetësh.

Ndërsa shifra e dokumentuar përfshin vetëm një pjesë të këtyre donatorëve pasi fshehja e parave që financuan MJAFT ka përbërë gjithmonë një sekret absolut dhe nuk ka qenë kurrë e mundshme që Veliaj & Co të tregojë. Është gazeta Sot dhe ekspertët e saj ata që kanë arritur të sigurojnë të dhëna të shumta nga shumë burime që do të publikohen vazhdimisht nga gazeta Sot për të treguar një pjesë të së vërtetës së financimeve të Velisë. Një tjetër nga pikat më të errëta do të mbetet gjithmonë sasia e vërtetë e parave që Veliaj ka siguruar nga Rrjeti Ndërkombëtar i Fondacioneve Soros i cili menaxhohet në nivel ndërkombëtar nga Princesha e Holandës Von Mise në Zyrën e Soros në Londër dhe nga Instituti i Shoqërisë së Hapur që ndodhet në të njëjtën godinë në Manhatan në New York ku ndodhet edhe Soros Management Fund (biznesi i George Soros) që organizon dhe koordinon të gjitha spekulimet financiare në botë. Zyra e Institutit të Shoqërisë së Hapur në New York në të njëjtën ndërtesë me biznesin miliarder të Soros i ka dhënë famën e Avokatit të Djallit që ka menaxhuar fatin e qeverive në vende në zhvillim apo të pazhvilluara në shumë vende të globit por që sot siç dihet i ka rënë influenca kudo përveç rastit të Shqipërisë ku pushteti i tij është absolut.

Ndërkohë që Erion Veliaj si një ushtar besnik i komandantëve lokalë të George Soros (në rastin shqiptar është Edi Rama), ka siguruar mbështetje financiare nga 43 donatorë ndërkombëtarë, para që kanë shkuar të gjitha për të fuqizuar një nga spinoffet që ka krijuar Soros në Shqipëri për të kontrolluar edhe politikisht Shqipërinë.

Nga të dhënat e mbledhura mbi Lëvizjen MJAFT dhe strukturat e saj (përfshi edhe Fondacionin Piramidal MJAFT që jep para me përqindje) rezulton se numri i punonjësve të MJAFT ka arritur në ditë normale pune rreth 40 persona dhe në ditë "piku" rreth 60 persona. Vetëm projektet aktuale të monitorimeve (gjobëvënies së sofistikuar sorosiane), kanë të punësuar 12 persona njëkohësisht (pavarësisht se ka raste që një person merr njëkohësisht dy rroga apo tre në të njëjtin program). Vetëm një projekt, ai Laboremus i financuar me 48.400 $ nga Banka Botërore dhe donatorë të tjerë (siç thuhet në faqen zyrtare të Bankës Botërore) përfshin një total prej 7 personash dhe ku rrogat variojnë nga 500 dollar deri në 350 dollarë duke përfshirë një total vjetor prej 34.200 $. Duke bërë një llogari të thjeshtë rezulton se vetëm tatimi mbi të ardhurat, sigurimet shoqërore që duhet t'i paguhen shtetit shqiptar përfshijnë 15.720 $. A i janë paguar ndonjëherë shtetit shqiptar këto para? As që bëhet fjalë. Dhe të mendosh që këto para janë derdhur vetëm për një projekt në 2006 ndërkohë që nga të dhënat tona rezulton se MJAFT në 2006 ka thithur pranë donatorëve rreth 800 mijë euro.

Dhe ndërkohë rezulton se Banka Botërore u zhgënjye shumë kur ky projekt nuk po realizohej sipas parashikimit dhe për pasojë Fondacionit MJAFT i erdhi paralajmërimi për kthim mbrapsht të fondeve. Në këtë kohë ndërhyri gruaja e Drejtorit të Soros në Tiranë, e cila është njëkohësisht edhe përgjegjëse për marrëdhëniet publike në Bankën Botërore për të mbuluar gjurmët e qarkullimit shumë mujor të parave në banka (të cilat prodhonin përqindje për familjet e mëdha të MJAFT të Velisë & Maznikut). Ky projekt u realizua brenda natës nga i vëllai i Erion Velisë i cili punonte edhe si biznes faturues edhe si staf i projektit ndërkohë që nuk rezulton që ai të ketë paguar pranë Drejtorisë së Tatim Taksave asnjë detyrim financiar për të ardhurat e marra. Nga të dhënat e gazetës Sot rezulton se vëllai i Erion Velisë ka punuar si webmaster dhe dezajner në të paktën 17 projekte të Erion Velisë duke u punësuar 17 herë brenda 5 vjetësh ku secila rrogë ka zgjatur nga 5 muaj deri në 3 vjet. Duke pasur parasysh se rrogat më të ulta në Lëvizjen Mjaft kanë qenë 350 $ rezulton se sasia e parave me të cilat është paguar Arbër Veliaj të ketë lëvizur nga 1000 dollarë në muaj deri në 2500, çka e përcakton atë de jure edhe si një kontribues të madh në Sigurimet Shoqërore dhe pagues i tatimit mbi të ardhurat i të paktën 1200 deri në 3000 $ në vit vetëm për rrogën që ka marrë në shoqatat e të vëllait. Por kjo nuk rezulton në të dhënat e siguruara në Drejtorinë e Tatim Taksave. Dhe këtu nuk po flasim për bizneset e paregjistruara të Arbër Velisë ku ai ka qarkulluar qindra miliona lekë të shoqatave të vëllait dhe qindra miliona lekë të tjera të 54 klientëve të tjerë të tij të prezantuar në faqen online www.fshatiurban.com.

| REVENUES | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Sale of Goods and Services | $ | - | $ | - |
| Advertising | $ | 5000 | $ | 15,000 |
| Contribution from Companies (Chamber of Commerce Fundraising) | $ | 1,000 | $ | 10, 000 |
| Continuous Fundraising from other sources such as the Germany Embassy that will donate again if the project is successful | $ | - | $ | 20, 000 |
| Totals | $ | 6, 000 | $ | 25, 000 |
| **EXPENSES** | | | | |
| Personnel | $ | 34, 200 | $ | 35, 000 |
| [illegible] | [illegible] | [illegible] | [illegible] | [illegible] |
| Training | $ | 4, 200 | $ | 5, 200 |
| Travel | $ | 2, 000 | $ | 2, 000 |
| Other | $ | 2, 000 | $ | 0 |
| Evaluation/Dissemination | $ | 1, 500 | $ | 1, 500 |
| General/Overhead | $ | 0 | $ | 0 |
| Totals | $ | - | $ | - |
| NET GAIN (LOSS) | $ | 42, 400 | $ | 700 |

Faksimile e një projekti të financuar nga BB

PROJECT COST

| Activity | A<br>Unit cost $ | B<br>Number of units | A*B<br>Total cost $ (A*B) | Total $ |
|---|---|---|---|---|
| Personnel<br>• Director of Project<br>• Employment Scouts (5 people)<br>• Webmaster/ web maintenance | $ 500<br>$ 400<br>$ 350 | 12<br>12<br>12 | 6000<br>24,000<br>4200 | 34, 200 |
| [illegible]<br>• Computers (2)<br>• Communications<br>• Website design | $1000<br>$1000<br>$1500 | 2<br>1<br>1 | $ 2000<br>$ 1000<br>$ 1500 | 4, 500 |
| Training (if any)<br>• Job Fairs<br>• Career Service Training | $ 1500<br>$ 300 | 2<br>4 | $ 3000<br>$ 1200 | 4, 200 |
| Travel (if any)<br>• Travel expenses (scouting for jobs) | $ 2000 | 1 | $ 2000 | |

Këtu tregohen 7 rrogat e projektit

Në fakt nëse do t'i referohemi standardeve të larta të rrogave dhe të numrit të rrogëtarëve të projekteve të MJAFT, ku Veliaj, Mazniku, Lika, Fuga kanë qenë ndër më të paguarit njëkohësisht në shumicën e projekteve të MJAFT, rezulton se të paktën vetëm këta të katërt duhej të paguanin rregullisht çdo vit në Drejtorinë e Tatim Taksave dhe në Sigurimet Shoqërore në Tiranë rreth 14 milionë lekë në vit prej 5 vjetësh por edhe kjo nuk rezulton.

Ndërkohë që të gjitha rrogat e shoqatave të Velisë & Co do të duhej të kishin paguar pranë Drejtorisë së Tatim Taksave dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore për 5 vjet Lëvizje MJAFT mbi 200 milionë lekë vetëm për pagesat e punonjësve të kontraktuar të projekteve të donatorëve të huaj. Natyrisht që as kjo nuk rezulton.

Pra vetëm me një llogari të thjeshtë kuptojmë se me paratë e 43 donatorëve të Velisë është kryer evazion i pastër fiskal vetëm me zërin rroga në shifra rekord duke demonstruar edhe një herë se çfarë abuzimi me ligjet e shtetit kanë financuar donatorët e luftës antikorrupsion dhe të promovimit të politikës së re.

Vetëm një javë më parë, në një emision televiziv, gënjeshtari Veliaj i cili tregoi një histori për rroga shumë të larta që paguan në Gjermani dhe në vende të tjera si eksperti më i kualifikuar i Ballkanit në shkencat politike, nuk paguante asnjë të ardhur në Drejtorinë e Tatim Taksave dhe Institutit e Sigurimeve Shoqërore sepse ai paguaka jashtë shtetit "sigurimin e jetës" dhe kjo sipas tij e përjashton nga detyrimet që ka ndaj shtetit shqiptar.

Veliaj që në fillimet e politikës së re përtej të majtës dhe të djathtës përfaqëson një lider të evazionit fiskal dhe shmangies nga detyrimet financiare që ka kushdo ndaj shtetit shqiptar. Por problemi nuk qëndron vetëm tek Veliaj, jo vetëm tek donatorët "e verbër", por edhe tek shteti "i verbër" shqiptar që ka lejuar të livadhisë një ndër VIP-at e evazionit fiskal të OJFve.

### Websiti dhe imazhi i PS produkt i vëllezërve Veliaj

# Erion Veliaj, biznese me Partinë Socialiste, Bashkinë e Edi Ramës dhe bashkinë e Durrësit




Faqja prezantuese e biznesit të vëllezërve Veliaj se tregojnë se çfarë punësh bëjnë për Edi Ramën.
Kjo faqe tashme është e fshirë

Në një ndër faqet on-line që ka fshirë këto ditë Erion Veliaj për të fshehur gjurmët e evazionit fiskal familjar thuhet qartas se biznesi i ngritur me mikrokreditë e paligjshme të Fondacionit Piramidal MJAFT që i ka dhënë Erion Veliaj, vëllait të vet, Arbër Velias, "Grafik Propaganda realizon imazhin e ri të partisë socialiste. Të gjitha produktet u prezantuan për herë të parë në kongresin e radhës të vitit 2006. Ky material është zhdukur këto ditë nga interneti por gazeta Sot disponon materialin e plotë në një CD.

Siç del nga të dhënat e faqes së fshirë këto ditë për të fshehur të dhënat e klientëve të www.grafik.fshatiurban.com, jo vetëm imazhi i ri ylberit i Partisë Socialiste por edhe vetë websiti www.ps.al i Partisë Socialiste është ndërtuar nga vëllezërit Veliaj: "Partia Socialiste e Shqipërisë. Grafik Propaganda realizon dizajnin e faqes në internet për partinë më të madhe opozitare në Shqipëri, duke u përpjekur për të treguar sa më mirë karakterin progresist të një partie eurosocialiste". Është një fakt i njohur tashmë që imazhi i ri i Partisë Socialiste përtej të Majtës dhe të Djathtës i promovuar në Kongresin e Partisë Socialiste ka braktisur ngjyrat tradicionale të së Majtës dhe ka marrë 7 ngjyrat "postmoderne" të ngjyerjes së pallateve të Tiranës nga Kryetari i Betonit. Elementet e reja të imazhit të Socialistëve bazohen tek 7 ngjyrat e ylberit që siç dihet përfaqësojnë flamurin Gay. Dhe personazhi që zgjodhi Rama të prodhonte imazhin e ri ylberist të Partisë Socialiste është djali që vetëm 3 muaj para se ti besohej kjo detyrë, doli në faqet e para të gazetave i veshur si femër gjoja në një ballo (fotot e Arbër Velisë i veshur si femër ishin marrë nga një festë private në një ambient intim).

Siç shihet në këto të dhëna rezulton se biznesi i paligjshëm i krijuar në 2005 me paratë e taksapaguesve të huaj të dhëna si mikrokredi nga Fondacioni Piramidal MJAFT, është financuar nga Partia Socialialiste dhe Edi Rama ndërkohë që disa të dhëna të tjera të publikuara në faqen online të www.fshatiurban.com rezulton se Grafik Propaganda ka punuar edhe për Bashkinë e Tiranës. Nuk është e qartë se si Partia Socialiste e cila premton të luftojë korrupsionin dhe evazionin e ka paguar Velinë për shërbimet e tij online që në 2006, por po ashtu nuk është e qartë se si Bashkia Tiranë ka kërkuar faturë për paratë që ajo i ka dhënë vëllezërve Veliaj. Është e qartë se faqja e internetit www.ps.al është faqje zyrtare e Partisë Socialiste por ajo që të bie ndër sy sapo e hap këtë faqe është se webmasteri i saj nuk bëhet i ditur dhe për më tepër në një faqe shumë të rëndësishme në vend të webmasterit shkruhet "prova teknike"!!! Fshirja e emrit të vëllait të Velisë nga Edi Rama është bërë me urgjencë këto ditë kur plasi skandali i bizneseve të familjes Veliaj, por fshirja rezulton e paefektshme pasi Gazeta Sot ka pohimet zyrtare të vetë Velisë. Një nga gjërat që duhet të sqarojë Edi Rama është se, sa para kanë paguar Velitë? Me cilat fatura të "Grafik Propaganda" që nuk ka ekzistuar e regjistruar në atë kohë në gjykatë dhe as në QKR sot, janë depozituar të dhënat e familjes Veliaj? Të ardhurat e nxjerra nga Partia Socialiste si janë deklaruar në zyrat e tatim taksave dhe a janë reflektuar këto në depozitimin e kontributeve për sigurime shoqërore pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore? Asgjë e tillë nuk ka ndodhur, dhe me të ardhurat nga Partia Socialiste është realizuar evazion fiskal sepse fitimet socialiste të Veliajve nuk janë deklaruar në zyrat e tatim taksave. Në fakt fshirja e logos së vëllait të Erion Velisë nga ëebsiti i Partisë Socialiste nuk është gjë tjetër veçse frika që ka Rama për implikimin e tij në afera financiare me bizneset e paligjshme dhe të paregjistruara të familjes Veliaj.

Gjithashtu është e mundshme plotësisht, që vëllai i Erion Velisë të jetë paguar për punën e kryer në Partinë Socialiste të jetë paguar me paratë e Bashkisë së Tiranës. Por kjo do të zbardhet kur vëllai i Velisë të detyrohet të demonstrojë para organeve kompetente se si janë faturuar këto para dhe kush Edi Ramë ia ka dhënë. Një ndër klientët e tjerë të familjes Veliaj është edhe Bashkia Durrës që siç dihet pas fitores së Partisë Socialiste për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë. Kjo Bashkia i ka transferuar Velisë mijëra euro për një websit si shpërblim për punën e vyer të MJAFT në mbështetje të kandidaturës socialiste në Zgjedhjet Lokale 2007. Siç rezulton nga të dhënat tona, drejtuesit e sotëm të G99 dhe të MJAFT, kanë dhënë një mbështetje aktive për kandidaturën e Kryetarit të Bashkisë së Durrësit dhe kjo iu shpërblye me mijëra euro të dhuruara për Veliaj & Co. Këtu problemi përsëritet pafundësisht siç ndodh edhe me donatorët ndërkombëtarë pasi Grafik Propaganda nuk ekziston sepse nuk gjendet në databasen e QKR i vetmi regjistrim biznesi që kanë vëllezërit Veliaj është NIPT që i jep mundësi të shesin parfume në Tiranë. Sa para nga shuma e dhënë nga Bashkia Durrës janë paguar për të paguar detyrimet fiskale dhe sigurimet shoqërore. E njëjta histori përsëritet edhe me ëebsitin e Parkut të Butrintit. Mungesë deklarimi të ardhurash në Drejtorinë e Tatim Taksave dhe implikim edhe të shumë institucioneve të tjera qendrore në kontraktimet e paligjshme të bizneseve te Velisë.

### Si u shpenzuan 120 milionë lekë të OXFAM nga MJAFT për udhëtim me jaht ne bregdetin shqiptar

# Erion Veliaj, 120 milionë lekë pushime për udhëtime me jaht me paratë e luftës kundër varfërisë



Jahti që përdori Erion Veliaj




Deri më sot kemi trajtuar në dosjerin special që ka publikuar gazeta Sot paudhësitë e VeliajT & Co i orientuar dhe i modifikuar nga drejtuesit kryesorë të Soros në Shqipëri dhe në mënyrë të veçantë nga Edi Rama, një ndër njerëzit më të afërt të George Soros në Shqipëri.

Një nder pikat më të dobëta juridike të këtij instrumenti të rrjetit underground Soros në Shqipëri është edhe evazioni fiskal i bizneseve familjare që kanë krijuar Veliaj & Co. Por një ndër çështjet e paprekura deri më tani është evazioni fiskal i vetë organizatave të Erion Velisë.

Siç rezulton nga të dhënat e Gazetës Sot që publikohen çdo ditë, sasia e parave të thithura deri më tani nga organizatat e MJAFT kapërcen shifrën e 5.4 milionë eurove dhe këtu nuk përfshihen shumë para që Veliaj ka thithur nga biznesi shqiptar (kompani celulare, qendra të mëdha biznesi, banka, prodhues pijesh), si dhe komuniteti shqiptar nga diaspora, etj. Vetëm MJAFT Fest e anatemuar vazhdimisht nga dëshmitarë okularë si festë marihuane dhe alkooli, ka pasur deri më tani 28 sponsorizime private. Por këto të dhëna nuk janë përfshirë në shifrën prej 5.4 milionë eurosh të MJAFT-ëve të Velisë.

Sasia e donatorëve të dokumentuar të Velisë deri më tani arrin në 43 donatorë duke thyer çdo rekord të njohur financimesh në shoqërinë civile prej 18 vjetësh.

Ndërsa shifra e dokumentuar përfshin vetëm një pjesë të këtyre donatorëve pasi fshehja e parave që financuan MJAFT ka përbërë gjithmonë një sekret absolut dhe nuk ka qenë kurrë e mundshme që Veliaj & Co të tregojë. Është gazeta Sot dhe ekspertët e saj ata që kanë arritur të sigurojnë të dhëna të shumta nga shumë burime që do të publikohen vazhdimisht nga gazeta Sot për të treguar një pjesë të së vërtetës së financimeve të Velisë. Një tjetër nga pikat më të errëta do të mbetet gjithmonë sasia e vërtetë e parave që Veliaj ka siguruar nga Rrjeti Ndërkombëtar i Fondacioneve Soros i cili menaxhohet në nivel ndërkombëtar nga Princesha e Holandës Von Mise në Zyrën e Soros në Londër dhe nga Instituti i Shoqërisë së Hapur që ndodhet në të njëjtën godinë në Manhatan në New York ku ndodhet edhe Soros Management Fund (biznesi i George Soros) që organizon dhe koordinon të gjitha spekulimet financiare në botë. Zyra e Institutit të Shoqërisë së Hapur në New York në të njëjtën ndërtesë me biznesin miliarder të Soros i ka dhënë famën e Avokatit të Djallit që ka menaxhuar fatin e qeverive në vende në zhvillim apo të pazhvilluara në shumë vende të globit por që sot siç dihet i ka rënë influenca kudo përveç rastit të Shqipërisë ku pushteti i tij është absolut.

Ndërkohë që Erion Veliaj si një ushtar besnik i komandantëve lokalë të George Soros (në rastin shqiptar është Edi Rama), ka siguruar mbështetje financiare nga 43 donatorë ndërkombëtarë, para që kanë shkuar të gjitha për të fuqizuar një nga spinoffet që ka krijuar Soros në Shqipëri për të kontrolluar edhe politikisht Shqipërinë.

Nga të dhënat e mbledhura mbi Lëvizjen MJAFT dhe strukturat e saj (përfshi edhe Fondacionin Piramidal MJAFT që jep para me përqindje) rezulton se numri i punonjësve të MJAFT ka arritur në ditë normale pune rreth 40 persona dhe në ditë "piku" rreth 60 persona. Vetëm projektet aktuale të monitorimeve (gjobëvënies së sofistikuar sorosiane), kanë të punësuar 12 persona njëkohësisht (pavarësisht se ka raste që një person merr njëkohësisht dy rroga apo tre në të njëjtin program). Vetëm një projekt, ai Laboremus i financuar me 48.400 $ nga Banka Botërore dhe donatorë të tjerë (siç thuhet në faqen zyrtare të Bankës Botërore) përfshin një total prej 7 personash dhe ku rrogat variojnë nga 500 dollar deri në 350 dollarë duke përfshirë një total vjetor prej 34.200 $. Duke bërë një llogari të thjeshtë rezulton se vetëm tatimi mbi të ardhurat, sigurimet shoqërore që duhet t'i paguhen shtetit shqiptar përfshijnë 15.720 $. A i janë paguar ndonjëherë shtetit shqiptar këto para? As që bëhet fjalë. Dhe të mendosh që këto para janë derdhur vetëm për një projekt në 2006 ndërkohë që nga të dhënat tona rezulton se MJAFT në 2006 ka thithur pranë donatorëve rreth 800 mijë euro.

Dhe ndërkohë rezulton se Banka Botërore u zhgënjye shumë kur ky projekt nuk po realizohej sipas parashikimit dhe për pasojë Fondacionit MJAFT i erdhi paralajmërimi për kthim mbrapsht të fondeve. Në këtë kohë ndërhyri gruaja e Drejtorit të Soros në Tiranë, e cila është njëkohësisht edhe përgjegjëse për marrëdhëniet publike në Bankën Botërore për të mbuluar gjurmët e qarkullimit shumë mujor të parave në banka (të cilat prodhonin përqindje për familjet e mëdha të MJAFT të Velisë & Maznikut). Ky projekt u realizua brenda natës nga i vëllai i Erion Velisë i cili punonte edhe si biznes faturues edhe si staf i projektit ndërkohë që nuk rezulton që ai të ketë paguar pranë Drejtorisë së Tatim Taksave asnjë detyrim financiar për të ardhurat e marra. Nga të dhënat e gazetës Sot rezulton se vëllai i Erion Velisë ka punuar si webmaster dhe dezajner në të paktën 17 projekte të Erion Velisë duke u punësuar 17 herë brenda 5 vjetësh ku secila rrogë ka zgjatur nga 5 muaj deri në 3 vjet. Duke pasur parasysh se rrogat më të ulta në Lëvizjen Mjaft kanë qenë 350 $ rezulton se sasia e parave me të cilat është paguar Arbër Veliaj të ketë lëvizur nga 1000 dollarë në muaj deri në 2500, çka e përcakton atë de jure edhe si një kontribues të madh në Sigurimet Shoqërore dhe pagues i tatimit mbi të ardhurat i të paktën 1200 deri në 3000 $ në vit vetëm për rrogën që ka marrë në shoqatat e të vëllait. Por kjo nuk rezulton në të dhënat e siguruara në Drejtorinë e Tatim Taksave. Dhe këtu nuk po flasim për bizneset e paregjistruara të Arbër Velisë ku ai ka qarkulluar qindra miliona lekë të shoqatave të vëllait dhe qindra miliona lekë të tjera të 54 klientëve të tjerë të tij të prezantuar në faqen online www.fshatiurban.com.

Në fakt nëse do t'i referohemi standardeve të larta të rrogave dhe të numrit të rrogëtarëve të projekteve të MJAFT, ku Veliaj, Mazniku, Lika, Fuga kanë qenë ndër më të paguarit njëkohësisht në shumicën e projekteve të MJAFT, rezulton se të paktën vetëm këta të katërt duhej të paguanin rregullisht çdo vit në Drejtorinë e Tatim Taksave dhe në Sigurimet Shoqërore në Tiranë rreth 14 milionë lekë në vit prej 5 vjetësh por edhe kjo nuk rezulton.

Ndërkohë që të gjitha rrogat e shoqatave të Velisë & Co do të duhej të kishin paguar pranë Drejtorisë së Tatim Taksave dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore për 5 vjet Lëvizje MJAFT mbi 200 milionë lekë vetëm për pagesat e punonjësve të kontraktuar të projekteve të donatorëve të huaj. Natyrisht që as kjo nuk rezulton.

Pra vetëm me një llogari të thjeshtë kuptojmë se me paratë e 43 donatorëve të Velisë është kryer evazion i pastër fiskal vetëm me zërin rroga në shifra rekord duke demonstruar edhe një herë se çfarë abuzimi me ligjet e shtetit kanë financuar donatorët e luftës antikorrupsion dhe të promovimit të politikës se re.

Vetëm një javë më parë, në një emision televiziv, gënjeshtari Veliaj i cili tregoi një histori për rroga shumë të larta që paguan në Gjermani dhe në vende të tjera si eksperti më i kualifikuar i Ballkanit në shkencat politike, nuk paguante asnjë të ardhur në Drejtorinë e Tatim Taksave dhe Institutit e Sigurimeve Shoqërore sepse ai paguaka jashtë shtetit "sigurimin e jetës" dhe kjo sipas tij e përjashton nga detyrimet që ka ndaj shtetit shqiptar. Veliaj që në fillimet e politikës së re përtej të majtës dhe të djathtës përfaqëson një lider të evazionit fiskal dhe shmangies nga detyrimet financiare që ka kushdo ndaj shtetit shqiptar. Por problemi nuk qëndron vetëm tek Veliaj, jo vetëm tek donatorët "e verbër", por edhe tek shteti "i verbër" shqiptar që ka lejuar të livadhisë një ndër VIP-at e evazionit fiskal të OJF-ve.

Kamikazi i Edi Ramës ka ngritur rrjet biznesesh me paratë e shoqërisë civile

# Mozaik sh.p.k pjesë e bizneseve të Erion Veliaj, në të njëjtën adresë me atë të vëllait të tij Arbrit

Erion Veliaj, megjithëse në publik mundohet të ruajë qetësinë, duke manifestuar para teleshikuesve të mediave që e ndjekin nga mbrapa sigurinë e një njeiu që i ka punët në rregull, gjurmët që ka lënë nëpër site dhe dokumente e komprometojnë shumë keq. Megjithëse mundohet të paraqesë faktet e gazetës SOT si modele të një historie konspirative, Erion Veliaj, ky "lejfen" i vogël kamikaz i Edi Ramës në historinë e tij kontribuuese për shoqërinë civile ka krijuar një rrjet biznesesh me paratë e donatorëve për shoqërinë civile shqiptare. Pa dashur të krijojmë insinuata armiqësie me njerëzit që bëjnë biznes, pasi biznesmenët janë njerëz të nderuar dhe të respektuar (në të kundërt të Erion komsomolasit), biznesi i Erion Velisë është biznes i ngritur mbi para që jepen për destinacion; shëndoshjen e shoqërisë civile shqiptare. Erion Veliaj në mënyrë të qëllimshme ka përdorur këto para për të shëndoshur financat e tij familjare, duke u pasuruar në koalicion me grupin e tij të mjeshtrave të vegjël të grupimit të 99 kamikazëve të vegjël të Edi Ramës. Në renditjen e fakteve që kemi dhënë gjatë kësaj periudhe nuk është e vështirë të gjesh implikimin e Velisë në afera biznesi, të cilat i ka të pasqyruar në dokumentacione dhe site interneti. Pak ditë më parë, Gazeta Sot ka zbuluar se Formacioni sorosian politik G99 i justifikon shpenzimet multimilionere në hotele superluksoze dhe me makina luksoze, nëpërmjet një skeme perfekte manipulimi financiar të bazuar tek përdorimi i një biznesi gjoja amerikan që kanë krijuar njerëzit e Mjaftit të Erion Velisë. Përfaqësuesi ligjor I këtij biznesi me emrin Mozaik sh.p.k. është Endrit Kromidhja I cili ka qenë një ndër personat kryesorë përgjegjës të financave të MJAFT dhe që në një moment të caktuar krijon një biznes dhe më pas "e ngre pazarin" duke krijuar nje biznes te transfertave dhe shitjeve online.

Mozaik sh.p.k. paraqitet me websitin e tij www.albmozaik.com faqe e cila hapet automatikisht në mënyrë të fshehtë në momentin që dikush kërkon t'i japë para G99. Në këtë faqe të një biznesi që garanton klientët e vet për ruajtje totale të sekretit Veliaj justifikon sasinë marramendëse të parave me të cilat financon Lëvizjen G99 sepse ka deklaruar para mediave se ai do ta bëjë si Obama duke thithur para online nga "aksionerët" e tij. Në fakt aksionerët e Obamës nuk kishin të drejtë të dhuronin online më shumë se limiti që ka përcaktuar ligji për dhurimet online ndërkohë që kjo e drejtë i njihet vetëm shtetasve amerikanë. Ndërsa Veliaj në faqen e vet mund të thithë çdo lloj shume nga çdo vend i botës dhe nga çdo individ duke u bërë subjekt i pastër i shkeljes së ligjit të pastrimit të parave dhe financimit të partive dhe fushatave elektorale.

Mozaik sh.p.k. këto ditë ka shtuar në faqen e tij online edhe një argument të fortë: "Të gjitha te drejtat e rezervuara. Asnjë pjese e kësaj faqe nuk mund te kopjohet apo riprodhohet ne forma elektronike apo te tjera". Pjesë e faqes është edhe adresa e kontaktit dhe kush drejton këtë biznes përfshi edhe mashtrimin sikur ky eshte nje biznes amerikan. Siç ka publikuar gazeta Sot, ky është nje biznes shqiptar i regjistruar si shpk ne Gjykatën e Tiranës si sh.p.k. nga shtetas me pasaporta amerikane ku njëri nga dy ortakët, shtetasi me emrin e zakonshëm amerikan John R. Moore nuk ka paraqitur të dhëna të plota mbi identitetin e tij çka të bën të dyshosh që ai nuk ka ardhur fare në Shqipëri dhe nëse e kërkon në Amerikë me lloj lloj mjetesh ai duket sikur nuk ekziston fare.

Problemi është se Mozaik sh.p.k. krijon shumë tym dhe shumë paqartësi mbi identitetin e saj. Dhe Gazeta Sot ka të drejtën që ia ka përcaktuar ligji që të paraqesë faksimile dokumenta dhe asnjë e drejtë copyright-i nuk mund të mbrojë denoncimin e skemave të fshehjes së financimeve dhe pastrimit të parave.

Arsyeja pse Gazeta Sot i ka kushtuar vëmendje të veçantë të dhënave mbi biznesin Mozaik sh.p.k. ka të bëjë në radhë të parë me faktin se ky biznes duke i shërbyer Erion Velisë si koperturë për të mos bërë transparencën e financimeve të G99 (e cila është ngritur me paratë e donatorëve të huaj të destinuara për shoqërinë civile dhe jo për mbështetjen e partive politike) është një biznes që ka lidhje krejtësisht personale me familjen Veliaj. Kolegia e parave të Mjaftit që ka punuar bashkë me Endrit Kromidhen në zyrën e financave, Juela Shamku sot prezantohet si përfaqësuesja e një biznesi të paregjistruar në gjykatën e Tiranës të quajtur "Fshati Urban" ("Grafik Propaganda") i cili është themeluar nga familja Veliaj me paratë e mikrokreditit që ka shpërndarë në mënyrë të paligjshme Fondacioni Mjaft konsulent i kredive të të cilit ka qenë edhe Kromidhja. Ky biznes që ka inkasuar dhe faturuar qindra milionë lekë të donatorëve të destinuara për Lëvizjen MJAFT, si dhe qindra miliona të tjera duke bërë evazion të pastër fiskal, është në të njëjtën dhomë me Mozaik sh.p.k.! Fshati Urban (Grafik Propaganda) i Arbër Veliaj dhe Juela Shamku, dhe Mozaik sh.p.k. i Endrit Kromidhja janë bashkë sepse në një formë apo në një tjetër janë e njëjta gjë. Adresa Adresa: Rr. Dervish Hima, P. Leskov 1/5, Tirane, Tel: (+355) 42227877, është e përbashkët si për biznesin e Arbër Velisë të përfaqësuar nga një nga ish-personat përgjegjës të MJAFT për financat, Juela Shamku ashtu edhe për Mozaik sh.p.k. të Endrit Kromidhja i cili ka qenë gjithashtu një ndër personat përgjegjës të MJAFT për financat (fakt që është publikuar me faksimile më parë nga Gazeta Sot). Sot e vërteta mbi biznesin që mbulon financimet e G99 po shkon pak nga pak drejt zbardhjes së plotë duke treguar se ky biznes është pjesë e lojës së Veliaj për të ndërtuar një skemë biznesesh që faturojnë, inkasojnë dhe pastrojnë gjurmët e korrupsionit politik të lojës së re G99.







## Politika e privacisë së Mozaik sh.p.k

"Tek Mozaik Sh.P.K., ne kuptojmë mirë çështjen e ruajtjes së informacionit personal. Përdoruesit e internetit janë gjithmonë të shqetësuar me të drejtë se si apo ku do përfundojë informacioni i tyre.
Ne respektojmë informacionin tuaj personal dhe e trajtojmë atë me një rëndësi të veçantë. Ne nuk japim informacion mbi klientët tanë asnjë palë të tretë për asnjë arsye, përveç në rastet ku bashkëpunojmë me organet e ligjit kur është kryer nje shkelje ligjore kundër kompanisë sonë.
Informacioni juaj personal është i sigurt me ne. Ky është premtimi ynë për ju. Informacioni personal i klientëve ruhet i kriptuar për siguri maksimale."

## Company Name: Urban Village

Street Address: Rr. Dervish Hima, P. Leskov 1 / 5
City: Tirana Country/Region: Albania
Telephone: 00355-68-4014803
Mobile Phone: 00355684014803
Fax: 00355-4-227877
Website: http://www.fshatiurban.com

Gazeta Sot ruan në arkivë e vet të gjitha ëebsitet e fshira të Veliaj & Co

# Virusi i Frikës që fshiu faqet e shoqatave dhe bizneseve të Vëllezërve Veliaj

Prej mëse 30 ditesh, Veliaj & Co i janë përveshur punës për zhdukjen e gjurmëve të korrupsionit duke fshirë faqet e ndryshme online që ata vetë kanë krijuar për të reklamuar punën e tyre dhe justifikuar mbi 5.4milionë euro financime të Lëvizjes MJAFT që Gazeta SOT ka të dokumentuar në serverin e saj.

Çdo ditë gazeta Sot dokumenton fshirjen masive të faqeve online që janë krijuar me paratë e donatorëve të destinuara për shoqërinë civile shqiptare.

"Dëmi" teorik financiar i shkaktuar nga fshirja e faqeve vetëm për këtë muaj (i matur nëpërmjet llogaritjes së përafërt të shpenzimeve për t'i ndërtuar këto faqe) deri tani shkon mbi 250 milionë lekë.

Justifikimi i Velisë & Co për "vetëvrasjen" e faqeve të veta është "motivuar" herë me teorinë e "rindërtimit" (under construction), herë duke prerë dhe redaktuar (lexo: hequr apo cuting) të dhënat diskredituese, dhe herë duke zhdukur çdo gjë pa lënë gjurmë.

E vërteta pse Veliaj & Co po shkatërron faqet e veta apo të të tjerëve që ka realizuar nëpërmjet evazionit të rëndë fiskal është sepse në këto faqe ka një pafundësi të dhënash që vërtetojnë denoncimin e Gazetës Sot për një skemë të madhe mashtrimi sorosian ku përfshihen:

- foto diskredituese (si psh zhdukje të ...mjeve me jahte luksoze që harxhojnë ...ndra milionë lekë të luftës kundër varfërisë ...po fshirje foto meshkujsh të veshur si ...emra për "ti hyrë në zemër" diplomatëve dhe donatorëve me preferenca homoseksuale);

- emra njerëzish (si psh zhdukje emrash që vërtetojnë përfshirjen e tyre në skema të ndryshme biznesi të ngritur me qëllim faturimin e parave të Lëvizjes MJAFT apo që "pastrojnë" financimet e paligjshme të Grupimit Politik G99);

- të dhëna mbi donatorët (si psh zhdukje të dhënash ato që vërtetojnë implikimin e palëve të ndryshme në skemat sorosiane të shoqërisë civile, politikës, universiteteve, bankave, medias, etj.);

- të dhëna mbi identitetin e origjinës sorosiane të spinoffeve të MJAFT-it dhe G99 (si psh zhdukje të dhënash mbi Shoqatën Kombëtare të Debatit - ANDA të Arbjan Maznikut të krijuar që në 2000, Balkan Youth Link - Albania të Velisë të krijuar që në 2000, SNEWS të Endri Fugës dhe Arbër Velisë të krijuar që në 2001, etj);

- të dhëna mbi Fondacione Piramidale dhe aktivitete të paligjshme të Velisë & Co me paratë e donatorëve ndërkombëtarë (si psh zhdukje të Fondacionit piramidal MJAFT i dhënies së kredive në kundërshtim me ligjin që ndalon veprimtarinë e Fondacioneve që japin para me përqindje interesi);

- të dhëna mbi konflikte të pastra interesi dhe skema riciklimi burimesh njerëzore (si psh Veliaj që i jep të vëllait mikrokredi nga paratë e donatorëve);

- të dhëna mbi biznese të paligjshme të ngritura nga Klani Veliaj & Co të cilat kryejnë evazione fiskale me përmasa qindra miliona lekë (si psh heqja e "portofolit të klientëve" të C&PR Production dhe Grafik Propaganda të Fshatit Urban, biznese këto të ngritura nga Veliaj & Co si fillim për të faturuar dhe përfituar privatisht miliona eurot e donatorëve për shoqërinë civile dhe më pas edhe për të hyrë në marëdhënie të drejtpërdrejta biznesi me vetë ndërkombëtarët dhe biznese të mëdha brenda dhe jashtë Shqipërisë);

- të dhëna mbi marëdhëniet e ngushta financiare dhe politike midis Erion Velisë dhe Edi Ramës (si psh heqja e portofolit online të biznesit të paligjshëm Grafik Propaganda apo të quajtur Fshati Urban pasi aty tregohet se si Vëllezërit Veliaj janë ata që kanë bërë faqen e uebsitit të Partisë Socialiste, Fondacionit Qemal Stafa dhe kanë realizuar që në 2006 vetë imazhin e ri të Partisë Socialiste përtej të Majtës dhe të Djathtës duke përfshirë edhe vetë logon e re të PSsë);

- të dhëna mbi marëdhëniet e paligjshme fiskale me institucionet shtetërore (si psh heqja e informacionit mbi klientët e biznesve të Veliaj & Co si Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Bashkia Tiranë, Bashkia Durrës, Departamenti i Administratës Publike pranë Këshillit të Minstrave, Parku Kombëtar Butrinti, KESH, etj.)

- të dhëna mbi kontrollin e llogarive bankare të shoqërisë civile nga Erion Veliaj brenda dhe jashtë Shqipërisë (si psh zhdukja e faqeve të fondacionit MJAFT dhe Balkan Youth Link që tregojnë numrat bankar që përdor Erion Veliaj në Kaliforni për të tërhequr paratë që i jepen MJAFT nga donatorët e huaj)

- të dhëna mbi marëdhëniet e paligjshme kontraktuale me të tretë (si psh zhdukja e faqeve të Fondacionit MJAFT apo të fshehjes së faqeve ku garantohet në mënyrë mafioze sekreti i burimit të financimit të Veliajt & Co), etj etj.

Ka një pafundësi motivesh pse faqet e Erion Veliajt po i zhduk VIRUSI i FRIKËS! Por e dhëna e parë që do të duhej të kishte dashur të zhdukte Erion Veliaj është sasia dhe burimi i financimit të tij në vite. Kjo nuk mund të fshihet sepse kjo e dhënë nuk është treguar kurrë nga MJAFT apo G99. As nuk është deklaruar ndonjëherë dhe as ka për t'u vetdaklaruar nga Veliaj sepse ai ka frikë të tmerrojë njerëzit me shkallën e lartë të abuzimit me këto para pasi që në atë moment askush nuk do të gënjehet nga "studenti i varfër që braktisi punën e shumëpaguar në OKB, për ti shërbyer Atdheut, i cili u kthye në vendin e tij si Mesia" (fjalë të cituara në një prezantim online të vetë Veliajt). Miliardat e Velisë nuk ka raport financiar t'i justifikojë sepse ato nuk maten me balet mediatik por me fatura dhe faturat duhet të tregojnë shpenzime që vërtetohen pasi çdo faturë është subjekt fiskal me një adresë të saktë. Dhe këto të dhëna Veliaj nuk i ka publikuar në asnjë faqe online pavarësisht se Gazeta Sot është detyruar ti gjejë dhe ti dokumentojë në burime të origjinës (të donatorëve).

Megjithë zhdukjen, shkatërrimin, copëtimin, redaktimin, apo kushtëzimin e aksesit të navigimit të faqeve që kanë kushtuar qindra miliona lekë të realizuar nga bizneset familjare të Velisë me paratë e taksapaguesve të huaj apo shqiptarë, sot në kohën e informacionit dhe të aksesit të çdokujt në teknologjinë e komunikimit, ekspertët e Gazetës kanë arritur të ruajnë kopjen e të gjithë faqeve të zhdukura.

Gazeta Sot disponon faqet e zhdukura të websitit të Lëvizjes MJAFT, të Fondacionit Piramidal MJAFT, të Balkan Youth Link, të SNEWS, të Grafik.fshatiurban.com, të C&Pr Production, të Mozaik sh.p.k., etj etj.

Gazeta Sot disponon edhe faqet e zhdukura këto ditë "terrori" nga frika të ish-spiunit Remzi Lani të spinoffit sorosian Instituti i Medias. Por kjo është një histori tjetër, e ngjashme me atë të soros.al e cila do të trajtohet një ditë tjetër.

Faktet që disponon Gazeta Sot janë të plota, ta sakta, të mirëruajtura dhe të arkivuara, ashtu siç duhet të jenë provat gjyqësore në një proces gjyqësor civil dhe penal.









# Organograma e financimit të spinoffit elektoral sorosian: G99

## George SOROS

▼

## SOROS SHQIPERI

▼

## EDI RAMA

Njeriu i Soros në politikën shqiptare (mik i afërt që në '96,Budapest) i dhuroi Soros Colësin e Artë të Tiranës. Anëtar i bordit të SOROS '93 – '98 (aktualisht Kryetar i PS dhe Bashkisë Tiranë)

SOROS ANGLI PRINCESHA E HOLLANDES ▼ FAMILJA MBRETËRORE HOLLANDEZE ▼ AMBASADA HOLLANDEZE ▼

## G99 & MJAFT

▲

### Fondacioni Soros Shqipëri ►

(themelohet në 1992 nga Fren Nazi në një celulë komuniste)

### MILVA EKONOMI

"Njeriu i Artë i Soros në Shqipëri", Financierja e të gjithë strukturave kryesore të Soros në Shqipëri '99 – '08 (aktualisht Drejton Institutin Agenda, G99, MJAFT, Besën,

▼

### REMZI LANI ►

Njeriu i Soros për Median '93-'08 (Aktualisht Drejtor i Qendrës së Medias)

### G99

◄ MOZAIK sh.p.k.

C&PR Production ◄

GRAFIK PROPAGANDA ◄

▲

Disa nga njerëzit kryesorë:

### VADETE SALA

Njeriu i Shoqërisë Civile'92-'05 (aktualisht drejtues i Programit të Qeverisë Gjermane për shoqërinë civile)

### CAPAJEC GJOKUTAJ

Njeriu i Soros për Administrin e Fondacionit '97-'08 (aktualisht Drejtor i Fondacionit të Soros A.B.C.)

### DELINA FICO

Njeriu i Soros për Lëvizjen Feministe '94-'08 (Aktualisht mbulon marëdhëniet publike të USAID për Fondin e Millenium)

### PIRO MISHA

Njeriu i Soros për literaturën '92-'08 (aktualisht Drejtor i Shtëpisë së Dialogut dhe Komunikimit)

► FONDACIONI MJAFT ◄

► BALLKAN YOUTH LINK ►

► Shoqata Kombëtare e Debatit – ANDA ►

► Instituti i Lidershipit Rinor ►

## LËVIZJA MJAFT

## MILIONA EURO financime për Lëvizjen MJAFT

- ◄ AMBASADA GJERMANE
- ◄ SNV
- ◄ NOVIB
- ◄ AMBASADA E MBRETËRISË SË BASHKUAR
- ◄ OSCE
- ◄ AMBASADA E SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS
- ◄ USAID
- ◄ DELEGACIONI I BASHKIMIT EUROPIAN NË TIRANË
- ◄ Agjencia Austriake IFA
- ◄ Agjencia zvicerane për Zhvillim dhe Kooperim SDC
- ◄ Agjencia Spanjolle për Bashkëpunim dhe Kooperim
- ◄ Banka Botërore
- ◄ UNICEF
- ◄ UNDP
- ◄ UNV
- ◄ UNDCP
- ◄ DFID
- ◄ GTZ
- ◄ IOM
- ◄ ILO
- ◄ OXFAM
- ◄ FREEDOM HOUSE
- ◄ Iniciativa e Paktit të Stabilitetit ESI
- ◄ NED
- ◄ GMF (German Marshall Fund)
- ◄ BOSCH (Fondacion Gjerman)
- ◄ Olaf Palme
- ◄ Pakti i Stabilitetit për EJL i mbështetur nga Qeveria Gjermane
- ◄ NDI
- ◄ IRI
- ◄ NED
- ◄ Fondacioni i Ndërkombëtar i Biznesit Rinor
- ◄ Fondacioni Ndërkombëtar i Rinisë
- ◄ Ballkan Children & Youth Foundation BCYF
- ◄ Forumi i Lidershipit të Biznesit të Princit të Éelsit
- ◄ Fondacioni Rockfeller
- ◄ Këshilli Britanik
- ◄ Fondacioni Soros Kosovë, Etj